

Lasgush
Poradeci

VIDEKJA

E

POSITI

Biblioteka RILINDJA

Redaktor

Nazmi Rrahmani

8JH-1
P 87

Lasgush Poradeci

VDEKJA E NOSITIT


Zgjedhi
e përgatiti
për shtyp

SABRI HAMITI



RILINDJA
Redaksia e botimeve
Prishtinë
1978





VDEKJA E NOSITIT

I. SHQIPTIMI I POEZISË

1. Hyrje për interpretim

*Këng'e lashtë e vjershërisë më pëlqeu aq fare pak...
Do t'ja marr që sot e tutje si bilbil parëverak,
Që nga fund'i vetëvetes do këndoje një mall të ri:*

Janë këto tri vargjet nistore të vjershës Zog'i qiejve, që në vend parafjale është e vënë në ballë të veprës poetike të Lasgush Poradecit. Këto vargje nistore mbajnë në vete një vlerësim të këngëtimit poetik shqip, si dhe një program orientues të poetit. Janë thirrje për të theksuar individualitetin poetik në një kontinuitet të shkrimit poetik shqip dhe vargje-çelës për të hyrë në temat, interesimet poetike dhe në gjuhën e poezisë së Lasgushit në gjithë veprën; të cilat në mënyrë implicite shtrohen në vijim edhe vetë brendapërbrenda kësaj kënge nistore. Në vargjet e lexuara në fillim dalin dy nocione-figura-tema të poezisë së Lasgushit: *Këngë e lashtë / Mall i ri*, të cilat po u eksplikuan brenda kësaj kënge dhe në gjithë veprën poetike në tërësi, dalin në një lidhje të fortë të ndërmjetvetshme, dhe jo në kundërshti, duke e përiashtuar njëra tjetrën. Ngase thyerja që do ta bëjë poeti në lirikën shqipe (vetëdijshtëm si shihet nga teksti) nuk është shkëputje nga kontinuiteti i poezisë shqipe, por

kërkim për lidhje më të fortë me *burimin* me rrënjën: këngën e lashtësisë, për t'u ngritur mbi të *Malli i ri*, rezultat i dëshiruar i shpërndërrimit poetik origjinal. Pra, ja këtu në fillim dalin dy tema të poezisë së Lasgushit, orientimi i tij programor-sistemi poetik. Në vijim të vjershës shenjzohen temat tjera:

Asohere-e ndjej si foli: Të jam falë,-o Zoti im!

Në këtë fushë shenjzimi të poezisë *Zoti* nuk është Zoti religjioz, por një shkallë e lartë e përqëndrimit të qenies, është përqëndrim e jo frymëzim, temë e këndimit qenieplotë, të pacopëzuar. Ky përqëndrim e sjell krijuesin në rrugën e leximit të thellë të realitetit, që del si zbulim i rishëm shpirtëror, identifikim me kërkimin e parreshtur dhe nisje në rrugën imagjinative poetike:

Tungjatjeta! Tungjatjeta! Vënt o Vënt ku çel junapi!

Në zemrën e vendit nis bumbullima e të jetuarit intenziv, që mbledh më vete ngazëllimin e dëshirën e pasosur, edhe humbjen e pësimin, si dhe mashtrimet e ëmbla:

Mu në funt të zemrës s'ate ritet fshehur dashurija

Në këtë shkallë të përpëlitjeve shpirtërore, në zgjatjen e një të jetuari intenziv nëpër gjakime-dëshirime-pësime lind kënga:

E kështu ti qan pa rreshtur bukuritë-e dashuritë

Në këtë varg dalin pranë e pranë figurat-nocionet *Bukuri/Dashuri*, si të *Bukuria* e *Naimit*. Kur këto dy nocione në këtë vjershë si dhe këto tema në gjithë veprën e Lasgushit përshkohen në këngë, kënga del *vaj i parreshtur*, si forma më e preferuar e poezisë së këtij autori për temën e dashurisë: si *këngë e duri-mit*. si *liri-robëri*.

Pra, vetëm brenda kësaj vjershe, të cilën poeti e ka vënë në ballë të veprës së vet poetike, dalin nocionet, figurat dhe temat qendrore të gjithë poezisë së tij: *Kënga pleqërishte*; *Malli i ri*; *Bukuria llajtare*; *Dashuria: kënga e durimit*; *Përjetësia*; *Vaji i zemrës*; *Vdekja*. Përderisa Bodëleri hyn në librin e vet *Lulet e ligësisë* me një vjershë kushtuar *lexuesit*, Lasgushi hyn në vallet e veta poetike me një vjershë kushtuar *krijuesit*. Kjo na e thotë edhe njëherë në fillim natyrën krijuese dhe programin poetik të Lasgushit, i cili edhe kur në fiksionin e vet poetik kërkon një dialog me lexuesin, edhe kur don të krijojë një vijë komunikimi me tjetrin, gjithëherë nisat nga krijuesi, nga vetja. Sepse do të jetë vetëm poet, kudo e gjithëherë. Poezia e tij është para së gjithash një shqiptim i thellë i krijuesit të saj. Pikërisht ky tip i shkrimit letrar dhe ky tip i krijuesit kushtëzon edhe një mënyrë specifike të interpretimit, të cilër do ta ndjekim më vonë.

2. Koha, Vendi, Gjuha

2. 1. *Kënga pleqërishte*. — Gjakimin për këngën, poeti, në mes tjerash, e shuan në kërkimin e parreshtur për identifikim me këngën pleqërishte (këngën e lashtësisë), si dhe me jashtësinë si determinantë të bumbullimës jetësore dhe si hapësirë të shtegëtimit të frymës shpirtërore. Në poezinë *Kënga pleqërishte* kjo kërkesë shtrohet si thirrje për sprovim të vetes dhe për identifikim me O-në apelative shqipe të lashtë:

O këngë pleqërishte! Ti vjershë e Vëndit t'em!

Ky varg shtrin kërkesën për identifikim, ndërsa brendapërbrenda tij krijohet një identifikim që shqiptohet në mënyrë eksplicite: *Kënga pleqërishte* (është) *Vjershë e vendit tim*. Do të thotë bashkimi me këngën e lashtë sjell identifikimin me vendin e lashtë. Kjo lind

kërkesën për shqiptimin e zërit poetik, duke e përshkuar këtë nëpër një kurorë dije e përvoje popullore, që në konceptin poetik të Lasgushit është: *Fryma* dhe *Shpirti*, që mbledhin më vete gjithë qenien popullore, mitologjike, psikologjike dhe antropologjike, në një rrafsh më të gjerë. Prandaj, përmes O-së apelative thirret një zë i larguar nga lashtësia:

Tani jam dëshëruar së largu të më vish

Identifikimi i këngës së lashtë me realitetin e Vendlit këtu vendi i përshkruar nëpër gjuhën e papreshme të këngës është më tepër kategori e kohës) bëhet duke krijuar bashkimin e tyre nëpër pikat e gjeografisë shpirtërore të vendit, nëpër të cilat pika shqiptohet kënga: duke u nisur nga hija e *Kasollës* e deri në *Mal*. Pra, kënga e lashtë shqiptohet duke bredhur nëpër labirintet e Vendlit dhe të Kohës (historisë). Kështu shenjohen mundimet në rrugën e identifikimit të këngës me Vendlin, me Jetën, me Kohën (Historinë); herë si *zë i shtruar*, *zë i dhemshur*, *i qarë*. herë si *këngë e përvëlur*, *rënkim i zemrës sulm*, *ushitimë*:

Si breshër i thërmuar... si lot i përvëlur...

Kështu kënga rritet e jeton me kuptimet e mbledhura nga „Mjerimi i vetëvetes”. Fundi i vjershës është vetëm vlerësim i përpëlitjeve në rrugën e kërkesës për identifikim, që përshkohet nëpër labirintet e kohës, vendit; është vlerësim i kërkimit ose himn i identifikimit:

Nga fund'i zemrës s'ate ti ngrihesh dyke vuar:

Ti bje në thellësirën e zembërës së vet

Vargjet shprehin rrugën e shtegtimit të këngës, nisjen dhe kthimin, duke përmbledhur shenjat dhe kuptimet e gjithë vjershës (niset) nga *fundi i zemrës*: (bje në) *thellësinë e zemrës*. Pra, identifikimi i këngës poetike me këngën e lashtësisë është bërë i plotë, i thellë.

2. 2. *Fisi e Jeta*. — Identifikimi me këngën e lashtësisë sjell bashkimin e plotë me Frymën e me Shpirtin, të cilat e shqiptojnë *Tërë fisin, tërë jetën*. Në këtë mënyrë krijohet lidhja e dy kohëve: e një lashtësie me një bashkëkohësi, ndërsa fillon kënga për Vendin. Të kësaj fryme janë një cikël vjershash në të cilat Lasgushi këndon jetën konkrete të shqiptarëve. Në këto vjersha nuk ka abstragime të fuqishme poetike, po teksti del si poetizim i një jete, një idile të rrallë, të përmallshme dhe shpesh të prishur. Këndohet jeta e pastër e një ambienti shqiptar, jeta e bariut dhe e bujkut në një ambient të përafërt nga këndimet e dikurshme të Naim Frashërit. Vetëmse iluzionit (vizionit) të jetës së pastër e të qetë të Naimit (romantik), tashti i kundërvëhet ndjenja e dhe mbjes dhe e pikëllimit të poetit, i cili edhe nëse nuk është revoltuar ende sa duhet, ai është i përmalluar dhe i dëshpëruar. Jeta e shqiptarëve shkruhet në këto poezi në mënyrë ciklike, nëpër ditë, stinë e kohë. Nga *Mëngjesi në Korrik*, në *Mbarim vjeshte*, në *Dimër*, duke u pasë përfshirë vijmishit edhe *Liqeri*, si temë e preferueshme e ambientit real-konkret dhe si temë e preferueshme e përqëndrimit dhe metafizikës së poetit. *Tërë fisi, tërë jeta*, nëpër këto poezi, përcillen nëpër situata të ngjalljes e të ngrysjes, për t'u realizuar më plot poetikisht në poezinë *Poradeci*. Prandaj, interpretimi i kësaj poezie na flet më shumë për këtë mënyrë të këndimit / shkrimit të Lasgushit.

Në këtë vjershë përmbledhen shenjat karakteristike të ambientit dhe të jetës shqiptare të kohës edhe pse vjersha mban titullin e vendlindjes së poetit. Figurat-çelës të vjershës janë: Qytetzë, Mal e Lendina, Li-

qeri, Krahinë e gjerë, Mal i thatë, Fisi jeta, Shqiponja, Drini. Vjersha është e përshkuar nga fryma e mbrëmjes, fryma e ngrysjes, po e përcjellë me një disponim të ngrysur shpirtëror të krijuesit (një subjektivitet të projektuar kaq fuqishëm në tekst nga ana e Lasgushit), që është melankolik e i dhembshëm dhe shpresë-provuar në se jo shpresë-humbur:

E kudo krahin'e gjerë më s'po qit as pipëlim

Në Katund kërcet një portë... në Liqer bje

një lopatë...

Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal-të-Thatë

*Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit
tim*

Komenti i këtyre vargjeve na thotë shumë për angazhimin social të Lasgushit, të cilin ia kanë mohuar dhe ia mohojnë edhe tash së voni shkrimet kritike mbi veprën e tij. Vetëm se Lasgushi konsekuent ndaj programit të vet poetik, gjithnjë mendon me figurë, nuk e ka kurr agresivitetin e shprehjes së drejtpërdrejtë që i emëron situatat, gjendjet. Frymimi i jetës, të cilën e shenjëzon kjo vjershë është i ngushtuar. Frika se do të prehet ky frymim është e madhe. Krahinë nuk lëviz, është e përmbyllur në një amull ku mungon dija dhe aksioni. E lëvizjet janë ata që sjellin vdekjen e fshehtë, të mistershme, të mbështjellë në një „natë shqiptare”. Një gjendje e tillë që mbyllet lëvizjen dhe frynëmarrjen kushtëzon migrimin, migrimin fizik dhe shpirtëror, ikjen ose mbylljen e tmer-shme në zjarrin e vetvetes. Shqiponja, simbol i lashtë i shqiptarëve, arratiset. Kjo situatë e ngushtuar për njeriun jipet edhe më qartë në gradacionin e humbjes:

Tërë fisi, tërë jeta ra... u dergj... e zuri gjumi...

ku shenjëzohet apatia, sëmundja, përtacia shpirtërore, gjithnjë në një zotërim të *errësirës* (në këtë kontekst

crësira duhet të kuptohet gjithnjë si metaforë e jo si fjalë që drejtpërdrejt emëron një atmosferë, një kohë, pra jo fjalë për një nocion) Çka do të thotë kjo? Do të thotë se kjo poezi e fuqishme kurrsesi nuk guxon të interpretohet si poezi përshkruese e liqenit e as e idilës, siç do të jetë bërë ndonjëherë. Në këtë shkallë të vetëdijes, kur fle shpirti, poeti e sheh të vetmin shpëtim me një emërim dhe një thirrje të vjetër të emrit të Drinit plak dhe të Shqipërisë. Rrjedh Drini plak e i përrallshëm, që shenjon jetën, e cila duhet të vazhdohet.

Këtyre vjershave që nëpërmjet të figurës së emërimit të vendeve paraqesin një situatë të dhembshme të jetës, u kundërvëhen vjershat e historisë së lavdishme. Pra, nëse të parat janë poezi mbi vendin e shqiptarëve, rapsoditë e këtij cikli në frymën popullore janë vjersha mbi kohën (historinë) e shqiptarëve, mbi zgjimin e ri duke kujtuar një të shkuar të lavdishme. Interesimi i Lasgushit për të përmendur vende e data të rëndësishme të popullit, kombit të vet, nuk mund të jetë vetëm një interesim i romantikeve i bartur në programin e tij; por vetëdije e zgjuar e një poeti në një kohë, sepse kështu do të vazhdojë të këndojë poezia shqipe edhe mbas Lasgushit. Kjo mund të provohet më së miri me interesimin e Lasgushit për historinë: duke futur në tekstet e veta poetike Skënderbeun, Ismail Qemalin, Naimin, Asdrenin, poeti do të bëjë një udhëtim imagjativ nëpër të kaluarën e shqiptarëve duke u revoltuar në një faqe të kësaj historie. Këtë revolt e shpalon në një mënyrë të fuqishme dhe të çuditshme për mënyrën e shkrimit të tij në poezinë *Naim Frashërit*.

2. 3. Miti i Gjuhës. — Një nga pikat e programit reformues poetik të Lasgushit është edhe Gjuha. Gjuha e pastër shqipe dhe gjuha poetike. Prandaj, poeti saherë kthen shikimin mbrapa në trashëgiminë poetike shqipe, shikimi përherë i ndalet në krijimet e Naim Frashërit dhe në meritën e tij të madhe për

reformimin e gjuhës së pastër shqipe. Duke e pasë çmuar shumë një punë të tillë të parardhësit, poeti shpesh kur merret me problemin e shqipsisë së shqipes dhe të krijimit të një gjuhe poetike shqipe, të cilën e arrin me sukses të plotë, don të identifikohet me Naimin. Këtë gjë e bën më pashëm dhe me tezë të vënë para vetes në poezinë *Naim Frashërit*, të shkruar në gjashtëmbëdhjetërrrokësh, të cilës i vë mo- to dy vargje të vjershës së Naimit, *Fjalët e Qiririt*:

*E ku shkruhenë në kartë
Fjalëtë e gjuhës Zjartë?*

me të cilët vargje që në fillim shënon programin e vet dhe mundimin t'i dalë në krye një detyre të rëndë siç ishte çështja e gjuhës. Poezia është shkruar si për- kushtim Naimit, me rastin e përvjetorit të vdekjes. Nis me një përfalje poetit të njohur, të çmuar e të nderuar, për të himnizuar punën e tij poetike letrare, për të përfunduar po me një përfalje dhe një për- kujtim të tillë. Mirëpo kontrasti lind menjëherë në tekstin e vjershës dhe e gjithë vjersha është e ngritur mbi kontrastin e dy kohëve: Një kohë të vizionit poetik të Naimit dhe një të kohës konkrete të poetit Lasgush. Lasgushi duke kërkuar identitetin e progra- mit të vet në programin e një poeti të madh reformues romantik, domosdo edhe strukturën, më mirë skemën e vjershës, e ndërton në bazë të një fryme ro- mantike. Kohës së shkruar të lavdishme, le të ietë kjo edhe vetëm kohë e një vizioni poetik, i kundërvëhet një kohë e tashme, kohë konkrete. Kohës së shkruar i përgjigjet një shqipe pleqërishte e pasur dhe e pa- stër, ndërsa të tashmes një shqipe e mbushur me „fja- lë barbare”.

Liqjërata pleqërishte; Frumë e gojës shqipëtare; Këngë e orës shqiptare; Folja jonë pleqërishte; Ku- vend i Zogut, të gjitha këto: sintagma, formula poeti- ke, që i lexojmë në këtë vjershë, e të cilat në veprën

e Naimit dhe të Lasgushit shtrohen si tema të poezisë, po prisheshin. Ç'do të thotë të prishen këto? Për Lasgushin, do të thotë të priset kombi. Sepse edhe te ai si te shumë poetë shqiptarë Kombi dhe Gjuha mund të kuptohen e të qëndrojnë „shëndoshë” vetëm kur janë të bashkuara. Sepse për Lasgushin gjuha s'është vetëm mjet komunikimi në mes të njerëzve, gjuha s'është vetëm mjet që sjell informatën, gjuha nuk është vetëm gjuhë poetike... Do të thotë, për të gjuha është: *gjuhë, të folur, ligjërim*... dhe: *mit*. Gjuha është shpirti dhe mendja e njeriut; gjuha është njeriu vetë; gjuha është përvoja dhe vizioni i kombit; gjuha është vetëdija dhe ndërdija e tij; gjuha është identitet... Ajo është vetë njeriu që shqipton veten para vetes dhe para të tjerëve. Duke pasur këso bindjesh për gjuhën Lasgushi mund të këndojë me kaq dhembje:

Ligjërata pleqërishte sot ka vrarë vetëdijen

Pra, gjuha për konceptin e Lasgushit në këtë vjershë, është: *Ligjërim i lashtë; Këndim popullor, Gjuhë poetike... gjuhë e pastër shqipe*.

Idetë e veta mbi gjuhën Lasgushi i shihte të eksplikuara në tekstet poetike të Naimit, në temat e këndimeve të tij. Aty e shihte shqipen të thuhej e pastër dhe plot kuptim, prandaj në vjershë e shenjëzon si: *Kuvend me hir të perëndishmë; Kënaq të tenërlumtur; Flakë e kuptimin të kulluar Goië vjershëlore*... Kjo ishte gjendje e një shqipe të pastër në të shkuarën, si në këngën pleqërishte, si në gjuhën poetike të Naimit. Po gjuha e konceptit të Lasgushit po prishej e shprishej pikërisht në kohën e shkrimit të tij, të veprimtarisë së tij poetike aktive. Ajo tashi ishte vënë në gojë e atyre që prishnin kuptimet, që i derdhnin fjalët, i mashtronin fjalët duke i ndarë nga kuptimet e kulluara. Pra nga fjalët lindin mashtrimet, kur nga mosbindjet duhet të krijohen bindjet:

*Ku çdo gojë e djallëzuar, mbledhur fshehur
në pikë.*

Me një fjalë barbarije ze një vend në politikë.

Vetëm brenda këtyre dy vargjeve hetojmë një sarkazëm të pashoqe, ndërsa sintagmat e këtyre vargjeve që shenjojnë situatën e keqe për gjuhën shqipe janë antitezë e atyre që shqiptohen në frymën e përparshme të poetit, duke u gjetur të konkretizuara në artin poetik të Naimit. Tashi kemi:

*gojë e djallëzuar: klikë
fjalë barbarije: politikë*

Do të thotë, gjuhën e prishin njerëzit që janë të verbuar nga intereset e ngushta vetiake, nga një vend në politikë. Në këtë mënyrë problemin e gjuhës së Lasgushit të shtruar në këtë vjershë në kontekstin e treshit: Vend-Komb-Gjuhë e prishin edhe vetë njerëzit që do duhej ta zhvillonin atë, ta pastronin, plotësonin e forconin. Dhe pikërisht njerëzit e verbuar dhe të untuar për pushtet duke e prishur strukturën e këtij treshi nocionesh të lidhura e prishin edhe trupin e shpirtin e gjuhës.

*Me përbrendjen e shkrumbosur një poet
një deputet*

Flet e çflet e vret e pret për një t'vet virgjinitet

Brenda këtyre dy vargjeve që më duken ndër më ironikët në gjithë poezinë shqipe shtrohet kritika e Lasgushit mbi gjuhën, mbi gjuhën poetike shqipe të kohës, mbi krijuesin shqiptar të kohës në të cilën u shkrua vjersha dhe mbi poezinë shqiptare të asaj kohe. Pra, krijuesi është tjetërsuar nga gjuha e mirëfilltë e mëmës dhe nga gjuha si figurë poetike. Një krijues i tillë, të cilin e përmbys Lasgushi me kritikën e tij, duke dashur të jetë i angazhuar, ndoshta i angazhuar për të përfituar më shumë për veten,

humb identitetin e krijuesit. Nga gjuha e pastër shqipe krijon një „mumi egjyptiane”, në gjuhë fut fjalë barbarie, ndërsa nga krijimi poetik, poetika krijon politikë.

Lasgushi lucid, Lasgushi poet, që në vitet njëzet kishte hetuar thellësisht, se përkundër të gjithë Rilindasve shqiptarë, që fjalën poetike e bënin një me idealin kombëtar, tashti po vinte një kohë kur po destruktohej qenia e krijuesit, kur po copëzohej ajo: në dëshirën për shkrim dhe në dëshirën për pushtet; e kur të dyja po humbnin këto dhe „poeti”, „deputeti” po bëhej agresiv, që pret e vret për të treguar (o ironi) virgjinitetin, paprishjen e vet shpirtërore. Në këtë mënyrë po vritej vetëdija më parë, e gjuha dhe arti, më pastaj. Në këtë pikë poezia e Lasgushit është aktuale edhe sot, dhe gjithnjë.

3. Kënga e durimit

3. 1. *Motra : Shoqja : Vasha*. — Më tepër se gjysma e poezisë së Lasgushit është këngë për dashurinë. Edhe titulli i parë i librit *Ylli i zemrës* ishte *Vasha e Trim* dhe shenjonte dy protagonistët e dashurisë së vjetër shqiptare. Titulli i parë i këtij libri edhe tashi mund të jetë aktual dhe i dobishëm si ndihmës për leximin dhe interpretimin më të thellë të sistemit të këndimit mbi dashurinë të Lasgushit. Do thënë: poeti së pari e së thelli e këndon dashurinë të konceptuar si ndjenjë-fuqi-zjarr për bashkim njerëzish e për jetë, gjithnjë këndim në frymën popullore shqipe. Ky orientim është më i hetueshëm në disa poezi që në radhë të parë janë vetëm mbi-ndërtime të këngës popullore të dashurisë. Në poezinë *Balladë* cikli i udhëtimit dhe përbashkimit dashuror përgjasohet me ndërrimin e motit, me stinët:

Thotë vasha: a) ...lele ngriva; b) ...celi molla;
...bubu plasa; ...po venitem...

Edhe këtu, si kudo tjetër, Lasgushi këndon me sistem, kërkon të shenjojë ciklin e zhvillimit të ndjenjës: lindjen dhe vdekjen e saj. Mirëpo dashuria këtu nuk vdes, mbetet ndjenjë e pashuar, e përjetshme. Ky cikël këndimi vijohet edhe në këndimin e takimit të vashës me trimin:

*Ishe vogëlushe... Isha mituri / Ishe vashë
e rëndë... isha trim i ri...*

Këndimi i dashurisë në frymën shqipe hetohet edhe në shkrim / përshkrimin e vashës, e cila rëndomë del figurë popullore si: bel-hollë, sy-përmbysur-përdhe, sy-gjumashe. Vasha në poezinë e Lasgushit s'thirret vetëm vashë, po edhe *Shoqe*, shpesh e shpesh edhe *motër*. Ai i drejtohet vashës më shpesh: *o motra ime*, *o motr' e ëmbël!* Edhe vetëm shpjegimi i metaforës *motër* në kontekstin e kësaj poezie jep orientimin e poetit në këndimin e vashës e të dashurisë. Këtu *Motër* nuk do të thotë *motër* (motër/vëlla), po *motër: mater* (vashë/nënë); që është emërim i vjetër i vashës, dashnores, si grua, si nënë, si shoqe, përkujdestare dhe vazhduese e frymës së jetës së bashkësisë. Pra, gjithnjë e më i përafërt është koncepti i lashtë shqiptar i këndimit të femrës si një qenie që e mban gjallë dhe e vazhdon frymën e jetës. Të gjitha këto interesime mund të shihen në vepër po të sjellim një strofë nga vjersha *Këngë* e Lasgushit, e shkruar dhe e botuar diku gjatë Luftës, që në të vërtetë përmbledh konceptin dhe mënyrën e këndimit të tij të vashës:

*O! zjarr-e-mall-e-yll-e-emër-pa,emër,
Vashë-edhe-shoqe-e-motër-e-dashurisë,
Nuse-edhe-grua-femër-varrë-në-zemër,
Varr-edhe-zjarr-e-flak'-e-dashurisë.*

Vargjet 2 e 3 të kësaj strofe ilustrjnë mendimet e thëna më parë, ndërsa vargjet 1 dhe 4 shqiptojnë mënyrën vetanake të këndimit të dashurisë nga Lasgushi.

3. 2. *Ylli : Dashuria.* — Vargjet e përmendura sjellin figurat qendrore të këngës së dashurisë së poetit Lasgush: *zjarr, mall, yll, varr, zjarr, flakë*. Figura *Yll*, që del në vetë titujt e dy librave të poezisë së Lasgushit: *Vallja e yjve* e *Ylli i zemrës*, lidhet me dashurinë, këtë ndjenjë të përjetshme njerëzore, e cila edhe në titujt e librave edhe në gjithë veprën e tij projektohet në dy rrafshet kuptimi; në një anë dashuria si ndjenjë humanizuese, si frymë lëvizëse e jetës; dhe në anën tjetër dashuria si ndjenjë-fuqi e afrimit të Trimit me Vashën. Po të shkrihen dy titujt e librave duke e konsideruar figurën e Yllit si të eksplikuar do të fitojmë një sintagmë-figurë karakteristike simbas modelit të Lasgushit: *Vallja e Zemrës*, që është barazi me *Kënga e dashurisë*. Ylli del metaforë e dashurisë dendur në këtë poezi për t'u eksplikuar nganjëherë edhe vetë brendapërbrenda një vjershe:

Një yll përjetësije u ndes në shpirtin tim

— — — — —
Është yll i dashurisë q'u ndes në shpirtin tim

Poezia *Vallja e yjve* e quajtur poemë erotike-kozmogonike, është këngë mbi dashurinë dhe dashurinë për jetën, dhe jo rastësisht është e vendosur në ciklin *Zemra e jetës*. Vetëmse në këtë poezi dominojnë figurat e hapësirës (largësia pa kufi) dhe figurat e kohës së pakufi (përjetësia), nëpër mesin e të cilave shetit *Ylli i dashurisë*, me mision poetik humanizues, i cili herë është i mjerë e herë i lumë. Ky kontrast figurash karakteristik për këto poezi e sidomos një strofë:

Dashuri- Heu! Mall i ri!
Dashuri! këng'e durimit!
Ti liri! Ti robëri!

shqiptojnë origjinalitetin e këndimit të Lasgushit, që i këndon dashurisë si një *këngë të durimit*. Kon-

trasti *Ti liri / ti robëri* nuk përmbledh në vete figura me kuptime që kundërshtohen, kemi të bëjmë me një shkrirje, me një figurë konceptuale që shenjon bashkëjetesën e elementeve të shenjëzuara, që shpreh një situatë, e cila përnga domethënia na e kujton këngën e Bodëlerit për dashurinë si varrë e robërim (burri brutal dhe i robëruar); por Bodëleri është më i prerë në figurë, më brutal; Lasgushi më i përmalluar, më i megjulluar, më i fshehtë. Pra, dashuria në poezinë e Lasgushit këndohet si një varrë që për të mbetur gjallë përditë e do nga një lëndim të ri (dashuror). Është një *fshehtësi plot llaftari / plot ëmbëlsi vërerore!* Ndërsa vasha një qenie *dhembshkurisht e ëmbël*.

8. 3. *Malli : mërgimi shpirtëror*. — Kështu arrijmë te këndimi i dashurisë si një ndjenje të larguar, te largësia dhe ëndërimi i përmallshëm, gjakimi, *Malli*, njëra nga figurat-çelës të poezisë së këtij autori. Kjo fjalë në gjithë poezinë e Lasgushit e vënë në kontekste të ndryshme merr vlerë të ndryshme konotative: herë dëshirë e flaktë, herë gjakim, herë dishirim, por asnjëherë jo *epsh*, sepse poeti këndon për dashurinë duke gjakuar të krijojë përherë një figurë *fshehtësie*. Ndoshta për epshin do të vlente sintagma e shpejtë në poezinë *dashurore të Lasgushit: malli i zjartë*.

Dhemb malli-i-djegur-durim-plot

Mirëpo ndanë *Mallit* — figurë në këtë poezi e ndeshim edhe *Mallin* temë — nostalgjinë, si temë të mërgimit shpirtëror. Me të drejtë është konstatuar që heret se Lasgushi më mirë se çdo poet tjetër shqip-tar e ka ndierë peshën e vargut: *Me shkue do të thotë me vdekë pak nga pak*. Largimin nga atmosfera e këndimit të vet poetik, poeti e këndon si mërgim shpirtëror, si dhembje të pafund. Edhe në kontekstin e kësaj teme *Malli* merr vlerën konotative të nostalgjisë, po edhe të dhembjes, të durimit, të dëshirës për afëri me një qenie. Prandaj çdo shkrim i këtij tipi

për dashurinë është një përpjekje që nga largësia ta sprovonjë identitetin e vet, ta gjejë veten të projektuar në gjirin, shpirtin e vashës; ngase dashuria s'është tjetër pos projektim i një shpirti në shpirtin tjetër. Largimi shpirtëror nga një qenie e dashur shqipton dhe mbjen e ndarjes por edhe gjakimin për një bashkim të ri, së paku si gjakim këndim/shkrimi:

T'a nisim duke pshuar mërgimin zemërak

— — — — —
Më hidhur do t'na dhembti largimi jon'i ri.

4. Ligjëratë mbi përjetësinë

4. 1. *Cikli i krijimit.* — Në frymën e filozofisë, më mirë teozofisë induse, filozofisë së Vedave (që Lasgushi e njihte mirë) poeti shkroi ciklin e vjershave kozmogonike *Vallja e përjetësisë*. Në pesë këngët e këtij cikli bëhen përpjekje që të kapet cikli i krijimit të botës, duke nisur nga forma më primitive e materjes deri në shkallën e saj më të lartë të zhvillimit, në *shpirt*. Deri në shkallën sa të krijohet dysia: *materje-shpirt*, e cila dysi më pastaj shkrihet, bëhet një për të përfaqësuar qenien e plotë njerëzore dhe krijuese. Cikli i zhvillimit kalon nëpër shkallët: *Lënda, Fryma, Ndjenja, Njeriu, Përjetësia*, Të përshkuar nëpër një subjektivitet të theksuar të krijuesit, në të vërtetë janë shkallë të gjendjes së shpirtit-Zotit, që ndodhet kudo në natyrë, është vetë natyra, është i përmbajtur në çdo objekt, prandaj Zoti i Lasgushit nuk është zoti teologjik, por zoti që si në çdo gjë të natyrës është ndhe në vetë njeriun. Kjo teori e *shetisë së lirë të shpirtit* e njohur nga Vedat, e në poezinë shqipe përthyer edhe nëpërmes veprës së Naimit, te Lasgushi subjektivizohet në një shkallë të lartë e përthyer në sistemin e tij poetik. Pikërisht në këtë pikë nis vlera e vjershave të Lasgushit dhe hetohet munda i punës së

tij artistike. Gjakimi për prekjen e Zotit, këtij absoluti, në vargun e ciklit të krijimit të botës, mbetet vetëm mashtrim, nëse ky kërkim, nga gjakimi i absolutit në jashtësi, nuk kthehet nga kërkimi i absolutit në *vete*, në brendësi. Kjo sjell përfundimin se Zoti ndodhet në vetë njeriun, siç ndodhet kudo tjetër në natyrë. Kërkimi i vetes është i mundimshëm, i vështirë, dhe arrihet vetëm në një shkallë të *vetëharrimit* (*nirvana*) në të cilën relativizohet e subjektivizohet koha deri në një shkallë të pakufishme.

*Zot'i em që m'është armik
Gjith më ç'duket gjith më ik.*

Krijimi i kontrastit poetik në gjakimin për *vetëlexim, vetënjohje: zot: armik, sjell poetizimin dhe përtërhyerjen e gjithë problemit nëpër poetikën e njohur të Lasgushit, të cilës i shtrohet subjektiviteti i projektuar krijues:*

*Sepse në vetëveten të pata ndjerë, o Zot!
Mjerush të pata ndjerë në vetëveten time.*

vargje që shqiptojnë vetveten të njohur, të mjerë e të dhemshme, të plaguar nga komponenta krijuese subjektive. Gjakimi për këndimin e *ciklit të krijimit* (të botës) në jashtësi dhe krijimi i bipolaritetit Tokë / Qiell e Brendësi / Jashtësi, e lind kërkesën për këndim-eksplikim të *krijimit në brendësi*, të krijimit të njeriut — *krijimit poetik*. Në këtë shkallë të kërkimit ndihet bashkimi i ngadalshëm i nocioneve Poet : Zot, që aktualizon edhe njëherë teorinë romantike mbi origjinën hyjnore të poetit, mbi poetin, gjeni, zot.

4. 2. *Qenia e plotë*. — Mirëpo, poeti Lasgush synon qenien e plotë krijuese, që don ta bëjë në këngën e fundit të këtij cikli *Përjetësija*. Kjo këngë është në rradhë të parë ligjëratë mbi përjetësinë (poetike) dhe gjakon t'i pajtojë t'i shkrijë ndër *vete kundërshtitë*: Objekt : Subjekt; Përjashësi : Përbrendësi; si dhe Ndje-

një : Mendim, për të arritur në nivelin më të lartë të skemës Trup : Shpirt. Kënga në tërësi është kërkim i një totaliteti njohës-krijues nga aspekti filozofik, si dhe kërkimi i definimit të qenies krijuese, definimi i mendjes-dijes, duke u pasë projektuar vetë në Botën, do të thotë duke pasë prishur edhe dysinë Unë : Bota, për të arritur shkallën më të lartë të shkrirjes, përjetësinë. Kjo këngë është më e plotë dhe përmban në vete të gjitha fazat e ciklit të krijimit, të cilat duke u kënduar nga poeti subjektivizohen dhe me figura-koncepte precize shprehin aktin e krijimit poetik vetanë. Në këtë shkallë të kërkimit të qenies së plotë krijuese, prishen, shkrihen të gjitha kundërshtitë dhe fillon procesi i njohjes: vetënjohjes : krijimi. Kategoria e kohës relativizohet, humb shkallët reale, dhe i gjason kohës së krijimit përkufizimi dhe shenjimi i të cilës del i përsëritur tri herë në vjershë, që del si kohë e pandryshuar, kohë e përsëritur, e pafund kund:

*Jam sot
Si vjet
Si mot
Si përgjithnjë.*

Korrespondimi me jashtësinë krijohet nëpërmjet tri shkallëve: nëpërmjet *Trupit*, në këngën e parë; nëpërmes *Zemrës*, në këngën e dytë; edhe nëpërmjet *shpirtit* në këngën e tretë. Vështruar nga aspekti i poetikës këto tri shkallë të lidhjes me jashtësinë janë tri shkallë të krijimit poetik.

Në këngën e parë, ku të lidhurit me botën bëhet nëpërmjet trupit, afirmohen tri shqisa: të shijuarit, të prekurit, të nuhaturit që në teorinë e shtruar nga kjo poezi dhe në teorinë poetike të Lasgushit, janë lidhjet e para, më të cekta e më primitive me botën. Në shkallën e dytë të korrespondimit afirmohen dy shqisat e tjera: *të pamit* dhe *të dëgjuarit*, që në këtë proces nuk mbeten më vetëm shqisa po arrijnë shkallën e ndjesisë, mbërrijnë më thellë në qenien e një-

riut, dhe të bashkuara e japin *zemrën*. Në këngën e tretë arrijmë në shkallën e tretë të lidhjes, që është më e plotë, më e thellë dhe më e tërësishme, ajo përfshin më vete gjithë qenien. Është shkalla e *Shpirtit*, që e shtruar në terminologjinë e poetikës, i përgjigjet vetëdijes në krijim, shpirtit të vetëdijesuar krijimtar, dhe kjo, duke qenë shkalla më e lartë e krijimit, njëherit është shkalla më e lartë e të lidhurit me jashtësinë. Nga kierarkia e lidhjeve të krijuesit me jashtësinë, duke u nisur nga ato më primitivet, deri te ato më të plotat, siç u dha në vështrimin e mësipërm, përfitojmë konstatimin se të lidhurit e krijuesit me konkretësinë jetësore dhe me njëmendësinë janë më të plota, pikërisht në shkallën më të lartë të krijimit shpirtëror dhe të abstragimit krijues.

Rezultati i tri lidhjeve njohëse-krijuese me botën në këtë këngë është i dhënë në tri pjesët e saj:

1.

Pra ti shijon një pamë-ëmbëlsi,
Ti çik me dorë fluturën-stoli,
Ti merr me gas një erë-fshehtësi.

2.

Pra ti shëkon një pamje-bukuri,
Pra ti dëgjon një këngë-llaftari,
Pra zemra ndjen një ndjenjë fshehtësi.

Tri figurat konceptuale që dalin në të tri këto vargje: *pamje-bukuri*, *këngë-llaftari* e *ndjenjë-fshehtësi*, përkufizojnë aktin e krijimit poetik. Figura e parë e kap të bukurën në jashtësi, të bukurën në natyrë që i hapet syrit të krijuesit, figura e tretë shqipton ndjenjën e fshehtë që fitohet lidhur me këtë pamje të bukur të jashtme, ndërsa figura e mesme shpreh fuqishëm aktin e të krijuarit.

3.

*Pra ti kupton ah! ti s'kupton tashi,
Një mal-e-hon-e-det-ah! Uaftari,
Një gjell-e-djellë-e-boatë-ah! fshehtësi.*

Mirëpo ideali i lidhjes së fortë të qenies krijuese me botën dhe krijimi i qenies së plotë është shenjzuar në fundin e kësaj poezie të bukur, i cili del si fund formulë e kërkuar në gjithë ciklin e Lasgushit mbi krijimin si dhe në vetë poezinë *Përjetësija*. Këtu kundërshtitë janë shkrirë dhe bashkimij njihës-krijues është bërë i plotë për të krijuar një qenie të padestruktuar:

*Bashkohesh brënda me përjashtësi
Bashkohesh jashta me përbrëndësi.
Bashkohesh-ritesh-me-përjetësi.*

5. Vdekja e ëmbël

Në ciklin e vjershave mbi vdekjen Lasgushi krijon një triptikon poezish simbolike, për herë të parë në gjithë veprën e tij: *Gjeniu i anijes, Lundra dhe Flamuri* dhe *Vdekja e Nositit*. Filozofia e vjershave është mjaft eksplicite ndanë natyrës së tyre që janë të krijuara simbolikisht. Vdekja është akt që shpaguehet me të mirat që bëhen në jetë, siç shpaguehet flijimi për hir të idealit. Në këto tri vjersha dalin tri simbole në vetë titujt: Gjeniu, Lundra, Flamuri, dhe Nositi, që duke u eksplikuuar mengadalë në vjershë përmbledhin fijen e shpalimit të idealit të Lasgushit në jetë, në krijimtari poetike dhe në botëkuptimin e tij mbi krijimin e botën. Vetëm duke i lexuar këto vjersha mund të hetohet sa është e madhe fuqia e jetës në përçasje me vdekjen. Gjeniu, është simbol i krijuesit të humbur dhe të flijuar pa dhembje për idealin, është fati i krijuesit të kuptuar (më shumë të keqkuptuar, siç

është vetë Lasgushi); *Lundra dhe Flamuri* janë simbole të idealit, i cili e heq njeriun përpara në jetë, dhe flijimi i ëmbël në emër të tij:

*Flamur i pastër që m'u nxi
Në sulm të lumtur për liri,
Qëndron gazmor në lartësi!...*

Përnga struktura e paraqitjes së shenjave poetike dhe për nga kuptimi i shenjave të zgjedhura të tri vjershat janë të ngjashme. Mirëpo, artistikisht më e fuqishme dhe më e realizuar është poezia *Vdekja e Nositit*. (Ndoshta këtu menjëherë do dhënë një shpjegim, që s'duhet të jetë i tepërt dhe s'do ta vras vlerën poetike të vjershës: Nositi është shpend i bardhë i liqenit që me sqepin e vet shkyen gushën dhe me gjak i ushqen zogjtë e vet). Kjo poezi është e shkruar në vetën e parë, si monolog, ku subjektiviteti i poetit është transponuar, drejtpërdrejt në materien e vet, në tekst; nuk ka ndërhyrje indirekte përshkruese, në fillim ose në mbarim siç ndodh me dy vjershat e tjera. prandaj nga një anë fiton dramaticitet më të lartë të shqiptimit poetik e nga ana tjetër na le ta lexojmë qenien e krijuesit të bartur, të shkrirë të tërën në tekst, ku figura dhe i gjithë teksti dalin si klithmë e dhembjeve dhe e mendjes së tij. Vetërrëfimi i Nositit (Poetit) nis me fjalët *zjarr, varr*. Pra strofa e parë krijon atmosferën e dhembjes e të flijimit që shprehet me rimat *-arr* që shenjojnë dhembje e lëvizje si dhe me kuptimet semantike në radhë të parë dhe konotacionet në radhë të dytë të fjalëve: *zjarr; varr*. Vazhdon strofa e dytë me rimën *-ak* me një *a* maksimalisht të hapur dhe me një *k* maksimalisht të mbyllur që shpreh dhembjen e thellë e cila shqiptohet përndryshe nuk mund të marrë jehonë. Në vijim del kënga e flijimit në të cilën dalin konceptet-figurat e Lasgushit: *dashuri për Uaftari*, dëshirë, gjakim për vetëflijim për ushqimin e trashigimtarëve. Akti i përshkrimit të shpërthimit të gjirit shprehet

me aliteracion, me shqiptimin direkt të klithjes *ah!* e cila përsëritet me radhë në të tri vargjet, ndërsa ekspresiviteti i situatës jetësore të përkthyer në tekst shprehet me rimën e futur: *godas, ças, gas.*

*Pa nis ah! gjirin ta godas... ,
Dh'e hap ah! gjirin më një ças... ,
Dh'i nginj ah! zogjtë-e vdes me gas!...*

Vargu i fundit i kësaj strofe është vargu qendror i vjershës dhe moto e vdekjes së ëmbël për një ideal. Këtu është përmbushur ideali më i madh njerëzor si kërkim i ushqimit për trashëgimi, me gjak jetësor, po edhe me kulturë shpirtërore. Vetëm pasi të jetë mbushur ky ideal vdekja mund të bëhet e pavajtuar, prandaj Nositi mund të klithë: *vdes me gas*. Malli-dhembja e vetëflijimit pastaj shtrihet si jehonë dhe disponimi i saj do të gjejë ekvivalentin e vet në jashtësi, në *liqe*, që është koncepti mbi të cilin poeti i ngreh problemet më të mëdha të metafizikës: *jetën, vdekjen, lëvizjen, qenien*. Rimat e strofës: *shkund, mund, fund* e thonë depërtimin sa më të thellë në vete në aktin e flijimit dhe jetojnë në vjershë si jehonë që del nga mbrendësia e plaguar për t'u përhapur si jehonë që do të ikë në lashtësi.

*Poezia fillon dhe mbaron me vargun:
Me zjarr ju flas, me zjarr.*

vetëm me cezurë të ndërruar, i cili varg sado figurativ më vete, në kontekstin e vjershës është i ngarkuar me funksion retorik, apelativ, si kërkesë e autorit drejtuar lexuesit, si thirrje për identifikim me situatën e shenjëzuar në vjershë. Kjo poezi, si dhe dy të parat, është e ndërtuar mbi një simbol dhe fuqia e madhe e tyre shprehëse është aliteracioni, metafora dhe rima e puthur në strofat trivargjshe. Ndërsa vetë poezia *Vdekja e Nositit* na e rrëfen na-

tyrën e krijuesit Lasgush që përkundër të gjitha të thënmeve nuk ishte *Albatros qesharak* por një *Pelikani i flijuar*.

6. Arti poetik

6. 1. *Frymëzimi* — *përqëndrim*. — Kategoria e frymëzimit, kaq e theksuar te romantikët, kaq e përmendur, e diskutuar e më shumë e dashur përthuhet edhe nëpër veprën e Lasgushit. Lasgushi duke ia pasë kushtuar drejtpërdrejtë katër vjersha këtij problemi, jo rrallë është quajtur poet mistifikues i frymëzimit, glorifikues i tij dhe së fundi njeri që ka shkruar pak duke pritur frymëzimin hyjnor që nuk i vinte shpesh (sic!). Mirëpo arsyeja, motivi që Lasgushi do t'i shkruante edhe këto katër vjersha nuk mbështetet në dëshirën e autorit për mistifikime as për mjeguallime por në kërkesën e tij që në gjithë librin e vet donte të krijonte një sistem poetik të shenjuarit shqiptar të botës përreth, po edhe të vetes në radhë të parë, pra edhe të krijuesit e të krijimit. Në këtë vijë të shënimit të *momenteve* të krijuesit në procesin e shkrimit, e shenjon edhe momentin kur njeriu është qenie e plotë dhe do të flasë, të klithë, pra një moment që më shumë është përqëndrim se sa nxitje, kur del

*Prej gjirit t'im të përvëlur
Fjalim' i mallit t'im mjerush*

Nuk duhet të habitemi nga fjalët *Zot e Shpirt*, sepse siç është parë edhe më parë në tekstin interpretues ato nuk kanë kuptimin e tyre religjioz dhe nuk kërkojnë eksplikimin e dëshirës fetare por në poezinë e Lasgushit kanë para së gjithash kuptimin e përqëndrimit dhe afrimit maksimal nga vetvetja. Vetëm në një shkallë të tillë përqëndrimi fjalës së palosur i hapen kindet, vetëm në këtë pikë: *thyer pak e zë të shkruaj*, e shkrimi do të zgjasë:

Kur një dit'e kur një muaj

— — — — —
Ndjej në gjit një këngë gjaku,

Kjo është shkalla qenësore e përqëndrimit kur lidhja me jashhtësinë është shumë e fortë, qenia është e hapur në një: *Zjarr, që djeg në shkrepëtimët*. Ku mbarojnë tundjet e qenies dhe harku i ndriçimit zvogëlohet, erret shikimi, nuk duket qielli, dheu e gjithësia, të gjitha këto tema të preferueshme të Lasgushit për të përkufizuar kosmosin e jashtëm dhe mikrokosmosin e qenies njerëzore:

*...S'është gjë: veç yll'i vetë
Më s'më djeg në krahëruar:
Unë shoñ me gas të qetë
Këngëzën e përvëluar.*

Ylli i vet, do të thotë kënga e gjakut, ylli i zemrës, më s'e djeg krahërorin, sepse bëhet tekst, *këngë e përvëluar*. Kjo sintagmë e përsëritur edhe më në veprën e Lasgushit, këtu përkufizohet si shpagim i një mundimi krijues. Krijimi, siç na thuhet në këto vargje, është një çlirim i autorit, një zhgarkim i barrës shpirtërore, është një katarzë, spastrim, që bëhet me mundim duke u përcjellë nëpër procesin krijimtar. I gjithë ky proces është përcjellë në vjershat *Shpirtit dhe Ri mbështetur në tryezë*. Ndërsa rezultati i spastrimit, i shqiptimit të shqetësimit vetanëk është *kënga e përvëluar*.

6. 2. Bukuri llaftare. —

*Bukuri! tmerisht e dashur, llaftari! tmerisht
e bukur,*

që në thelb është vazhdim i këndimit lasgushian të procesit të krijimit artistik dhe në vete eksplikon mënyrën e lindjes së: *këngës së përvëluar, këngës së zjarrtë, këngës së kulluar, këngës së llaftaruar*, është

varg i diskutuar më së shumti dhe më së shumti është keqtrajtuar. Tema të këtilla mbi shkrimin poetik që i ndeshim të futura në shumë vjersha të Lasgushit në kontekste më të ndryshme, në vargun e cituar e të diskutuar gjejmë një formulim të saktë lasgushian me një thënie të fuqishme poetike. Vargu përbëhet nga dy pjesë dhe përmban: (1) Programin e një krijuesi që do të shkruajë poezi dhe, (2) Flijimin e tij për të krijuar art:

1. bukuri (tmerisht) e dashur
2. llaftari (tmerisht) e bukur

Pjesa e parë mbledh gjakimin e krijuesit, dëshirën, mallin, dashurinë për të krijuar dhe përmban dy nocione-figura: *bukurinë e dashur* që në poetikën e Lasgushit nuk është vetëm dashuri, po më së shpejti përgjasim me dikend, përpjekje për të qenë një me diçka të afërme; do të thotë të jeshë një me *bukurinë; të krijosh të bukurën*, — artin poetik — — poezinë. Fjala *tmerisht*, të cilën për arsye të interpretimit e mbyllëm në kllapa, shpreh një intensitet në shkallën superlative, kulminative të dashurisë, dëshirimit dhe është për afërsisht përfaqësim figurativ i afektivitetit në të krijuar (-llaftari).

Pjesa e dytë përmban flijimin, mundimin për ta krijuar të bukurën, artin e këngës, me të cilën do të bashkohet krijuesi. Është procesi i krijimit dhe i flijimit. *Llaftaria*, njëra nga figurat celës të shenjimit të superlativitetit të intensitetit shpirtëror, e pranishme në të gjitha temat e shkrimeve poetike të Lasgush Poradecit, del edhe në këtë varg-program dhe eksplikues të këtij programi. Llaftari... e bukur. Flijimi dhe vetëflijimi, do të thotë shqiptimi i votës në këngë sjell të bukurën e gjakuar; flijimi në shkrim është i bukur.

Nga interpretimi i këtij vargu, jo formal, po semantik-poetik, eksplikohet poetika e Lasgushit, të cilës ky autor do t'i mbetet më konsekuent se çdo-

kush tjetër në poezinë shqipe, siç shihet nga leximi i veprës në tërësi, nga rezultatet e krijimeve poetike të tij, nga variantet e fjalëve e të vjershave, nga kërkesa që prej fjalës të nxjerrë maksimumin e thënies.

6. 3. *Sintagma poetike*. — Rëndom kur flitet për gjuhën e Lasgushit përmendet fjalori i tij poetik i pasur dhe maksimalisht shqip; se Lasgushi ua ka shkundur pluhurin e harresës shumë fjalëve të vjetra shqipe duke i semantizuar dhe rikuptimzuar në poezinë e vet; se ka një fjalor të pasur dhe të pastër. Domethënë rëndom theksohet të zgjedhurit e shenjave poetike, *paradigma* e tij poetike, e gati përherë është harruar bashkimi dhe vënia e këtyre elementeve shenjuese në një strukturë, sistem ku do të shpalohej kuptimet e tyre të reja, domethënë *sintagma* poetike.

Së pari: poeti e ngarkon fjalën emocionalisht deri në maksimum duke kërkuar ta bëjë gjuhë të zjarritë. gjuhë të zemrës, që nënkupton gjithnjë një ngarkim emocional të plotë dhe një subjektivitet të projektuar fuqishëm në tekst. *Së dyti*: duke bërë zgjedhjen e fjalëve krejtësisht shqipe në gjuhën e shkrimeve të veta i nënshtrohet idealit për të krijuar një gjuhë shqipe të bukur e të kulluar, një shqipe poetike. *Së treti*: kurdoherë nga fjala do ta nxjerrë maksimumin e thënies e të sugjerimit duke e lënë fjalën vetën, por më shpesh duke e vënë në kontekst të fortë poetik në varg e në vjershë, duke e vënë në kontekst kontrastik. *Së katërti*: kur nga fjalët shqipe don të krijojë nocione që këto, si të vëtmë, s'mund t'i shprehin krijon lidhje sintagmatike, sintagma-kompozita për të shprehur një nocion, vështirë të shprehshëm në shqip, apo për të shenjuar gjendjen shpirtërore të pacopëzuar:

dhemb-malli-i-i-djegur-durim-plot,
vashë-edhe-shoqe-e-motrë-e-dashurisë.

Së pesti: funksionalizon shenjat e pikësimit duke krijuar cezurat, pushimet, sugjerimin e një mënyre të leximit të tekstit, ngritjet dhe rëniet e mënyrës së shqiptimit të tekstit; do të thotë tekstin e kthen fiktivisht në një fjalë të folur, pra krijon iluzionin e tekstit si këngë. Në rastin tjetër pikat i funksionalizon për hir të tekstit të humbur, tekstit të heshtur, të cilin njeriu e lexon më vete, simbas mënyrës së vet dhe mënyrës sa mund të bashkohet me të. Të gjitha këto thonë se Lasgushi poet e ka krijuar vetë lexuesin e vet dhe i ka dhënë udhëzimet e veta për lexim. Së gjashti: duke kërkuar maksimalen e thënies, Lasgushi nga fjala kërkon kuptimet, konotacionet e rrokjes e të fonemës, prandaj në poezinë e tij del aqë i funksionalizuar aliteracioni:

Flet e ç'flet e vret e pret për një të vet virgjinitet

Së shtati: sulmin emocional e projekton në tekst më së miri me rimat dhe ritmin. Sidomos është e pranishme rima *-ak*, në të cilën *a*-ja maksimalisht e hapur ndiqet nga një *-k* maksimalisht e mbyllur: për të shqiptuar më së shpeshti dhembjen, flijimin, që sugjeron një skenë semantike *klithje-pushim*.

6. 4. *Variantet*. — Puna e papreshme krijuese e Lasgushit dhe vetëdija e tij krijuese bëhet më e qartë dhe më e pashme, po të shikohen dorëshkrimet e tij, më mirë po të lexohen variantet e vjershave të tij. Ky poet nganjëherë krijon deri në katër variante të një vjershe. Duke ndjekur variantet e vjershave të tij hetojmë interesimin e përhershëm të poetit, që gjuha poetike e shkrimeve të tij të jetë sa më e pasur, vargu sa më i rregullt dhe të kumbujë sa më shqip, ndërsa shprehja sa më precize. Do të thotë, poeti, me sa mund e kërkon dhe krijon figurën, po me aq mund kërkon një mënyrë të mundshme të qartë të leximit të saj. Variantet nganjëherë në veprën e tij janë si forma të dyta të leximit të

vjershës së shkruar njëherë më parë. Kështu në vjershën *Naim Frashërit*, të botuar më 1925 lexojmë vargun:

Gjuha: goja! Gjuha: fjala! Gjuha: zemr'e kombësisë

Po ky varg në varianten e kësaj vjershe të botuar në librin *Vallja e yjve* del në formën:

Gjuha : goja! Gjuha : fjala! Gjuha: zemr' e

Pra, si shihet në varianten e dytë është interpretuar varianta e parë, është eksplikuuar, figura është kthyer në një figurë tjetër interpretative. *Gjuha-goja* (= të folurit, ligjërimit popullor) dhe *gjuha-fjala* (= gjuha e shkrimit), japin *yllin e vjershërisë*, në varianten e dytë, pra eksplikohet mënyra e krijimit poetik të Lasgushit dhe lidhja e tij me trashëgiminë gojore e të shkruar që përkthyer në krijimin e tij poetik. Një interpretim të ngjashëm ndeshim edhe në vargun:

Shpirt-lanet sa uj'e det flet mbi të vet virgjinitet,
që në varianten e dytë del:

Flet e çflet e vret e pret për një të vet virgjinitet

Kështu metafora e parë *Shpirt-lanet* është interpretuar me një frazë retorike, që përmbledh krimin e mashtrimin (flet e çflet e vret e pret), ndërsa fuqia poetike i shtrohet aliteracionit. Nganjëherë variantet e vjershave janë vetëm shkallë të shkrimit, krijimit, për të gjetur formën më të përshtatshme e funksionale të shprehjes dhe precizitetin e figurës, do të nënë nëpërmjet leximit të tyre mund të kërkojmë gjenealogjinë e figurës. Ja për shembull në variantet e vjershës *Lamtumirë*, njërin nga vargjet qendrore e gjejmë në tri trajta:

1. *Zbret Yll'i të riturit t'im*
2. *Vdes Yll'i të riturit t'im*
3. *O vashë-e të riturit t'im.*

Këtu pra hetohet mënyra e shenjzimit poetik të një dashurie që humbet, venitet, nga një figurë përgjithësuese, duke u afruar deri te shenjzimi direkt i konceptit, objektit që shkruhet. Nganjëherë puna në variante bëhet për të intensifikuar thënien apo për ta përgjithësuar e plotësuar domethënien e vargut: *Në zemër të plasur / Në shpirt të shkretuar* është një varg me format që merr në dy variante të një poezie. Mirëpo ka edhe raste kur variantet, nuk janë vetëm ekspikim i njëra tjetrës, as ushtrim për shkrim, por të gjitha së bashku krijojnë një figurë, apo një rrjetë semantike figurash, që krijojnë një tërësi poetike dhe mund të kuptohen drejt vetëm nëse lexohen të tri variantet si një tërësi poetike. Kështu, në variantet e vjershës *Më zu një mall*, që është e shkruar tri herë, njëra nga rimat në të tri variantet është me *-ot*, përderisa rima tjetër në secilën nga variantet është e ndryshme dhe përherë tingullisht e sforcon dhe semantikisht e thekson të njëjtën fjalë me të cilën krijohet:

1. *vuaj* — 2. *vetë* — 3. *fare*

Kështu të tri fjalët e theksuara aq shumë në tri variantet e krijojnë një fjali, së bashku, që shpreh fuqishëm gjendjen e një të mërguari, të mërguari shpirtërisht, gjë që është temë e vetë poezisë.

6. 5. *Sistemi poetik*. — Gjakimi i parë i Lasgush Poradecit, pos shkrimit të poezisë me vlerë veç e veç, është krijimi i një sistemi poetik vetanak. Prandaj, për veprën e tij poetike, më duket mua, duhet të flitet e të shkruhet në rradhë të parë duke u nisur nga ky sistem. Sepse mund të ndahet ndonjë poezi

si e vetme dhe duke qëndruar si e tillë e vetmuar mund të ketë vlerë më të madhe se një tjetër, mirëpo vlera e çdo poezie të tij hetohet drejt vetëm si e inkuadruar në këtë sistem poetik, që është mjaft i fortë dhe origjinal. Kështu që edhe nuk është punë që bëhet kurr me sukses nëse ka përpjekje që të flitet mbi një klerarki të vjershave të Lasgushit, në bazë të vlerës së tyre, prandaj Lasgushi mund të lexohet drejt vetëm si i plotë. Edhe interpretimi i nocioneve themelore që shenjojnë botëkuptimin e Lasgushit, si dhe interpretimi i nocioneve-figurave qendrore të poezisë, mund të bëhet drejt vetëm në kuadrin e këtij sistemi, në kuadrin e tij kuptimsohen dhe stabilizojnë domethënien qendrore, sepse në kontekste të vjershave konkrete mund të kenë edhe konotacione të ndryshme, jo të njëjta.

Gjakimi i Lasgushit për të kërkuar një sistem poetik të shkrimit, hetohet në të parë edhe kur të lexohen dy librat e tij veç e veç. Të dytë janë të ndarë në cikle që korrespondojnë mesveti, prandaj nuk është punë e vështirë dhe e paarsyeshme që këto cikle të shkrihen në njëri tjetrin, duke u bazuar në lidhjen e tyre të fortë në mesveti, dhe të krijohet libri i tërësishëm i Lasgushit. Në këtë pikë të gjakimit të krijimit të një sistemi origjinal poetik të përsosur, vepra e plotë poetike e Lasgushit na i kujton sistemet poetike të Dantes, Bødëlerit, Valerisë, Stefan Georges. Në poezinë shqipe, edhe sot, nuk ka poet që do të ketë krijuar një sistem kaq të mëvetësishëm e kaq origjinal si Lasgushi. Edhe kjo është një vlerë e pamohueshme e veprës së tij.)

II. FUSNOTA

Poezinë e Lasgush Poradecit e ka përcjellë kritika letrare shqipe edhe në kohën kur kjo është botuar nëpër revista e publikime të ndryshme edhe mbas daljes në libra të veçantë. Mirëpo, edhe sot

në shqip nuk kemi një shkrim kritik-monografik mbi veprën poetike të tij. Këtu vetëm po përkujtojmë idetë që shprehen në disa nga artikujt kritikë mbi veprën e tij, që në një mënyrë kanë ndikuar në formimin e mendimit të lexuesit shqiptar mbi veprën e këtij autori. Shkrimet po i përmendim kronologjikisht siç janë botuar në një rrjedhë kohe prej një gjysmë shekulli.

1. (1929, *Gazeta e re*, 22 shkurt, fq. 3.)

Në këtë numër të gazetës botohet artikulli i Eqrem Çabejt: *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit*. Në krye të artikullit Çabej pohon: „Po sa di vetë, gjer tani kurrkush nuk është marrë estetikërisht me poezinë e Lasgush Poradecit-“, prandaj në vazhdim mundohet ta plotësojë këtë boshsi në mendimin kritik mbi këtë poezi. Në këtë rrugë të gjakuar autori nis duke e nxjerrë personalitetin krijues të Lasgushit duke e krahasuar me poezinë shqipe dhe poetët shqiptarë në një anë dhe me poetët modernë të Europës në anën tjetër. Asokohe poezinë shqipe e vështron të ndarë në dy periudha. Në të parën hyjnë poetët e Rilindjes me në krye De Radën e Naimin, të cilët mirreshin më shumë me ndezjen e zjarrit për lirinë e Atdheut, dhe në poezi merreshin më shumë me çështje etike, i cili orientim nganjëherë kalon në zonat e religjionit. Në periudhën e dytë vijnë poetët që shkruajnë mbasi Shqipëria ta ketë fituar pavarësinë, te të cilët „...ideja kombëtare i le udhën idesë njerëzore“. Poetët merren me „vegime më të thella“. Këtu nis poezia moderne shqiptare me përfaqësuesit e saj të parë Asdrenin dhe Lasgush Poradecin.

Çabej jep dhe një pasqyrë të poezisë moderne të kohës në Evropë: Në Gjermani, Rilke e Stefan Geor-

ge; në Francë: Bodëleri, Verleni, Rembo e Valeri; në Itali, D'Anuncio e Paskoli, në Rusi, Jesenini. Bir të kësaj kohe e sheh dhe Lasgush Poradecin. Në vijim të artikullit shkruan: „Lasgush Poradeci na hap portën e një jete të re në poezinë shqiptare, një „frisson neuf” siç pat thënë V. Hugo për vjershat e Baudelaireit, lind e rritet në lëmën e këngës shqiptare një stil i ri, të cilin do ta kërkosh më kot ndër poetët e tjerë shqiptarë, po më kot edhe ndër shkrimtarët e huaj nga shkaku i origjinalitetit që shquan këtë poet djalosh. Këtu ndjenja e mendime që nuk kish guxuar e s’kish arritur kurrkush nër Shqiptarët e pëndës t’i çfaqte, këtu një stil i munduar, i cili ndryshon nga shkrimi i një Naimi..., si bie fjala, një pjesë bettoveniane nga një mozartiane. Ky pra është stili modern, stili i Lasgush Poradecit”.

„Ç’e ndryshon nga të parët është thellësia... Esh-të vjershëtori më i thellë që ka shkruar në shqipet; në qoftë se kjo nuk është vënë re gjertani, shkaku është se më të shumët nuk e kuptojnë poezinë e tij, e cila me fjalë e mënyra foljesh fare të thjeshta, e shumë herë popullore, arrin të koncentrohet aq sa mundet të nxjerrë në dritë mendimet më të thella, ndjenjat më labirintike, idetë më të larta. Dhe po të këndohet Lasgushi me dashurinë, do të vërtetohet thellësia e tij e pashoqe, në mos sot, nga brezat që do të vijnë”.

Pra, si shihet, Çabej vë në plan të parë origjinalitetin e Lasgushit, të lidhurit e tij me poezinë shqipe po dhe hapin e tij në pasurimin e saj. Pra, dallimin e Lasgushit nga paraardhësit e sheh jo në gjuhën poetike, siç do të thuhet shumë herë më vonë, por në thellësitë e ideve, në ndjenjat labirintike. Shi atëherë, duke e hetuar thellësinë e vjershave të Lasgushit, Çabej e hesht tezën mbi mundësinë e leximit të gabueshëm të tij, apo të pamundësisë së leximit në mesin e konzumentit shqiptarë të poezisë, i cili më

shumë i pëlqen vjershat si „Kroi i Poradecit” se sa vjershat e thellësive të ideve. Në vijim të artikullit ky problem është kapur dhe më hapur: „Po moskuptimi i lehtë, errësia e disa vjershave të tija, nuk është një e metë, përkundrazi një element i gjithë shkri-meve të thella në botë që prej poemave indiane e, nëpër Kuranin, gjer më sot. Fundi i fundit çdo thellësi është e errët. Dhe faji s’është aq’i gjeniut sa i publikut mendjeshkurtë. Vlera e mendimeve të Çabejt mbi vjershat e thellësive të Lasgushit do të jetë aktual edhe më vonë në rrjedhën e kohës, madje edhe sot, sepse ky grup i vjershave të poetit tonë të njohur kurr nuk është kuptuar, mirëkuptuar e interpretuar si duhet deri më sot. Mendimi më interesant në këtë artikull më bëhet ky: „Një tjetër send karakteristik për të: ky është poet lirik në kuptimin më të vërtetë të fjalës: nuk do të gjesh të ëmbla e të buta melodi; më shpesh vjershat e tija janë drama dhe shumë prej syresh tragjedi të vogla; shquan prologun, aktin e parë të dramës, kulmin e dramës, pastaj, si vala e detit e „këngës pleqërishte, bie, bie, bie, pasi pat luftuar shpirti i munduar...” Kjo tezë e thënë kaq heret mbi Lasgushin jo poet të vërtetë lirik, që duket shumë interesante si ide, nuk është zhvilluar asnjëherë në interpretimet e mëvonshme të Lasgush Poradecit, ndonëse tashti më bëhet, se po të ndiqet kjo ide në interpretim mund të japë rezultate të rëndësishme.

Eqrem Çabej, në shqyrtimin e poezisë së Lasgushit dhe të vlerave të saj, e shihte këtë poet ... „të cilin Shqipëria do t’ia falë njëherë botës”. Ky parashikim i tij nuk është realizuar as sot, por jo pse nuk ka vlera Lasgushi, po në një anë për shkaqe jashtletrare, e nga ana tjetër për shkak të problemeve që nxjerr përkthimi i suksesshëm i poezisë së tij. Që të dalë Lasgushi në botë duhet ta ketë pranë një përkthyes të lartësisë së vlerave të tij poetike.

2. (1932, *Minerva*, nr, 4-5)

Nonda Bulka boton një artikull të shkurtë me titull *Horizonte të reja të letërsisë kombëtare*, në të cilin parabolikisht don të hetojë momentin e atëhershëm të krijesve të rinj duke u përpjekur ta lidhë këtë me momentin shoqëror të vendit dhe të kohës. Për Lasgushin shkruan: „Lasgushi nuk ka hedhur sytë rrotull tij për të parë njerinë që rjep njeriunë, vëllanë që vret vëllanë. A nuk ka parë se si virtyti zhduket dhe thëthitet prej interesit? S'ka kuptuar se ati e do të birin për interes, se „qendra e gravitacionit” të çdo veprimi njerëzor është interesi?... Qan, lëngon dhe shfrynë poeti një dashuri të demoduar dhe anakronike. I lutet një Perëndije pa ditur mirë ku e ka banesën kjo Perëndi. Përpëlitet zall më zall dhe pastaj...”.

Si shihet nga ky apostrofim parabolik, autori don ta bërë artin një me jetën, ta vlerësojë me kritere jashtletrare, me kritere të realitetit, dhe nga poezia kërkon një ndikim të shpejtë, të atypëratyshëm, që do të thoshte ta zbriste poezinë në nivelin e pamfletit, të artikullit të gazetës.

3. (1936, *Knjiga o Balkanu*, I, f, 347)

Skender Luarasi boton një artikull panoramik në serbokroatisht me titull *Moderna književnost u Arbaniji* (Letërsia moderne në Shqipëri), në të cilin shkruan për Lasgushin: „Nëse tashti kalojmë në letërsinë më të re shqipe, ne pa farë luhatjesh do t'ia jipnim palmën poetike poetit tonë më të ri, që quhet Lasgush Poradeci (1899), poetit të pastër dhe filozofit të merituar. Vargjet e tij të përsosura nuk pranojnë kurrëfarë vërejtjesh sa i përket formës. Më tepër me origjinë proletare, ai ka mundur të ngritet përmbi këtë jetë dhe të bëhet artist në kuptimin e plotë të fjalës, duke krijuar në njëfarë „lar-

purlari", duke shpaluar në vjershat e veta botën e ndjenjave dhe të ideve. Ai kalon përtej kufijve tanë politikë. Prandaj niset të kërkojë inspirimet e veta poetike, jo vetëm në poezinë gojore shqipe, por në poezinë gojore në përgjithësi.

„Lasgushi i ka ndarë veprat e veta në cikle. Poezitë e tij erotike zënë vend në ciklin e katërt. Në mesin e kaq motiveve nga të cilët dridhen telat e lirës së tij, të përmendim nostalgjinë e shkuarjes në vjershën „*Partir, c'est mourir un peu*” (me shkue do të thotë me vdekë ngapak), të cilën poeti ynë e ka ndierë më shumë se çdokush tjetër.

„Duhet të theksohen edhe dy seri të poezive të tij filozofike nga të cilat njëra ka titullin „Vallja e përjetësisë” e tjetra „Vallja e vdekjes”. Si shihet autori, në një tekst konstatues prek disa nga temat e Lasgushit, motivimet dhe përsosjen e krijimit të vargjeve. Shkrimi, pra është shkruar mbas daljes së *Valles së yjve*.

4. (1937, *Ylli i zemrës*, mbasthënie)

Mitrush Kuteli, si përkujdesues me rastin e botimit të këtij libri, shkruan parathënien e librit me titull *fjala e editorit*, në të cilën, nga një anë jep shënime mbi veprat e Lasgushit, me rastin e botimit, shënime mbi kohën kur dhe ku janë botuar veprat e tij, mbi mënyrën e komponimit të librit, nërsa në pjesën e dytë të këtij shkrimi i bën një vështrim veprës poetike të poetit. Shkrimi i Kutelit mbi Lasgushin mbetet, edhe sot, ndër shkrimet më të plota dhe më të suksesshme. Ky është një shkrim *parafrazë* e veprës poetike të Lasgushit. Autori niset kryesisht nga shpalimi i formës së poezisë së këtij autori, duke e konsideruar formën si element primar në krijimet poetike, për çka do të kritikohet më vonë. Autori në një rast shkruan: „Sa për stilin ky nuk është përveç se mënyra e rradhosjes së fjalëve në

vargje". Ky përkufizim i stilit ndoshta mund të jetë edhe moto që është ndjekur në vështrimin e tij kritik. Shkrimi përqëndrohet në paradigmen poetike të Lasgushit, e kurrnjëherë në sintagmën, ndërsa edhe kur bëhet kjo bëhet në mënyrë tepër përshkruese pa e pasë gjetur deri në fund funksionalizimin e formave në poezi dhe vlerën e tyre poetike. Kuteli përpiqet të flasë me gojën dhe me gjuhën e Lasgushit, do thënë gjatë shkrimit mrekullohet me poetin. Prandaj, edhe interpretimi i temave dhe i problemeve që shtron poeti në poezinë e tij, bëhen duke i emëruar ato njëherë, duke i shqiptuar bashkë me poetin, për të shtrirë ndonjë koment. Janë interesante të përmenden këtu dy konstatime të këtij shkrimi: 1) „Lasgushi është poet shqiptar, i vetmi poet shqiptar, që mendon, flet e shkruan shqip”, mendim që do të gjejë diskutim në një artikull të mëvonshëm të Kristë Malokit; dhe 2). „...kur gjendet brenda realitetit Poeti nuk është në elementin e vet pikërisht posi „albatros” i Baudelaire -it”. Këto dy konstatime, sidomos ky i fundit, eksplikojnë frymën e shkrimit të Kutelit, që pos analitik, do të jetë në rradhë të parë himnizues dhe mrekullitar për poetin, edhe në rastet kur gabon thellë dhe i ik pikërisht intencës dhe programit poetik të Lasgushit. Teza se Lasgushi nuk është i lidhur me realitetin, përsëritet pavetëdijshëm edhe këtu. Ndoshta duhet përmendur edhe njëherë me këtë rast se Lasgushi nuk është një Albatros që ndihet qesharak në tokë, por një Pelikan i vetëflijuar në jetë për të tjerët. A nuk e shqipton këtë fuqishëm Lasgushi në poezinë *Vdekja e Nositit?*

5. (1938, *Përppjekja shqiptare*, nr. 18, f. 333-350)

Kristë Maloki boton pjesën e parë të një artikulli (të dytën ndoshta s'e ka shkruar kurrë, sepse ky autor edhe me raste të tjera boton fragmente, për

Naimin, bie fjala, e vijimin s'e boton tutje) mbi poezinë e Lasgushit, me titull *A asht poet Lasgush Poradeci?* Artikulli është i shkruar më shumë si shfaqje e pikëpamjeve të autorit mbi poezinë, poetin, artin e fjalës, për ta kundërshtuar shkrimin e Kutelit mbi Lasgushin, se sa si shkrim mbi poezinë e Lasgushit. Maloki ndonëse në krye të punës së vet shtron kriteret e shkrimit të mirë në kritikë: „*pastrië* ner qëllime, *drejtësië* ner gjykime dhe *vërtetësië* ner paraqitje” nuk u përmbahet këtyre kriterëve, sepse duke u përpjekur të përhapë, përqaan „mjegulla”, si u thotë ai, rreth Lasgushit, ai vetë krijon mjegulla të reja duke ikur nga teksti dhe duke u përpjekur ta shtrijë poetin tonë në shtratin e psikanalizës (psikologjisë analitike, thotë Maloki). Autori shtron pyetjen a duhet të jetë poezia *qëllimore* (në kuptimin e sotëm e *angazhuar*, që nënkupton angazhimin social?) Duke iu përgjegjur kësaj pyetjeje Maloki përpiqet të bëjë një tipizim, karakterizim të shkrimeve poetike në të shkuarën dhe në të tashmen, kohën e tij: „...ner kohna të vjetra asht shkruar poezija si mjet edukimi të *personalitetit* (në kuptimin e Goethes), sot priten prej sajë ma fort efekte sociale dhe kolektive”. Në këtë mënyrë Maloki nuk mund ta futë Lasgushin në këtë skemë, as si poet: Vetëdije e Kombit, as si poet social, duke pasë menduar se skema e tij i shterrë të gjitha interesimet e mundshme poetike. Kërkon poezi sociale si prodhim të kohës, ndërsa nga ana tjetër, kërkon po në këtë kohë shembëll poeti, të krahasueshëm me Gëten! Konstatimi i tij se në poezinë e Lasgushit: „...ndihet mungesa e *çdo problemi shpirtënore* shqiptar dhe me te bashk mungesa e një *koloriti* karakteristik shqiptar” është i papranueshëm.

Shkrimi i Malokit në tërësi mbetet në hijen e një konstatimi të shkruar brenda tij: „Fakt asht që Lasgushi ka hy një herë e përgjithmonë në letraturnë shqiptare e vepra e tijë kërkon prej nesh — kështu o ashtu — një studjim serjoz”.

6. (1956 (?) Lasgush Poradeci: *Lirika*, parathënie)

Me rastin e gjashtëdhjetëvjetorit të lindjes së poetit, më 1956 (?) në Tiranë u botua një vëllim me vjersha të zgjedhura të Lasgush Poradecit, me titull *Lirika*. Zgjedhjen e ka bërë Muzafer Xhaxhiu, që është dhe shkruar i parathënies me titull *Disa shënime rreth jetës dhe veprës poetike të Lasgush Poradecit*. Në artikullin e Xhaxhiut përmenden shumë mendime, më mirë të themi përsëriten, që ishin thënë e shkruar më para tij për veprën e poetit. Po ne do të ndalemi e t'u japim zë disave që jipen më thekshëm këtu. Së pari, autori i shkrimit të përmendur pranon dijen e gjërë letrare dhe kulturën e Lasgushit, mirëpo në një mënyrë këtë dhe e sheh si fajtores për një mënyrë të errët të shkrimit të tij. Botëkuptimin e „errët mistiko-teozofik” të Lasgushit e sheh të formuar nga dija që kishte marrë ky poet nga filozofët idealistë të Europës. Në veprën e Lasgushit do të gjejë „ide mistike dhe fataliste” megjithë që në shkrimin e tij nuk mundohet të japë argumentime shterruese po vetëm kënaqet me konstatimet. Në thumbin e kritikës së tij janë pikëpamjet dhe idetë e vjershave të Lasgushit mbi krijimin dhe Përjetësinë. Gjithnjë në këtë frymë ai do të shkruajë: „Në poezitë filozofike për jetën, vdekjen, lëndën apo shpirtin, madje edhe në mjaft vjersha të dashurisë, ku mendimet janë të mbyllura në teozofi dhe misticizëm, forma poetike është e përdhunuar, plot artifise dhe formalizëm”.

Nga ana tjetër ky autor në shkrimin e vet ngreh në kulm vjershat e Lasgushit me motive dashurie, në të cilat ndihet mënyra e këndimit shqiptar, e krahasuar dhe e matur, tradicionalisht me këndimet e Naimit. Në këtë vijë hyjnë edhe vjershat me motive popullore. Ai përmend gjuhën poetike të Lasgushit, gjithnjë duke përfolur dhe vjershat. Përfundimi i tij është se: „Lasgush Poradeci është poet me plot gojën, „këngëtor finosh” dhe i ëmbël i natyrës dhe i

dashurisë”, që është një simplifikim i çuditshëm i vlerave të Lasgushit.

7. (1965, *Buletin shkencor i Institutit pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës*, f. 3-57)

Në këtë buletin *Vehbi Bala* boton studimin *Lidhjet letrare shqiptare-rumune*, në të cilin pos tjerash shtron tezën e ndikimit të madh të poetit romantik, Mihai Emineskut në poezinë e Lasgush Poradecit. Ndikimet i sheh në temat dhe në fjalorin poetik, mirëpo argumentimet nuk janë të mjaftueshme, sepse nuk janë ndjekur sa duhet burimet e formimit dhe të dijes së Lasgushit të cilat nisin në trashëgiminë poetike shqipe në të parë, më së hetueshmi në poezinë e Naim Frashërit, dhe hapen në literaturën europiane të cilën poeti ynë mund ta lexonte në origjinal, e deri në mitologjinë e *Vedave* induse të cilat Lasgushi i njihte mirë që në rini.

8. (1967, Rexhep Qosja, *Dialogje me shkrimtarët*, f. 135-177)

Në këtë libër gjindet studimi i Rexhep Qosjes mbi poezinë e Lasgush Poradecit. Ky shkrim u shtrohet më shumë kërkesave të një shkrimi historik-letrar se sa kritik-analitik, prandaj merret me mundësinë e gjetjes së vendit të Lasgushit në historinë e letërsisë shqipe në radhë të parë, dhe me gjendjen e poezisë së tij në relacion me poetët bashkëkohës të Europës. Intencën e shkrimit e paraqet një konstatim që është dhënë në fillim të studimit: „Lasgush Poradeci ndien si romantik, mendon si klasikist, asht i vetmuem dhe i hermetizuem shpirtnisht si simbolist dhe i kujdesshëm ndaj formës e vargut si parnasist. Asht eklitkik dhe origjinal në çdo pikëpamje”.


Ky konstatim shtrohet në formën e tezave dhe gjakohet të eksplikohet në gjithë tekstin e studimit. Rezultatet nuk dalin gjithëherë të sakta ndoshta pikërisht pse kërkohen me çdo ngulm edhe aty ku nuk mund të gjenden, nëpërmes të lidhjeve që nuk janë lidhje relevante dhe të forta. Këtë insistim me këmbëngulje të shprehur në fillim ndoshta më së miri e shpreh konstatimi antinomik i pamundshëm, i paqëndrueshëm: *Origjinal dhe eklektik*, e sidomos i thënë pas konstatimit ku Lasgushi përafërohet me poetë të shekullit të kaluar, kryesisht frengë. I gjithë shkrimi që gjakon të ketë natyrë interpretative, përbrenda këtij studimi, ngritet mbi një varg të Lasgushit: *Bukuri! tmerisht e dashur, Uaftari! tmerisht e bukur*, i cili varg përsëritet në çdo kaptinë të studimit, pa u pasë interpretuar asnjëherë, por duke u quajtur varg *larpular*, varg të cilit nuk mund t'i gjinden shpjegime të tjera pos shpjegime formale! Po të interpretohej e të kuptohej drejt ky varg në kontekstin e poetikës së Lasgushit, Qosja nuk do ta truante poetin edhe për qëndrimin e tij ndaj frymëzimit: „Tue pritë frymëzimin, poeti Lasgush Poradeci mbetet pa shkruar ma tepër, mbetet pranë variantave të të njajtit motiv(...) E nëqoftëse ndonji poet ia ka pa sherrin qëndrimin të vet mistik ndaj gjenezës së poezisë, ky asht Lasgushi”. Pra këto janë konstatime që nuk do të dilnin si të tilla sikur të ishin përfundime të analizave paraprake të vjershave të Lasgushit. Në këtë studim preket edhe problemi i sistemit poetik-filozofik të Lasgushit, dhe në këtë pikë në studimin e Qosjes Lasgushi del i dështuar, sepse autori i studimit nuk bën me kohë dinstinksinin e *sistemit poetik*, dhe të implikimeve filozofike që dalin nga vargjet nga doktrina filozofike, që Lasgushi s'besoj ta ketë pasur ndonjëherë ndër mend. Pikërisht kjo është rezultat i vetë metodës së Qosjes, që u afrohet veprave poetike, duke u përpjekur t'i përkthejë ato në nocione e terma që nuk janë të fushës së letërsisë. Pra, ai krijon një *alegorezë* të krijimeve poetike të

Lasgushit. Në studimin e Qosjes përsëritet dhe njëherë çështja e poezisë së Lasgushit dhe problemit social, i cili vetëm përsëritet si dhe në shkrime të hershme mbi këtë poet. Qosja mund të shtojë edhe këtë: Ai (poeti, S. H.) s'ka utopi sociale).


9. (1976, Mihai Eminescu, *Ylli i dritës*, Pashënie).

Në mbasthënien e këtij libri *Poezia e Mihai Eminescu-t, Rexhep Ismajli*, pasi flet mbi poezinë e Emineskut, diskuton edhe çështjen e ndikimit të tij te poetët shqiptarë, e edhe në poezinë e Lasgush Pora-decit, në kaptinën *Eminescu-Asdreni-Lasgushi*. R. Ismajli diskuton mendimin e Vehbi Balës dhe me argumenta të fortë e hedh poshtë duke përfunduar se poetikisht epërsia e Lasgushit ndaj Emineskut është e dukshme. Ndërsa, sa për ndikimet e tjera që do t'i ketë marrë Lasgushi përmes poezisë së Emineskut, — Ismajli thekson se poeti ynë kishte një informim dhe formim të thellë letrar, dhe letërsitë e Europës i lexonte në origjinal. Është karakteristike domethënia e fjalisë përfundimtare të këtij teksti që shtrihet si apel, si thirrje, si kritikë: „Kjo do të thotë se komparativistët tanë ende nuk janë liruar nga konceptonet dhe psikologjia centriste, që i vret vlerat”. Kjo shtrin kërkesën që kur flasim e shkruajmë për poezinë është mirë të nisemi përherë nga teksti konkret, të bëjmë interpretimin e tij, dhe interpretimin e figurave poetike e nocioneve, për të gjetur verifikimin e tyre njëherë brendapërbrenda sistemit poetik të autorit, e pasi të jetë bërë kjo punë, të kërkojen lidhje e përgjasime. Përndryshe, krahasimet me teza paraprake nuk i zbulojnë vlerat origjinale, japin rezultate të gabueshme të kërkimeve.

Sabri Hamiti



LASGUSH PARADECI: „YLLI I ZEMRËS”, KOPERTINA E LIBRIT,
BOTUAR NË BUKURESHT ME 1937



I

NË VEND PARAFJALE

ZOG' I QIEJVE

*Këng'e lasht'e vjershërisë më pëlqeu aq fare pak...
Do t'ja marr që sot e tutje si bilbil parëverak,
Që nga fund' i vetëvetes do këndoj një mall të ri:*

*Brenda tufës së junapit që mbleroj me kaq stoli,
Kur po shoh ndaj ryn bilbili e sakaq ze qan nër fletë,
Këng' e ti më ngjan kulluar posi këng'e Zotit-Vetë.
E prandaj, dyke filluar, ay Lart i shpije kryet
Dh' i ngreh sipër-e-më-sipër gjer sa qafa ment i thyet.
Asohere-e ndjej si dridhet më një zë pa shëmbëllim,
Asohere-e ndjej si foli: Të jam falë, — o Zoti im!
E pastaj i ulet gusha më-përposh-e-më-përposh,
I venitet me-nga-dale syri-i qarë-e bukurosh.
Ay sheh që nëpër fletë me vështrimin e çuditur
Ndaj çkëlqen ner mijë gjyra Vënd' i ti ku pati sbritur,
E pra ja q'i mbylli sytë, e që gojezën e hapi:
Tungjatjeta! tungjatjeta! Vënd o Vënd ku çel junapi!*

*Haj! bilbil, se Vëndi jonë ka liqere-e anë detesh,
Nëpër bimëzat e tyre po vërrej si qan e tretesh;
Po dëgjoj prej largësire, si nër male-e si nër fusha,
Si nër kopshle jargavanësh dhemshurisht*

*të fryet gusha;
E çdo lis që mban të gjelbër, e çdo pemë-e çdo rakitë,
E çdo bar i lulëzuar ças-pas-čas t'i ndjen çuditë...
Ti këndon, o zog i pastër, ti këndon, këndon përherë,
Pa pushim të del nga zemra vaj' e tingëllit të mjerë;*

le- do
Ti vajton me zë të fshehur, se një zjarr kupton në gj:
Dheut! ah dheut të përtëritur sot i falesh përsëri!
E si rron në gj të dherit dit-për-ditë-a nat-për-natë,
Gjir' i dherit ku rreh jeta të fal breng e përgjërëte:
Se prej mallit që të thyen përmes pamjeve të tija,
— Mun në fund të zemrës s'ate ritet fshehur dashurija,
— E si ritet prej së jellash, më një ças fillon të nisë
— Kënga jote-e papandehur q' është fjal' e dashurisë.
Ajo ngrihet... ngrihet... ngrihet... dhemshurisht
e duke qarë.

Pastaj sbret e parpalitet si një fluturëz e vrarë.
— E kështu ti qan pa rreshtur bukuritë-e dashuritë,
Prej qepallës së përlotur të pikon një pik' e ngritë.


Asohere kënga jote shuhet dyke psherëtitur;
Ti fillon t'a rrahish mëndjen, e buçet me shpirt
të mitur:

— Se ç'gëzim përjetësije! E se ç'mall! E ç'dëshirime
— Të pat falur dashurija në të qarët e një grime!
Prej dëshirës së zhuritur q' i dhe këngëvet, o zog,
— Rrodhi vesa mëngjezore përmi lule borsilog...
— Përmi lule ku rreh djelli ndrin me zjarr si pikë loti,
Zjarri fërfëllon e ngrihet gjer ne djelli, gjer ne Zoti...
Ti e sheh... dh' aq fort të tundet fund' i zembërës
së gjore

Aqe fshehur të thëthijnë lartësirat qiellore,
Sa, t'u ngritur me vetijen më-përppjetë-e-më-përppjetë,
Si mendim me hov te letë valon qiejve ti vetës
Ha! ç' të zotërovi Drita! Ç' të përshkoj një Gas i ri!
Seç të ndjell një Frymë-e largë tej nëpër paanësi!...
Nër paanësi të ndrijnë yjt' e ndezur varg-e-varg:
Ti me mall të paqetuar fluturon larg-e-më-larg...

— Që nga bota njerëzore, ku këndoje me shpirtin plot,
Prit-e, prit! se po t'afrohet Zog' i Qiejvet, o Zot!
Fal-i Këngëtor-finoshit Gas të Thjeshtë mun në gj:
— Pösi lot në reze djelli ndrit e në Përjetësi!

II
VALLJA E QJELLIT
ZEMRA E QIELLIT



SHPIRTIT

(ODE)

Të lus, o Lajmës qielluar!
O Frym' e Zotit, Vetë Zot!
Me hirin t'ënd të pashteruar
Që ka mburim përjetësije,
Hirplot, o Shpirt, nër gaze Ti-je.
Dhe nër mjerime je hirplot!

Ti botës s' onë-i prure lajmin
E nj' ëndërimi të pafaj:
Për mallin t'ënd më të pastajmin
Ti kuvëndon që përmi botë,
Dhe në gëzim i bije lotë,
I bije gas në zi të saj.

Kur del mi male yll'i ditës
E shuhet nata prapa ti,
Ti me vështrimin vetëditës
Çkëlqen në fund të zemrës s'ime
Dh'i bën prej këngës së një grimé
Një të përjetëshme — harmoni.

E kur për humbur jet'e dherit,
Kur syr'i lodhur m'u përgjum,
Në shkëndijim të kandilerit
M'i çfaq ylberin e një rruaze... —
Fatlum, o Shpirt, ti je nër gaze,
Dhe nër mjerime je fatlum!

Sot hapa sytë që-me-natë
E po këndoj si kurrëkush:
Drejt lartësirës së pamatë
Ah, mëshirë të ngjitë-i çmuar
Prej gjirit t'im të përvëlur
Fjalim'i mallit t'im mjerush

RI MBËSHTETUR NË TRYEZË

Ri mbështetur në tryezë
Ndaj më shpesh e ndaj më rrallë,
Pa vjen malli të më ndezë
Zjarr në zemër, zjarr në ballë.

Asohere dyke pritur
I marr tëmbëlat nër duar
E qëndroj krye-venitur
Me vështrim në kraharuar.

Sbret një yll prej lartësije,
Një të ndritur shkrepëtime —
Pasi flakë e posi hije
Ajo ryn në zemër t'ime.

E kuptoj me shpirt të sosur
Si kullon dale-nga-dale,
E si fjalës së palosur
M'i hap kindën e një pale...

Unë qit një psherëtitje,
Thyem pak e ze të shkruaj,
Dhe më shkon më një pulitje
Kur një dit' e kur një muaj.

Mëndjen t'ime-e merr dëshira,
Ndjej në gjit një këngë gjaku,
M'i fal syrit plot çudira
Këjo odë varfanjaku:

Këjo oda s'ka mënyrë
Ku të kryet, ku të nisë
Ndaj më ndrin si në pasqyrë
Drita e Përjetësisë.

.
.
.
.

Po çudi tani më fal-ti,
Zjarr, që djeg në shkrepëtimët!
Dyke ngjitur për së nalti
Fërfëllon një flakë-a himët...

Me kullim të pashteruar
Ajo del prej vetes s'ime,
Del nga shpirt' i përvëluar
Nër një mijë shkëndijime.

E si shkoj që prej së felii,
Ç' m'u verbosnë-o! syt'e mija?
U nxi dheu?... U shua qjelli?...
U bë natë gjithësija?...

... S'është gjë: veç yll'i vetë,
Më s'më djeg në kraharuar:
Unë shoh me gas të qetë
Këngëzën e përvëluar.

MALLI I VJERSHËTORIT

Foli nëna me vajtim,
Foli djali-i dëshëruar.
— Ç'bëre, bir, n'atë mërgim?
— Shojta zjarr' e shpirtit t'im,
Që m'u ndes në kraharuar.

— Bir, po malli si s'të zu?
Foli nëna dyke qarë.
Ç'më le korbën si kërcu!
Kù më fluturove, ku?
Bubu! shtatë vjet pa parë!

— Fluturova zall më zall
Posi zog me yll në ballë,
Këngëtor me zë që çmall:
Popo! ylli ç'ishte mall!
Ç'ishte malli yt i gjallë!

YLLI

Del nga zemëra një yll,
Nuku di nga vjen i shkreti:
Sikur djeg përdhe mi pyll,
Sikur shkon për-së-përpyeti.

Sikur digjet përsëri
Mun në fund në krahuar,
Sikur sbret nga qjell' i ri,
Yll i jetës i pashuar.

Yll e mall që shëmbëllen,
Drejt prej zemërës së qete,
Vjen e ndrin e shkon nga vjen:
Rrëzë qjelli, rrëzë jete.

GJUMI I SHPIRTIT

Fli shpirt edhe fli. Zemërore
Po dirgjet dhe nata nga-dale.
Gjumash ti shëkó nëpër ëndër
Pulitjen e yjve mi male —
Enigmën e yjve mi male.

Fli, fli. I harruar harrimi,
Fli rëndë-, edhe fell-edhe rrallë.
Nër funde liqeresh paqtore
Vërré ndaj po ndez kaq përrallë —
E dhemshur e yjve përrallë.

Ti fli... dhe në dó që të sgjohesh,
T'a dish si djeg yll' i vërtetë,
Kaptó nëpër qjejt' e përflakur
Dh'u ndis u zhurit e ti vetë —
Si yll të zhuritesh ti vetë.

GJUHA E ZJARTË

O gjuhë-e shentëruar, o mall me shpirtin plot.
O vetëtim' e qjellit që fërfëllon me flakë,
O djellë-i llaftaruar që ndrin si pikë lot...
Si pikë lot e ndritur po ndrij në reze t'uaj,
Po ndrij e papandehur po qaj pak e nga pakë
Sepse prej botës s'uaj kam mbetur kaq i huaj...

Kam mbetur kaq i huaj, dh'i ndrydhur edh' i shkret!
Prej ligjëratës s'ate që më çudit, o zjarr!
Me gjuhëra prej flake ti djeg... ti flet... ti pret...
Do vi! do të vi pranë mjerush e dyke vuar,
E flakën vraparake nër kraha do t'a marr,
Posi kuvënd të shkruar do të t'a çik me duar.

O këng' e shentëruar, o verb i larë n'ar.
O zjarr që më përflakesh si yll vetëtimtar.
O fshehtësir' e ndezur në fill prej shkrepëtime.

Kur të këndoje me gojë, kur të kuptoj në kartë,
Posi një kraharuar ti dhemb, o Gjuhë-e zjartë,
Posi kullim' i gjakut që rreh në zemër t'ime.

Ti ndrin në thelb të jetës si dritë-e përvëluar,
O gjuhë-e zemrës s'ime, o mos-e-kuvënduar.

III
VALLJA E DHERIT
ZEMRA E DHERIT

KËNGA PLEQËRISHTE

O këngë pleqërishte! Ti vjersh' e Vëndit t'em!
Ti fjalë që më dhimsesh e që më bën ujem!
Tashi jam dëshëruar së largu të më vish:
Dëgjoju, as dëgjoju! moj këngë pleqërish!

.....

... Në hije të kasolles që nxin atje mi mal,
J-a nis me zë të shtruar... j-a mer me dal-nga-dal...
J-a thua më të dhemshur... j-a thua më të qarë...
J-a dreth e përvëluar... j-a zjen... e j-a heq zvarë... —
Pastaj fillon të ngrihesh, e nis e j-a thërret:
Dh'áq letë-e ngreh së poshti... áq fort e shpje përpjet...
Aq dyke mërmëruar me zë të parpalitur
Rënkimi-i zemrës s'ate ronitet më të ngjitur...
Sa... që nga lartësira ku vate fluturoj...
Me sulm e ulërimë këputet si përroj...
E rrjeth për tatëpjetë prej kulmit qielluar
Si breshër i thërmuar... si lot i përvëluar...
Pastaj të shuhet zëri... e rrihesh... edhe vdes:
Mjerimi-i vetëvetes të thjevi mes-për-mes:
Së fell-e pá mëshirë të thjevi dhembja jote,
Dëshir' e varfëruar e Këngës magjiplotë!

.....

O këngë pleqërishte! O vjersh' e Vëndit t'em!
O fjalë që më dhimsesh, e që më bën ujëm!
O mall! O psherëtimë! O vajë! O lot i zi!
O shpirt i përvëlur që qan nër syt' e mi!
Si ngrihet që nga deti një valë-e dëshëruar:
Nga fund' i zemrës s'ate ti ngrihesh dyke vuar;
E prapë posi vala, që bje së-rish në det:
Ti bje në fellësirën e zemërës së vet.

PORADECI

Perëndim i vagëlluar mi Liqerin pa kufir.
Po përhapet dal-nga-dale një pluhurë si një hije.
Nëpër Mal e nër Lëndina shkrumb' i natës që po bije.
Dyke sbritur që nga qjelli përmi fshat po bëhet fir...

E kudó krahin' e gjërë më s'po qit as pipëlim:
Në katund kërcet një portë... në Liqer heshtë
një lopatë...
Një shqiponjë-e arratisur fluturon në Mal-të-Thatë...
Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit t'im.

Tërë fisi, tërë jeta, ra... u dergj... e zuri gjumi...
Zotëroj më katër anë errësira...

Po tashi:
Dyke nisur udhëtimin mes-për-mes nër Shqipëri,
Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi...

NAIMIT

Ku psherëtin dëshir' e djegur,
Në shesh të kuq të Qerbelasë,
Mes trimërish shtërgjyshërishte
Të shoh ndaj po m'i bje xhurasë.

E më të lum, më të përmallshmë
Të sjell në dritën e mejtimit
Ndaj fërfëllon si yll me flakë
Prej shkretëtirës së harimit.

Qëndroj në tmerr zili' e botës
Se më s'u lodhe dyke ndritur,
Se më s'të treti prush'i vojtjes
Në kraharorin e zhuritur.

Po ti me vrap të piraustit,
Që fluturon në zjarr e flakë,
Therorësin' e vetëvetes
E pate dhembjen më të pakë...

O! sikur këng' e zemrës s'ate,
Që ligjëroj aq më të kotë,
Që veç me fjalë dhemshurije
U pat dëgjuar përmi botë.

Në gji të çdo mëmëdhetari
Të mund t'a përtëritte mallë
Dhe një të tërë varg dëshirash
Q'i thurri mëndja jote-e rrallë.

Me ç'zë të pastër lavdurimi
Do kish bekuar varfëritë!
Vaj' e një çasi-e këngës s'ate
Përjetësisht do dil në dritë!

Po t'u pat thënë short' e verbër
Të përvëlohesh nër padije:
Me mijë reze shkrepëtimi
Mezi të ndritish po një fije...

Dh'aher' i dehur prej durimit
Në mall të math të këngës s'ate,
Kaq zilitar këpute zemre
Ç'më të paçmuarshmë ti pate.

Dh'u ngrite për në të vërtetën
Me fluturim të artit mjeshër:
U droth alltari jonë-i lashtë
Sapo t'a ndjeu të shentën është.

Se ngashërim' e vjershës s'ate
Ish malli i fellë-e pà të ngjarë,
Posi një krua pastërsije
Këndimi yt nër ne pat rarë;

U pat tërhequr shpirt' i kombit
N'atë vajtim aq të lënduar
Q'e thurri gjuha jote-e-zjartë,
Dhe balli yt i frymëzuar;

Se bukuritë e-vetes s'onë
Mëndimi yt desh të na falë,
O! Fjal' e pikave qiriri,
E pika lotëvet, o Fjalë!

Q'ahere dyke shpënë sytë
Nga Toskëri' e Gegërija,
Shpesh e më shpesh patm' ëndëruar
Si ndrin me famë Shqipërija.

Mes ligësish armiqërishte
Stolismë lulen e vullnetit,
Sbuluam gur margaritari
Prej fundit thëthimtar të detit.

E m'i çkëlqyer sesa djelli,
M'i lum se kohët që më s'janë
Filloj për ne ndryshim' i motit
Më një të pritme të pa anë:

Ti! Fjalëtor i mallëngjyer!
Ti! këng' e ritur ndaj selvisë!
Ti o rapsod i lasht' i kombit,
Ti pate pjesë — urgjin' e zisë!

A! po n'u trete prej mendimesh
Me tëmbra t'ulura nër duar:
Në ç'qjell të larg pat gjetur prehje
Kjo zemra jote-e përvëlur?

Nga fluturoj bilbil-finoshi
Q'e fryri era posi fletë?
Kú vanë pendët e pëllumbit
Q'e shtiu në dhet mërgim' i shkretë?

.
.
.
.

Sikur të shoh, i tmershmë Frashër,
Ndaj po mban zi përgjithëmonë,
Ti: më besniku trashëgonjës
I dashuris' së vëndit t'onë!

NAIM FRASHËRIT

*E kû shkruhenë në kartë
Fjalët e gjuhës së zjartë...*

Naim Frashëri: „Fjalët e Qiririt”

Në çetele të kujtimit që dhëmkoset pak-nga-pak,
J-a shënova kohës s'onë fluturimin vraparak,
Se mi gropën e shkretuar ku dremit që kur ke rarë
Pas njëzet-e-katër vjetesh sot po çfaqet mot'i parë...

Vallë dergjja jote-e fellë pat pushim e lumtëri?
A t'j-u çduk dobare gjumit e përjetëshmeja zi?
N'atë varr ku për së fundi mort'i keq të zu në rrasë,
Të çkëlqeu pakmos së largu fush'e ndriçm'e Qerbelasë?
Të këndoje me këngë malli Drini plak e i kulluar? —
Zot, o! Zot, të qofshim falë që Naimi pat pushuar!

Sepse Hije-e shentëruar nër të gjallët sikur t'ishte... —
...Sikur t'ishte nër të gjallë, Ti, Xhuraja dhemshurishte,
Ti rapsod që pranë shqipes dit' e nat' i lodhe ballët,
Ball'i sbet' e-i adhuroar sikur t'ishte nër të gjallët:
Që nga tumb' e përmivarrshme ku do shihnje
përm'at'anë

Vallë-a mos u ndreq të folët në Devoll e në Bujanë,
Do të dukej i skëterrur më një mjergull zembërate
Horizont' i madhërishmë nër kufi të Tokës s'ate;
Bukuri' e Mëmëdhethit do të ngjante-e pashijuar...

E atje, ku zër' i kthiell s'diti ç'është fjal' e shkruar,
Me dëgjimin t'ënd fisnik e me vërrejtjen e pasharë
Gjuh' e ëmbël e stërgjyshve do të dukej gjuh' e vdarë:
Humbi rradhën çdo të folur, çdo kuvënd e ndyti shijen,
Ligjërata pleqërishte sot ka vrarë vetëdijen.
Aq, sa me t'u mëshiruar në kaq helm e kaqe prishmë,
Më të kot do të vërrente veshi yt i harmonishmë
A mos gjejë-i tepërlumtur midis fjalëvet barbare
Tingëllimin q'i dha zërit frym' e gojës shqipëtare...

Nuk di, është fshehtësira që kalon me fat në duar:
Është njoll' e zez'e qjellit që le pàs një yll i shuar;
Është krism' e vetëtimës kur fundet në fund gremine,
Heshtj' e këngës që pat qarë me një harmoni divine:
Po nër bijt e Mëmës s'ate-yll i ndritur! yll me zjarr
Vetëtim e harmonishmë që pushove nënë varr! —

stërnipër,

Po nër bijt' e Mëmës s'ate, me gjyrmashë-e me
Shkatërrim' i shpejt' i gjuhës sot qëndron

në vepr'e sipër;

Sot po humb kuvënd'i zogut ç'gjithë bukuri që kishte
Pa lëngon e nis të shembet folja jonë pleqërishte,
E në breng të kaq rrëmuje psherëtiu dh'u shua fare
Dyke rënë posi pika këng'e orës shqipëtare.

Kùsh u tall se pasurija është rob'e larë n'ar?
Se një mëndj'e palëmpirë sbukuron një trup bujar?
Në fjalim të Shqipëtarit kùsh përqeshi? kùsh gajasi?
Kùsh më tha se gjuh' e sotme shëmbëllen me zë larasi?
O, t'a njoha prej së largu buzëqeshjen e shëmtuar,
Ti, demon i shkrëtëtirës, që kalon me vaj në duar:
M'i përdredhur se zilija t'u pat çfyturuar shtati,
Mun në fund të vetëdijës ty të ndrin një sy lugati;
Je njeri, e pà pandehur sikur ngjan me sprijë zalli,
Flet me gojë, — e pà pandehur sikur ulurin çakalli,
Qan e heq në të kënduar, ze këndon në zi të madhe;
Vdes kur hapet zemr' e gjuhës posi lulja nër luadhe:
Ha! se në kaq ndryshmësira m'u duk vetë Shqipëtari
Ndaj shëmton fjal'e të folur nga padija, nga nakari.

...Të përmbysim vetëdijen kur na fton mburim i jetës?!
...Të mendojmë kaqe errët mun në mes të së vërtetës?!
...T'a mjerojmë kuvëndimin me kaq helm e kaqe
prishmë
Kur fillon t'ja thotë shqipja me një hir të
perëndishmë?!

Sepse hir të perëndishmë kish kuvëndi yt, Naim,
Ajo këng' e tepërlumtur që më s'pati shëmbëllim;
Se mendimi yt kish flakën e kuptimit të kulluar,
Goja jote vjershëtore kish një zë të pastërsuar:
O! sa bukur që rrjeth fjala nëpër brigj' e nëpër sheshe,
Nëpër mal ku merr kullotën tuf'e bardh'e një bareshe...
Ç'ëmbëlsir' e lumtëruar n'at zëth aq të mahnitur
Ku një trim i falet vashës dyk' u shtrir' e u venitur...
Rreth murishtës së qytezës zu po zjen një zi mizore,
Fryhen grykët e shëndosha në bërtitje trimërore...
E mes tempujve të qetë, pranë pikash prej qiriri,
Dyke njohur vetëveten dal-nga-dal ze vuan gjiri,
E si tretet dyll 'i djegur e pikon e merr kullimin,
Shpirti yt në kraharuar i bën mëndjes shoqërimin,
E më shpejt se shkrëpëtima kur godet mi shkëmb
petriti,
Bje përposh në fund skëterre... fluturon në kulm
zeniti...

E pse dot më s'gjet të prehur as mi dhet, as nën' etere,
Mërmëron e qit prej helmit mjaltë blete parëvere...
Këngëtor i pazembruar çit prej ferrash trëndafil...
Bëhet erë-e-i hyn në gushë gushë-dehurit bilbil...

Kjo 'shtë këng' e shentëruar e kuvëndit t'ënd lotak!
Ambrozi q'u shtryth nga zembra dh'u përzje me
vaj' e gjak.
E kjo fjal' e perëndishme, ky kanisk pa shëmbëllim,
Këjo vallë diamandësh na-u pat lënë trashëgim.
Po kaq fortë-i pru shkëndijat rez' e ndriçm' e ti ndaj
neve,

Sa, të mundur nga çkëlqimi, humbmë fillin e ideve,
Nga çudija patnë humbur diltësin' e syrit vet
E në ngjau se zuri perde dh' u verbos e mbet i shkret.
E kështu, kur hën' e plotë lakuriqin e ka prekur,
Ay ngaci nd' anë murresh dh' u çukit e ra i vdekur.
Ra e shtrirë mes pishtari me qipallë të këputur
E shastisur po nga flaka pendë-shkruarëza flutur.
E kështu-i javiti kryet një çfrerim edhe një bujë,
Ku thesar' i shent' i gjuhës bëhet lodër e rrëmujë,
Ku çdo goj' e djallëzuar, mbledhur fshehura në klikë,
Me një fjalë barbarije ze një vënd në politikë:
...Se ç'u mbush plot kapedanë — po me mëndje-
cilimiu. . .

Ç'ndriti Lushnja trimërore — po ç'u err dhe vetvetiu. . .
Se me zemër prej luani mprohet Toka — po me skistër
Kruhet ajk' e majm' e gjuhës në kongres të saj
sinistër;

Pastaj rrugësh arratije bje gjykimi-e gjëma shtohet,
Pa ze çbëhet ç'u pat bërë — ç'u godit ze çkatërrohet;
Ç'u ndërdua bres pas brezi, bje greminë më një ças,
Ku këndoj bilbil' i kombit, grifsh' e huaj çirret pas.
Me përbrëndjen e shkumbosur një poet, një deputet,
Flet e çflet e vret e pret për një të vet virgjinitet. . .
Prej blatishtash tradhëtije shkumbëzon një farmason
E me ton që të shurdhon dënon një renegacion. . .
E nj' aty një tru-venitur që mban dije për një fije,
Lajkatar a dërdëllitës nxjer levezhga gjuhësije,
Dyke lojtur maskaradën, si kasneci në pazar,
Me dy sy të zgurdhulluar, me një pedantizm barbar.
Se pat humbur prej qëkuri shpirt' i gjuhës së atyre
Që në fat të lum të kombit janë shëmbëlla myxyre!
Se për shqipen pleqërishte — për çudin' e
mosfjalosur —

Vesh' i tyre-i shushulluar ka timpanën e rrëxhosur.
E kështu-i kaptisi kryet egzotizmi orë-lik,
Vijza mërshe-e gjyrë dheri mori shtat' i saj fisnik.
E kështu filloj të ngrihet nga varrishtat e çdo ane
Përmi gjuhën shqip të gjallë një mumi egjiptiane.

Po ti drith-u, o! komb i lashtë, me-atë zembëren e gjërë,
E në gas të drithmes s'ate lè të tundet bot' e tërë!
Lè të ndritet Shqipëria nër bregore-e nër fushore
Si buçet me zë të thjeshtë frym' e gojës stërgjyshore;
Si flet shqip' e lumtëruar e bekon me gjith bekimin
Vajzërinë-e virgjërinë... — zemërimin... renegimin...

Gjuha: shpirt i shent' i kombit, që kalon dyke kënduar!
Gjuha: zjarr ku djeg me dritë një mendim i frymëzuar!
Gjuha: afsh' i gjall' i jetës! shpat' e ndritur e lirisë!
Gjuha: yll' i vjershërisë! Gjuha; Verb' i Perëndisë!

Po ti mbeç me hir të shentë, bard i lindur nër pallate,
N'atë varr ku të pat mbyllur dhemshuri' e Mëmës s'ate!
Pranë tumbash ku rin myshku, nën shtyllë ku del
gjemb,

Sà 'sht' e rëndë balt' e huaj mës u qaj a mës të trembi!
E në larg nga Shqipëria, nuk do jesh pakmos i shkret!
N'ato pllaja ku këndove atë Burrin e vërtet!
N'ata pyj pate qarë (për kujtim të zi të motit)
Si u tret në dhë të fellë zemr' e gurt' e Kastriotit.
Sepse — yll i përvëlur n'orizontin shqipëtar —
Ç'e pat pamjen at të largë syri yt vetëtimtar?
Ç'dashurove-aq fort Atdhenë, sa të ndritish më të kot
Një qëllim të vrerësuar veç me vaje e pika lot?
Se mendimi yt i pastër desh të lajnë e gjoks e kokët
Me floririn e virtutës gjith eskrokët edhe trokët;
Se kuxove të na thuash me kalem të zi në kartë
Mall' e Math që të pat djegur: Fjalët e Gjuhës së
Zjartë.

174

Et maist...

Stall

Se... (The text is heavily scribbled and difficult to read, appearing to be a list or account of items and their values.)

(M, off...)

LASGUSH PORADECI: NJE NGA DORESHKRIMET E PARA
TE VJERSHES "NAIM FRASHERIT".

ASDRENIT

PORTRET

Burr' i urtë-e i veçuar,
Shqipëtar me shpirt të quar,
Vjershëtor vjershë-kënduar:

Pate shkruar e punuar
Kombin për t'a kombësuar,
Shqipen për t'a shqipëzuar.

DREMIT LIQERI

Mi zall të pyllit vjeshtarak,
Dremit liqeri pa kufi,
Ay ndaj fundesh u përflak
Posi me zjarr e me flori.

Posi me flakë-u ndes e kroj,
E vetëtiti plot magji,
E yll' i ditës perëndoj
Në qetësi dhe dashuri.

Tashi po shuhet nënë mal
Qytet' i ngrysur në të zi.
Po ndizen yjtë dal-nga-dal
Plot bukuri! plot fshehtësi!

Në këtë ças perëndimor,
Ndaj po më dehen sytë-e mi,
Kuptoj si shpirtin vjershëtor
M'a frymëzon një mall i ri.

ZEMRA E LIQERIT

Dirgjet shpesh liqeri-i kaltër
E pushon në mes të ditës,
Sipër ti buçet prej fundesh
Pasqyrim' i ti shëndritës.

Val' e urtë-i shtrohet anës
Dal-nga-dal e fashe-fashe,
Që prej zallit të përbufshëm
Nisen lundrat levorashe.

Po atje ku nisen lundrat,
Sipër valave paqtore,
Me rrëmbim të zemëruar
Uji hap një gjeratore:

Hap me gjëmë llaftarije
Plagë-e hon në kraharuar
Ndaj largohen sërë-sërë
Që prej zallit të shkretuar.

DRITË FSHEHTËSIJE

O greminë! O fusha pllajash! O shkëmbënj!

O brigje t'artë!

O ju qiej shkretëtirash tej-për-tej aq të këqyrshmë!
Ti përflakje mëngjezore! Harg ylberi-i shtatëgjyrshmë!
Botë yjsh! botë hënash! botë djejs me gji të zjartë!

Bjenë fellë mënt' e mija dhe çuditen dyke pyetur:
Në lëvisni-a në përdridhi, në valoni-a në këndoni,
Në me sulmë të vërtikshme çmëndurisht ju fluturoni,
E prej sysh më bjenë lotë posi helm e plumb i tretur.

.....

Po të mos të kisha njohur në mjerim të jetës Tinë,
Bukuri! tmerisht e dashur, llaftari! tmerisht e bukur;
Po të mos kisha parë—ah, stoli ndaj më je dukur!
Dritë-e fshehtë-e zemrës s'ime që më fal përjetësinë:

Si do mund t'i dliinja vallë kupëtimit t'im të ngushtë
Grop'e shesh e krast' e male, pasqyrim nër vala detesh,
Dritën që buçet sëfshehta përmes ditësh edhe netesh,
Dh'ata yj që më shëkojnë posi mijë yj të prushtë?

MËNGJES

Si shpirt' i zi në kraharruar,
U mbyll liqeri nënë male.
Ndaj fund' i ti e pasqyruar,
Po shuhet nata me-nga-dale.

E shoh ku vdes e ku po vuan,
E syt' e saj dyke pulitur;
E syt' e saj q' u mavijuan,
Jan' yjt' e qjellit të venitur.

Tashi dh' agimi llambaritës
Po svagullon në fund liqeri,
Po tretet tinës yll' i dritës
Posi një sumbull prej sheqeri.

Pra ja! pra ja! se dita ndezi,
Se fund' i ujit vetëtiti,
Se posi lajmëtar-mëngjezi,
Del zogu-i bardh' i një nositi...

KORRIK

Një afsh i dëndur avullon në erë.
Po përvëlon një djellë posi prushi.
U poq kajsija. Bari është' i prerë.
Ri në shullër fatlum një zog ardhushi.

Prej kaq të nxehte shqerrat janë hekur
Nër drizëri ku pik' e vapës iku:
E çlodhen... dirgjen... flenë... kanë vdekur.
Në këtë zjarr, këtë mbarim Korriku.

Ka rënë heshtja posi frym' e dehur
Mi çdo mblerim e mi çdo gjë të gjalla —
Kur ja! se pylli dridhet pa pandehur:
Nër lisa larg, po çinçërron gjinkalla!...

MBARIM VJESHTE

Fluturoj dhe shtërg' i fundit, madhështor, me shpirt
të gjorë
Dyke shkuar që me-natë sipër malesh me dëborë...
Iku rënd' e i përmallshmë, dhe me sqep të ti të fortë
Zotëriut q'i la folezën i trokiti mun në portë...

Pra më s'duket shpesh' i fatit prapa bujqësh edhe
plorësh,
Prapa brazdës së rrëxuar hap-me-hap prej qe malorësh;
Më s'dëgjohet nër ugare të kërcasë miu i hirtë,
Vdiq nepërka pikëlore ndaj blatisht' e shkretëtirtë.

Dheri-i mardhur prej thëllimi dirgjet heshtur nënë
brymë,
Fryn veriu në pyll të thatë me zembrim e me fërtymë,
E si shtohet cinërима... ja! se ku dinak dh' i voçërr
Nëpër gardhe-e nëpër ferra dërdëllet gazmor një
çoçër! ...

O! sa hir që kishte shtërgu, aq fisnik me shtat të gjorë,
Kur bariste dal-nga-dale — posi dhëndër me kurorë!...
E kur pranë-i vinte krilla, që shëndrij në kraharuar,
Me sy lart, me hap të matur — posi vash' e nusëruar!...

DIMËR

Shpirti im që sot u mbyll
Dhe gëzimin m'a përzuri.
Nëpër mal e nëpër pyll
Zu dëbora prej qëkuri.

Bjenë flokët një-nga-një
Mi katundin e shkretuar.
Dyke mardhur nënë të
Dheri fjet e ri mbuluar.

Fjet nga-dal e shpirti im,
Dhe në zi pikoj si fleta,
Pa më s' qit as pipëlim
Tërë filë, tërë jeta.

Në kaq heshtje-e qëtësi
Ndjej vajtimthin e një shpesi:
Psherëtin me zë të ti
Jet' e trembur se mos vdesi. . .

GJAHTORI

Sapo nis thëllimi-i parë
Nëpër pyll që marth e mpijet,
Prej së lartrash brymarake
Ze-e përhap dëbora fijet. . .

Unë ri mi shkembe drurë
Dhe vështroj dyke menduar
Ndaj po zbardhet dal-nga-dale
Kjo krahinë-e dimëruar.

Ja! kollani më një krabë!
Më një thumb takien ja-e!
Dh' aty pranë-i mvarren palët
Palëshumëshmes silëe.

Pa m'a ngjesh fustania belin,
Rryp' i kuç m'a lith opingën:
— Prej ovqjalash, ku ri mykur,
Vasha, ju! m'a sillni stringën!

. . .E sakaq palcorja-antike
Lyen pushkëzënë e vjetër,
I mbush vëzmezëja grykën
Për një ljepur, për një ketër;

E sa ngjitur pyjtë-e shkretë
Çfaqet heshtur vesh-llapushi,
Del përtej maçok' i egër
Dal-nga-dal nër driza bushi;

Me vështrim të shkrepëtimtë
Alurin mi shkëmb çakalli —
Un' e shoh dhe përnjëheresh
Mund si prush më ndizet balli;

Po nga dal... se çquhen këmbë
Pranë tumbave malore:
Gjah i madh ka lënë gjyrmën
Në mëngjes mi shtrat dëbore.

— E bekuar qofsh! ti flakë!
Tym, o ti! më paç urimin! —
...Ha! prej zjarrit që zu vërzat...
Bish' e trembur zu mendimin...

E njaty, që prapa krastës,
Unë ri dhe pres në rrasë:
Pres që krism' e trimëruar
Të buçasë-e të godasë:

Dhe të shtrihet grykë shpelle
E paçmuarëshmja kunëz...
Dhe t'a marr i lumtëruar
Dhe t'a fut për nënë gunëz...

Dhe pastaj, me shpirt të çelur,
T' j-a them këngës nër shkorreta:
T' a bëj zmrën valë-valë...
Dhe fustanen reta-reta...

MARSHI I DJALËRISË

(HIMN KOMBËTAR)

Urdhëroj i Madhi Zot:
Zu ndrin yll' i Shqipërisë;
Ndrin e më s'përmbahet dot,
Se që sot e jetë-plot
Po rreth zemr' e Djalërisë.

Djalëri, lart për liri!
Lart për Zonjën Shqipëtare!
Yll në ballë-e zjarr në gji,
Zjarr në gji për Shqipëri,
Digj-u! zemra djaloshare!

Qjell me shkaba shqipëtar!
Male mbushur me dragona!
Këto fusha derdhur n'ar,
Deti plot margaritar —
Këto janë viset t'ona!

Këtu leu që në fillim
Trim'i dheut si zog i shkruar;
Leu dh' u la për trashëgim
— Me nderim e me qëndrim —
Besa jon' e shentëruar.

Ha! dh'e bukura liri
Këtu mbretëroj përjetë:
Mbretëroj: e plot mëri,
Bëri në rezik të zi
Prej kujtdo një trim me fletë.

Lithni besën për Atdhe,
Ju me gjak të Kastriotit!
Lithni-e shpejt e bëni be:
Be që vret posi rrufe
Para Kombit — para Zotit!

Djalëri, heu! yll i ri!
Djalëri, këng' e shëndetit!
Për liri, për lumtëri,
Rrofsh! e lumja Djalëri!
Rrofsh e qofsh sa val' e detit!

E FUNDIT MËRZITJE

(MARSH SHQIPTAR)

... Na mbajte rop gjith nënë thumb,
Na prure vdekjen gjith me plumb,
E kur nuk ra — yn' at u mvarr;
Dh' i hape truallin për varr,
E varrit-vet i vure zjarr,
Dh' e bëre shkrumb.

Në çdo lëndinë-e një thërror,
E nj' është në çdo vënd botor;
Dhe çdo kujtim e vjershëri
Qan'e thërret prej dheut të zi
Një trim që ra për nder të ti
Drejt mun n'obor.

Armik! po shpejt u përgatit
Të shkosh ngaj ardhe më me nxit
Se n'u vonofsh gjer më në fund:
Kushtrimi-u dha! Shqiptari-u tund!
Flamuri u ngrit mi çdo katund!
Atdheu u ndrit!

Pa vjen sulmon dragoj shqiptar
Si lajm i Zotit çpërblimtar
E bën urgji për Shqipëri

Ti m'u ndrite-e vetëtite
 Posi yll me reze drite!
 Se që sot e që tashi
 Po të ndrin një yll i ri
 Mun në zemr' e mun në gji!
 Pa ke nder e madhëri!
 Ke gëzim e lumtëri!
 Ke flamur të-kuq-të-zi!
 Ke liri! liri! liri!
 Rrofsh! e lira Shqipëri! —
 Rroftë! tha Smail Qemali
 Me zembrim, si zërë mali;
 Rroftë! j-u përgjiq rremeti,
 Pa u tund si valë deti;
 Rroftë! fusha ushëtui,
 Rroftë! pylli uturiu,
 Rroftë-e deti j-a buçiti!
 Rroftë-e pushka j-a kërciti!
 E sakaq një vall' e madhe
 U përhap n'ato luadhe:
 Ishte vall' e dashurisë,
 Në luadhet e lirisë,
 Mun në thelb të Shqipërisë!

.
 Dh'atëhere... nënë mal...
 Nisi kënga me-nga-dal...;
 Nisi këng' e shentëruar,
 E j-a mori më të shtruar...;
 E j-a drodhi më të qarë...
 E j-a zjeu... j-a hoqi zvarë...; —
 E pastaj si më s'u ndje,
 Zu të ngrihet që përdhé
 Gjith më nge... e gjith më nge...;
 Pasi shkoj e zë më s'kishte
 E pastaj filloj të ritet...
 E të ngjitet... e të ngjitet...
 Më me sulm... e më me jetë...
 Më përpjetë... e më përpjetë...

Dh'aq dëshirë-e aqe gas,
Aqe mall lëshovi pas,
Aq me zë të parpalitur
Pat kënduar dyke ngjitur,
Sa... që lart ku fluturoj,
Heshti pak edhe rënkoj
Dh'u këput posi përroj...
Pa prej kulmit qielluar
Ra përposh me t'ulëruar,
Posi breshër i thërmuar...
Posi lot i përvëluar...

.

E si ra në qetësi,
Si shkoj kënga për liri,
Ajo kënga pleqërishte:
Asnjë zë më s'dolli fare
Përmi tokën shqipëtare,
Përmi tokën e qetuar
Si një zembr' e ngushëlluar...
Dh'atëhere — o! çudi:
Ç'far u ndje në Shqipëri?
Qjelli! qjelli! ç'ushëtoj!
Bot' e tërë ç'e dëgjoj!
Zot' i math seç kuvëndo!
Q'atje lart ku ndizen retë
Kuvëndo me zë të vetë
Zot' i math e i vërtetë:
„Rrofsh! moj Shqipëri përjetë!”

Ç'U MBUSH MALI

(RAPSODI POPULLORE)

*Shqipëri! moj nëna ime,
Më ke ritur me thërrime!
Shqipëri! të qofsha falë,
Të kam nënë-e më ke djalë!*

I

Ç'u mbush mali me dëborë,
Ç'u mbush deti me pamporë,
Seç u mbush e shkreta Vlorë
Plot me krushq e me dasmorë:
S'janë krushq edhe dasmorë,
Janë Toskë-e Malësorë —
Janë Toskë-e Malësorë
Me flamur të kuq në dorë
Si dhëndurë me kurorë.

Ç'u zbardhë malet, ç'u zbardhë:
Nga çdo anë seç na ardhë
Shqipëtarët gunë-bardhë.
Seç na ardhë palë-palë
Dyke rutulluar malë
Kush më këmb' e kush më kalë,
Kush më shpejt, kush më ngadalë:

Kush i lum e kush i gjo­rë
Kanë zbritur mun në Vlorë,
Mun në Vlorën e lirisë,
N'atë thelb të Shqipërisë.

II

Ç'u nxinë malet, ç'u nxinë,
Gur' i kuq lëshon mavinë:
Qani, djem, e mbani zinë!
Qani gjithë Shqipërinë,
Toskërinë, Gegërinë —
Ububu! ç'humbi lirinë!

Ç'u hap qjelli pak-nga-pak,
Maj' e malit seç u flak,
Doli ylli me barjak:
Me armikun kemi gjak.

Ç'u mbush sheshi me të parë,
Ç'u mbush zyra me zyrtarë,
Thonë-u pake çet' e parë!
Thonë më t'u paske parë
Me tri mijë luftëtarë,
Tri shtëpi me fis e farë,
Qytetarë, katundarë —
Gjith bujarë Shqipëtarë.

Ç'ka që çan rrufeja retë?
Vjen Smaili trim me fletë,
Fluturon posi shigjetë.
Thonë, vjen përdrejt në Vlorë,
Me flamur të kuq në dorë,
Me flamurin e lirisë
N'atë thelb të Shqipërisë:
Thonë, është vet-i-tretë,
Thonë, është vet-i-tetë,
Thonë vet-i-njëstetë —
Rrofsh moj Shqipëri përjetë!

DITA NJËZETETETËS

Ardhi dit' e shentëruar,
Dita e njëzetetetës
Me flamur të kuq në duar.

Iku dyke flutuar
Nat' e zisë-edh'e së metës —
Ardhi dit' e shentëruar.

Shqipëtarët e gëzuar
Ndjejnë zërin e trumbetës
Dyk' ushtuar e gjymuar.

Pa në Vlorën e dëgjuar
Mblidhen posi sgjoj i bletës
Shqipëtarët e gëzuar.

Do t'i falem pa pushuar
Ditës së njëzetetetës,
Kësaj ditës së shënuar.


Se kështu pat urdhëruar
Goj' e artë-e Zotit-vetës:
Do t'i falem pa pushuar.

O! moj kohë që ke shkuar
Ku ndrin yll' i së vërtetës,
Sesa jemi dëshëruar!

Dit' e muajit Nëntuar
Të vështron me syrin pyetës,
O moj kohë që ke shkuar.

Kúsh e dha për të kremtuar
Ditën e njëzetetetés?
Këtë ditë të bekuar?

Po me gas në kraharuar
Të jam falë-o Zot i jetës!
Ti na dhé për të kremtuar
Ditën e njëzetetetés.



IV

VALLJA E YJVE
ZEMRA E JETËS

VOGËLUSHJA

Kur e kur, mes aratisë,
Vjen më merr një mall i letë:
Më shkon shoq' e miturisë
Nëpër ëndër... nëpër jetë...

Shkon si yll — edhe sakaqe
Ndodhemi gjith më të bredhur...
Lëshon gropëza nër faqe
Leshëra-cullufe-dredhur...

— Leshërat e tu moj çupë,
Valle sumbullash e ruazash
Ndaj të derdheshin mi supë
Posi vargje prej unazash.

Kur ndaj tufësh borsilogu
Lulëzonte lul' e kuqe,
Afër saj un' isha zogu
Që çukiste çdo burbuqe...

Kopsht! o kopsht i shentëruar!
Që kurdo na pate pranë!
Vetëm ti m'i ke dëgjuar
Përkëdheljet që më s'janë!

Sot të shoh prej zembërate
Me vështrimin më të qarë,
Dhe s'kuptoj sesi më vate
Vogëlusheja m'e parë,

E si pshoj me breng të shuar,
Vjen më merr një mall i letë:
Më shkon këng' e perënduar
Nëpër ëndër... nëpër jetë...

MALL I LARGË

Nuk t'harroj askurr' e fare,
Nuk t'harrova kurresi,
O moj zemra djaloshare
Që kurdo më rreh në gji.

Vashë ti që tërë monë
Pate flakën në vështrim,
Koh' e largë-e mallit t'onë
M'u ndërmënd me ngashërim.

Ja-e! kopsht' i shentëruar
Ku mbleron po n'atë vënd,
Ku përditë-e pati shkuar
Hov' i letë-i çapit t'ënd;

Ja! dhe shkollëza mitare
Q'u stolis për krentrërim* —
Ajo pret vetëtimtare
Mun në mes të fshatit t'im;

Tuf' e krerëvet me famë
Ja! ku zjen si kurrëkush;
E ja ti! dhe unë ja-më!
Nëpër vgjer... e nëpër bush...

E po ja! fytyr' e mbretit,
Dora jote ku m'a dha:
Para syve të rremetit
Un' e vara përmi ta...

E më ngjau kur u përmënde,
Dhe më pe me sy vramus,
Sikur vara korën t'ënde
Që t'i falem e t'a lus.

TI MOJ SHOQE

Kur për herëzën e parë
Vetë filli ti më poqe,
Zura mall që s'kish të ngjarë,
Ti moj shoqe.

Zure-e sytë me dy duar
E së qeshuri m'u fike,
Dhe më mbete-e turpëruar,
Ti moj mike.

Oh, q'ahere dit'-për-dita
Gjiri jonë-u shkri në dashkë,
E n'agim sa çelej dita
Ishim bashkë.

Si më dhemb o! grim' e dehur,
Çasi-i lum që zbrita katin!...
Sepse gjeta pa pandehur
Vetë fatin.

Ti më ngjiteshe përpjetë
Me nxitim si nusk'-e-lalës,
E të mori turpi-i shkretë,
Turpi ndalës...

E sakaq dëshir' e suhur
Gushë-e faqe t'i përflaku —
Unë mbeta krye-ulur,
Varfanjaku!

E m'u duk si pate shkitur
Dh'u shastise nëpër shkallë,
Të të puth me zjarr të mitur
Mun në ballë.

SYR' I FSHEHUR

Malli jonë q'u pat shuar,
Malli-i bërë fije,
Sot më gjet të zemëruar,
Më pru lotë zije.

Un' u ngrita që-me-natë
Posi dashurija —
Pse m'u lag o! syr' i thatë
Në mjerim të tija?

Ësht' agim tashi moj mike,
Dhe ja! se ku dolla
Nënën strehë venetike,
Ku po mbin vijolla;

Ku m'u ndes si zjarr rrufeje
Dëshërim' i parë,
Dhemshurisht thërret pas teje
Zemërez' e vrarë;

Të më vish dyke vrapuar
Ndaj të pres i mjerë,
Se të kam për të pushtuar
Për të fundit herë;

Se për herëzën e fundit
Më zu mall i mitur,
Syr' i fshehur i katundit
Që më pat zhuritur.

Un' i ziu që mbeta vetë
Dhe të shoh të vluar,
Më vërtitet mëndj' e shkretë
Posi shaqiluar.

VESË DASHURIJE

Sillet heshtur an' e mb'anë
 Hij' e gjumit të pandalë —
 Kú jan' ëndërat, kú janë,
 Gjumë ti, të qofsha falë?

Kú 'sht' o! mik' e gjithë ditës,
 Të m'a shohë shpirt' i sgjuar?
 Zjarr' i syrit vetëtitës
 Që më pati përvëluar?

Sonte mbeta mun në pisë
 Nën' ushtimin e një buje:
 Moj motriçk' e vogëlisë,
 Nuk të shoh, po ti këtú-je...

Ti mendon mi supë t'ime
 E mbështetur më një faqe;
 Rëgëtin me dëshërime
 Zembr' e mbushur me farmaqe;

Më flet tinës buz' e shkruar,
 Fjal' e urt' e gojës s'ate,
 Pshon për kohën e kaluar
 Që më s'vjen që kur na vate;

Që kur lamë shokërinë
Sa zu zemra të buçasi —
Oh! sa shpesh më ven' e vinë
Përkëdheljet e çdo çasi!

Pa mendohem me llaftarë
Si të humba posi hije
Sa pikovi lot' i parë,
Posi vesë dashurije.

SI NUS' E RE

Shpirti im i dëshëruar,
Shpirti im që m'u zhurit,
Nga mërgim' i zemëruar
Fluturoj posi petrit.

Iku larg e dyke qarë
Me një dhembje mun në gji,
Dhe qëndroj ku mall' i parë
Hesht e vdes në qetësi.

Hesht e vdes — po që-me-natë
Ja! tërhidhet malli im:
Ja! përndritet shpirt' i ngratë
Më një hov pa shëmbëllim:

Ja! së-rish më del ti vashë
Plot me turp si nus' e re,
Dirgjen syt' e tu gjumashë
Të venitur gjith përdhe;

Supëvet me përgëzime
Të bje flogu fije-ar,
Ndritet fund' i zemrës s'ime
Posi yll shkrepëtimtar!

Dhe më flet me gas të qetë,
Dhe të flas me dhemshuri,
Më pushton me shpirt të letë,
Të pushtoj me llaftari.

E së-rish ah! me t'u ndarë.
Ri mënjanë-e qan vetiu,
Ri dhe qaj me shpirt të vrarë
I shastisur un' i ziu.

VASHË DHEMSHURIJE

M'u bë zemëra në besë
Vetëm fije, fije,
Dashuri pa shëmbëllesë,
Vashë dhemshërije.

Sot me lotë varfanjaku
Më gjen parëvera,
Ndaj po di sado së paku
Se më le përhera.

Sepse ja ku jam kapitur
E mendoj së largu
Atë çasin e zhuritur
Që m'j-u shua vargu...

Çasi-i fshëhtë-i dhemshuruar,
Që m'u çduk qëmoti,
Si më zjen në kraharuar
Prej një pike loti!

Dhe të shoh ndaj ze më thua
Fjalë zemërore,
Ndaj buçimin që m'j-u shtua
Dashuris' së gjore.

Ah! në hov të zemrës s'ime
Më s'të pata parë —
Të thërrita nër mërgime
Vetëm dyke qarë.

Papo zemëra në besë
M'u bë fije, fije,
Dashuri pa shëmbëllesë,
Motër dhemshurije.

ERË TRENDELINË

Sesí m'ju lëndon dashurija!
Sesí m'ju lëndon pa pushim!
O lotët e syve të mija!
O klithmëz e tingëllit t'im!

Ju shoqe të kohës mitare...
Mikesha... motriçka... pa faj!
Ju humbtë në mjegull përfare,
Dh'u solla ndër mënd e po qaj!

As flak' e shkëndijës q'u shua,
As syri që nxihet e plas,
Nuk lanë-o ju vasha për mua
Vuratat e errëta pas:

Haj! flutur' e zezë me duar
Një flutur sicila prej jush,
Më la në gishtrinj dyke shkuar
Pluhurin që ndrin posi prush...

Sot çela pëllëmbën e dorës
Q'u çiku gazmore dikur —
Si pah verbimtar i dëborës
Së-rish po më ndrin një pluhúr...

Përse nuk m'u shojte përherë,
Të hesht të pushoj për kurdo,
Ti mall që nër to pate lerë
Dh'u rite dh'u ndrite nër to!

Ju shoh përtej mjegullës s'uaaj
E shpirtin prej jush e kam plot,
Pa s'mund si t'a them, si t'a shuaj
Ah! këngën e mbushur me lot.

Së koti-u larguat mënjanë,
Më vajttë më kot aqe larg,
Kur sumbullat lot që më ranë
Si ruázat i shkova në varg...

Dh'i ndrita me syrin e fshëhur...
Dh'i vela me zërin mitar...
Dh'i skuqa me buzën e dehur...
Me shpuzën e flogut si ar...

Oji! trendelin' e venitur
Ju fali gjith erën e saj... —
Pse rreh kaq me hov të çuditur,
Haj! zemëra ime ti haj?...

Ju lule q'u leu parëvera,
Dh'u çika me gas një mëngjes!...
Së largu prej jush më ra era,
E desha prej mallit të vdes!

DASHURIA UDHËTARE

Kur të qan e të gajas
Zemr' e përvëluar,
Bukurisë-i bje ti pas
Dh'e kërkon me duar. . .
Sipër ujrash ku rrëshqet
Ti vështron një vashë,
Janë zjarr e janë det
Syt' e saj gjumashë;
Janë zjarr e syt' e tu,
Janë det i shkretë:
Dashurija që të zu
Të rrëmbeu për jetë!
Po — atëhere-e merr një trim
Motrëzën në dore,
Pa kalon si vetëtim
Vasha zemërore.

Mos vajto kaq bukuri
Q'humbi posi hije!
Ndaj po syr' i saj i zi,
Ndaj po goja lëng-qershi,
Ndaj po gjiri llaftari
Ty të dha çdo shije.

JE ULUR FORT

Kujtimi im që më s'më jep të qetë,
Kujtimi im q'u llaftaris pas teje,
Në qetësi është' ishtë prej rrufeje,
Në ças llaftare zjarr e flakë vetë.

Çkëlqen si prush kur skëterrohen retë,
Kur mall' i dhemshur ze buçet ndaj meje.
Kuptimin t'im o! ndjeje-ahere, ndjeje,
Se n'atë hof m'a ndrin ah! zemr' e shkretë.

Kaq mot-me-mot shkëndijat m'j-u shpërndanë
Gjith përmi kulm të bimës më së gjate...
M'j-u përvëluan gjith më tjetër anë... —

Je ulur fort, po syt' e mi të panë:
Plot me stoli kjo lul' e zemrës s'ate!
Si kopsht i mbushur plot me jargavanë.

OH, VANË FLETËT . . .

FRAGMENT

O vanë fletët e në zî-ra
Si mot-për-mot vjeshtori pyll.
Me zinë-e kohës çel dëshira,
Dëshira çelur — gazi mbyll.

Përtej nga-i jetave sinuar!
Dhe larg përjetë-helmori gas!
Po jo: ah, malli q'u pat shuar
Lind e rilind m'i ndritur pas.

Prej të brengosurave dete
Kam huar dhembje-e zemërim
Që të buças në krismë jete
Prej buçim-heshturit durim;

T'a shoh me sy prej vetëtime
Sy-vështrim-derdhurën-përdhe,
T'i flas magjinë-e fjalës s'ime
Ndaj shkon me turp si nuse-e re.

Ç'DËGJOJ ME SY TË TREMBUR

Ç'dëgjoj me sy të trembur fytyra që m'u prish?
Një këng' e laftaruar po vjen prej lartësish! —
Ah! zëri yt që zbriti prej botës së pa ane,
Po heth posi me ruaza në qelq të një kambane...

Këndimi yt, o vashë, tashi pikoj përdhe.
T'a ndjej si dhemshurohet më një magji të re.
E t'j-a kuptoj dëshirën ndaj po valon në mua,
Ndaj po më gjen ah! zemra dhe malli që m'u shtua

Tashi të ra këndimi, po fare nuk t'u vdar.
Un' e dëgjova tinës e mbeta mendimtar.
Më foli goja jote me ngashërim të letë
Që shpirt' i përvëlur m'u droth posi një fletë.

Tashi po humb sëfshehta ushtim' e zërit t'ënd.
Tashi t'u shua fare dhe më s'më vjen ndërmënd.
Haj! mëndja ime-e ndjellë prej zërit që të vate
U bë nga-dale këngë... dh'u shojt pas këngës s'ate.

TI PO VJEN QË PREJ SË LARGU

Ti po vjen që prej së largu magjiplotë-e dal-nga-dal.
Ti po vjen që prej së largu dyke shkitur mi lëndina.
Nënë thembërzat e tua përgëzohet trendelina,
Shtrihet luleja mitare e zëmbakut që t'u fal.

E si shkon me hap të matur më pushton një
dhemshuri:
Do të tretem të kullohem në kalim të këmbës s'ate,
T'i pushtoj i llaftaruar ato hapëza mëkate
Ndaj kalon mi tufë lulesh madhërisht si yll i ri.

Dhe të qaj me mall të rëndë poshtë teje pa pushim,
Poshtë fillit të poleskës ku do shkeli këmba jote.
Të të shtroj nga dhembja ime një çudi prej pikash
lote,
Një fluturë të përvajshme vetëm dhembj' e dëshërim.

Të m'a shkelish hije-letë! të m'a shkelish mes-për-mes!
Të të shoh si më lëkundesh me sy fjetur e fatuar,
Brenda lotëve të mija të të shoh të pasqyruar,
E pastaj le të venitem, le të hesht, e le të vdes.

AH, ME-ATË MALL
QË MË KE TI

(TRIOLETA)

I

Ah, me-atë mall që më ke ti,
Moj zemërzën m'a more:
Gëzon e qan në fshehtësi,
Ah, me-atë mall që më ke ti.

Një fshehtësi plot llaftari —
Plot ëmbëlsi vrerore.
Ah, me-atë mall që më ke ti,
Moj zemërzën m'a more.

II

E shtje qëpallën tatëpjet,
Pa shkon me turp ndaj meje;
Aq hije-rëndë-e-zemër-shkret
E shtje qëpallën tatëpjet.

Dh'atë vështrim që shket e vret
Posi një zjarr rrufeje! —
E shtje qëpallën tatëpjet,
Pa shkon me turp ndaj meje.

III

Bubu! ah Vasha qan me lot,
Moj Motrëza bujare!
Seç e zu Trimi-e s'duron dot...
Bubu! ah Vasha qan me lot.

Dhemb malli-i-djegur-durim-plot
Gjer i tret zemrat fare... —
Bubu! ah Vasha qan me lot,
Moj Motrëza bujare.

KU SHTROHET VALA . . .

(ROMANCË)

Ku shtrohet vala përmi zall
E fryn një këngë' e pakuptuar,
Të pashë, motër, plot me mall,
Më pe më shpirt të llaftaruar.

Q'ahere silleshim më nge
Gjith vet-i dytë, vet-e dytë . . .
Dh'i shtinja sytë gjith përdhe —
Gjithë përdhe m'i shtinje sytë . . .

Po me t'u ndarë vet e vet,
Më s'kishim turp që s'kishte fjalë . . .
Na ritej malli posi det,
Posi një det që vjen me valë:

E prapë silleshim më nge
Gjith vet-i dytë, vet-e dytë;
E prapë sytë gjith përdhe,
Gjithë përdhe pikonin sytë.

.
.
.
.

Q'ahere qamë plot me mall
Atë vështrimin e kaluar,
Ku shtrohet vala përmi zall
E fryn një këng' e pakuptuar.

Se kish kuptim, që s'kish kuptim,
Kuptim' i fellë-i mallit t'onë;
Se malli jon' ish zotërim,
Që robëron përgjithëmonë;

Se s'dashuronja-as un' as ti,
Po dashuronte dashurija:
Një dashuri — një fshehtësi
M'e fshehur sesa fshehtësija.

DORA JOTE LEDHATARJA

Dora jote ledhatarja, është e zbetë si qiri.
Dora jote ledhatarja lëshon dritën e dëborës.
Kur t'a ndjeu magjinë-e pastër që të shtrydheshe prej
dorës.

Shpirti im i frymëzuar rëgëtiu në llaftari.

Se me lëndë magjistare u pat bërë tul' i saj;
Tul' i saj u pat gatuar me vaj ere-e brumë dylli;
I dha hëna pah të ndezur, pluhur t'artë-i fali ylli,
E kështu m'u duk hirplote — haj! o dor' e vashës, haj!

Në vështrim të dorës s'ate ç'pat, o! balli që m'u vdar?
Ç'pat qëpall' e përlotur q'i ra pika tatëpjetë? —
Dor' e bryllt' e vashës s'ime, dor' e paqme, dor' e zbetë,
Vetëtiu me prush magjije e më bëri mendimtar.

Dora jote që më dhimset, dora jote që më çik
Dora jote që më shtrihet sipër tëmblave gjumashe;
Dora jote: zemra jote që t'u nda më pesë fashe...
Dh'u bë dorë të më ndali ndaj dyshoj se mos i ik.

POSI BURBUQ' E TRËNDAFILIT

Posi burbuq' e trëndafililit që çelte-e fshehur afër nesh,
Të çeli buza miturishte e më një ças t'u nënëqesh;
Ahëre hargu i hepuar t'a ndau përmes më dy thelpinj...
E t'a shijoj me ëmbëlsirë vështrimi im që më s'm'u
nginj.

Tash burbuq' e buzës s'ate i riti gjëndërat së rish...
Ajo zu lëng prej lylshtrydhjesh dh'u skuq me zjarr
prej kulumbrish
Ajo u ndes e mori valë, ajo u doq, ajo u poq,
E po më fal e dëshëruar një mall të fellë-edhe pa shoq.

Fillon më dhemb ah dashurija, e ndjej një brengë-e
çqetësim,
Më përvëlton buz'e zhuritur drejt mun në fund të gjirit
t'im,
Pa dhemshurisht e dyke vuar prej shpirtit t'ënd kur
e thëthi,
Si llaftarinë-e puthjes s'ate kuptoj në shpirt një
llaftari.

EJA, MOTËR

I

Kur vjen të mûgëtisë e qetë
Që nëpër pyje e nëpër male,
Në shpirtin t'îm pushon çdo jetë
E bije nata me-nga-dale.

Ahere çduket yll' i ditës
T'u dredhur hështazi në natë,
Dh'e mbyll vështrimin vetëditës
Prej hapësirës së pamatë.

Sesi m'a nxin, o! dashurinë. —
... Po dita shuë, dita ndezet,
E gjithë më dëndur venë-e vinë
E perëndimet e mëngjëzet...

.
.
.
.

Më dridhet shpirti posi fleta
E buzëqesh sa vjen më rallë,
E jet'e vet q'e rroj vërteta
Më shëmbëllen me një përrallë.

Në këtë ças të perënduar,
Ku po më dirgjen syt' e qarë,
Mos u zembro se pata vuar
E të thërrita me llaftarë;

Mos bëj të keq se për së pari
Më pati bindur dashurija
Të bëjë sunbulla prej ari,
Prej pika loteve të mija:

Ndaj vëndi-i zi, ku mbeçë-i huaj,
As eja! motër, si ngahera!
As afërò-m'u! të të çquaj
Nër mijë vashëza të tjera!...

Sepse tashi jam dëshëruar
Që të më çfaqesh ndaj nat'herë:
Mi syt'e mi q'u patnë shuar
Magjin'e syvet t'i m'a shtjerë;

Më kuvëndo me zë të tretur
Gjith më së paku-e më së paku,
M'a çik qipallëzën e fjetur
Me gishtërinj si prej zëmbaku;

Edhe kështu qëndró përjetë
Larg njerëzisë-e pranë meje:
Të të pushtoj me shpirt të njetë,
Posi me flakë prej rrufeje. —

II

... Ndaj do m'i falish syt'e tua,
Qipallë-dëndur-tatëpjetë,
Do më vërresh posi pallua
Drejt mun në zemërzën e shkretë.

Dh'ahere soje do buçasë
Prej dhemshurish një yll së brëndi,
E pamj'e lumtur do më ngjasë
Sikur t'a shihnja përnjëmëdi:

E pamj'e jetës së vërtetë
Do të më ngjasë-e ëndëruar,
Kur të më çikish hije-letë,
Me gishtërinj të llaftaruar.

Ah! motër til! se gjith më fshijesh
Nga çasi-i ditës kujtim-mirë:
Dhe ja!... posi nër dritë-hijesh
Më vjen e shkon në mugëtirë.

Më çdukesh ditën e më dukesh
Pa të pandehur nat'për-natë:
Fytyr'e thurrur prej balukesh
Më buzëqesh me përgjërata.

Dh'as për kudò s'të çfaqet hija,
As për së fundi-as për së pari —
Veç kur-e-kur nga syt' e mija
Lëshoj dy sumbulla prej ari:

Dh'ahere ndjej se më je qasur
E dhemshurisht më puth në ballë,
E mall' i zemërës së plasur
Më psherëtin sa vjen më rallë.

Edhe stolitë-e dashuritë
Më sillen varg nër pikëllime,
Pa del në qjell një yll me dritë
Prej shpirtit t'im, o motra ime.

VDEKJA JONË

I

Pa shijmë, shijmëzë detar
Mi lundër venetiku!
Zu po dremit vetëtimtar
Ndajnatë-Adriatiku.

Dhe po të pres me shpirt të vet
Të vemi dal-nga-dale
Ku-i jep mëshirë-i tmershmi det
Së pamëshirshmes vale...

II

Ërgjënd' i hënës vajzëror
U ndes me gur të shtrentë,
Po ndrin kaq heshtur e paqtor
Nër funde uj'i shentë.

E përmi detin që pushon
Del Vashza dhe Trimi... —
Dh' ashtu filluam më të von
Një këngë dëshërimi.

III

Zu po ngre valë-i tmershmi det,
Qëndresa-i humb shkëndijat...
Pa shij-i motër, syt' e vet
Si ngjajnë me të mijat!...

Që sot, ti botë do mbash zi
Një Mall që vdes përjetë:
Tërheq dy veta uj' i zi
Dh' i tret posi një vetë...

ËNDËR ZILITARE

.....
Që larg e me trishtim nër syt' e mi
Kur pyjeve të pata shëmbëllyer —
O! s'është' ajo! O, s'është kursesi!
Bërtita që prej zemërës së thyer
Kur pyjeve të pata shëmbëllyer —
Më kishte rob e tmerrëshmjja zili.

Ahere syri yt ish malli-i em, —
Ahere kuvëndonja-i llaftaruar.
Haj! ëndër ti... po si? po kujt t'j-a them
Një zë po më flet në kraharuar? —
Ahere kuvëndonja-i llaftaruar
E m'ish mendimi-e zemra m'ish ujem.

Po sa pa dalë-agimi për mi mal,
Prej gjumit pa m'u çdukur ëndërritja,
Luftimi-i zemrës tinëza m'u ndal:
Pra ligjëratën vashëzës ti prit-j-a!
Prej gjumit pa t'u çdukur ëndërritja,
Trimush! se ja! po flet me-dal-nga-dal:
Në gji më ke... në gjirin t'ënd, o trim...

E kur mëngjezi zu të buzëqeshë,
Më sgjove, motër, me një pipëlim...
Po dil! prej gjirit t'im, o pëllumbeshë!
Se ja! mëngjezi zu të buzëqeshë:
Do vemi nëpër pyj me udhëtim...

DËSHIRAVE

Dëshirave, dëshirave, mikeshë,
Dëshirave të shuara qëkuri,
Një fat që m'i pat nxirë-e m'i përzuri
Sot ardhi përsëri t'j-u buzëqeshë.

Dëshirave që lindin këtë ditë,
Filloj t'j-u neveritet lumtërija,
Mendojnë dyke heshtur mënt' e mija
E s'gjejnë kurrëkund një reze dritë.

Dëshirave që kanë për t'u sgjuar
Se ç'helm zemërim-plot do m'i lëndojë?
Se ç'hir mëshirë-math do m'i gëzojë?

Mjerush e me vështrim të ngushëlluar
Shoh fletët ku prej qielli ra menjë
E pamja po më ngjan me një rrëfenjë.

KUR NË FLAKË

Kur në flakë të qiririt ze mendohem net-për-net
Dh'e ndjej shpirtin e kulluar nëpër dritën që më tret
Prej skëterrës së pa mate më del bot' e ëndërruar,
Vetëm ti, o im-e dashur net-për-net më ri larguar.

Po çdo ëndër që më çfaqet prej skëterrës së pa fund,
Çdo mendim i llaftaruar që më dhemb e më përtund,
Dyke rënë prej së lartash posi pikë zembërate
T'i përshkohet për-së-felli bukuris' së qënies s'ate.

T'i përshkohet mes-për-mezi dlirtësis' së shpirtit t'ënd,
T'a merr pamjen e fytyrës, bëhet shkronjëz e kuvënd.
Ay del prej shkretëtire mënt' e mi të m'i stolisë
E ka tingëll llaftarije, ka verbimin e magjisë,
Ndrin i kthiellt e i pastër si pasqyrëz' e një kroj
Pa nër të fytyrën t'ënde t'a vështroj... nuk t'a
vështroj...

O! fytyr'e vjershëruar që më mbush me dëshërimë!
Q'i fal gas përjetësisje dashëuris' së zemrës s'ime!
Që më bën kur mënt' e mija rëgëtijnë varg e varg
Të të ndjej aq fare pranë, të më jesh aq shumë larg.

RI ME SHËNDET

Që sot një vënd i huaj më ka thërritur pàs:

Vënite motër buzën, e mos e bëj më gas.

Nga bot' e lumtërisë vështró nër syt' e mi

Me shpirt të zëmëruar e plot me dhemshuri.

O, psé kaq ëndr' e bukur më s'lumtërovi dot!

Përse m'a njom qipallën kjo valle pikash lot!

Tani shënden' e fundit kam dashur të t'a fal —

Posi një perëndeshë afró-m'u dal-nga-dal,

Me flokë përmi supë, me robe gjer përdhé,

Do të pushtoj nër kraha me një magji të re,

T'a dish sesá 'sht' i valë ky mall që po më tret,

Sesá m'u pate dhemshur t'a dish me të vërtet.

As éja! éja! në zjarr të gjirit t'im!

Vrapó si fill rrufeje! çkëlqe si vetëtim!

— M'a ndrit me një të parë fytyrën që m'u mvrejt!

— Më shih me sy pëllumbi në zemër drejt-për-drejt.

Të ritë-e zemrës s'ime, greminë pa kufi:

Sí do t'i mbushnje anët veç ti, ah! vetëm ti:

Sesí do të më ritej, nër kohë paskëtaj,

Një yll përjetësije drejt që nga fund' i saj!... —

Që sot mjerim' i vjetër në shpirt m'u përtëri,

Po m'a zembron të pritmen një fat shumë m'i zi.

Dhe ah! e desha veten prej teje t'a kem plot!

Kjo dashurija jonë do ndriti më të kot?

Vrapó me hap të letë e mos u ndal aspak,

T'a nisim dyke pshuar mërgimin zemërak,

Të qajmë shoqi shoqin së bashku që të dy.

- Të puthemi në flokë, në ball-edhe në sy:
— Sá dhemb mërgim' i largë që do na lerë pás
— Më pranë njërijatrit të dehemi në gas...
— E sá të jemi dehur në gas e lumtëri,
Më hidhur të na dhembi largimi jon' i zi...
Sepse ky malli jonë më s'pati shëmbëllim,
Se na 'shtë vaj një këngë, dhe kënga nj'ëndërim,
Pá çmallje, pá të sosur, pá nojmë kurrëkund,
Siç ish, siç do të jetë — një dashuri pa fund.

LAMTUMIRË

Më del e ze pshon më të fshetë,
Një breng hije-rëndë mi sy;
Përbrënda në zemrën e shkretë
M'i shtje drejt-për-drejt që të dy.

E loti prej syve të tua
Rëngjethet valomë përdhe:
M'j-a ndjen vështrim-bukur-pallua
Ti zemrës greminën e re...

Po këngët që sot më nuk janë,
— Stolisen me mall në mërgim.
Përmbytur mjerimesh pa anë,
Ndrin Yll' i të riturit t'im.

LAMTUMIRË

VARIANTE

Më vjen edhe pshon me t'u qasur,
Një breng hije-rëndë mi sy.
Përdrejt mun në zemrën e plasur
M'i shtje llaftarisht që të dy.

Bje loti prej syve të qarë,
Venitet rrëmbyer përdhe:
M'j-a ndjen zemërimin e parë,
Ah! motër ti dhembjes së re...

Sot këngët që vanë-e më s'janë
Buçasin me mall në mërgim,
Pa-i mbytur mjerimesh pa anë
Zbret Yll' i të riturit t'im.

LAMTUMIRË

VARIANTË

Më del përkundrejt dyke pshuar,
Një breng hije-rëndë mi sy,
Pa fellë në shpirt të shkretuar
M'i shtje drejt-për-drejt që të dy.

Dhe loti prej syve të thata
Gremiset si valë mbërdhe,
Që sot iku dita, vjen nata
Me yj që më s'ndrijnë si dje.

Pra këngët që vanë-e më s'janë,
Përmbysten me mall në mërgim.
I ngrysur mjerimesh pa anë
Vdes Yll' i të riturit t'im.

LAMTUMIRË

VARIANTE

Më del me-atë hir të zemruar
Një breng hije-rëndë mi sy,
Që sot kur po ish i mërguar
T'i shoh drejt-për-drejt që të dy.

Ra loti prej syve të tua
E vate kulloj gjer përdhe:
Në pikën q'u tret nënë mua
Qan zemëra vajën e re.

Ju ditët e mallit prej flake!
Ju nete me ëndëra plot!
Sesi m'ju pushton varfanjake
Ky det i një sumbulle lot! —

Sot pikave lot që m'u thanë
J-u ndjeva të parin kullim,
Pa dridhet liqeri pa anë
O vashë-e të riturit t'im.

TË RITË-E VITEVET
TË MI

KËNGË

Të ritë-e viteve të mi
M'a fryri fati zall më zall:
Sesi çkëlqenje në stoli
Kur më pat zën' i pari mall!

Të ndrinin flokët posi ar
T'u derdhur supës tatëpjet,
E të vështronja zilitar
Në sy të fellë posi det.

E shtat'-i-shkundur-hije-plot
Aq bukuri pa shëmbëllim:
Aq dhemshuri ky mall i kot,
O pëllumbesh' e shpirtit t'im! —

Të ritë-e viteve të mi
M'a fryri fati zall më zall:
Ti perëndove në stoli
Sa më pat zën' i pari mall.

Që sot i ëndravitë varg
M'u mbyll në gji si nënë varr,
Dh'u nisa për në vënd të larg
T'u djegur pàs si yll me zjarr.

Po nga mërgimi zemërak
Të pres me mardhje të më vish,
Të më rrëfehesh si zëmbak
Nër mijë lule dhemshurish:

Nër mijë shpesë një pëllumb
Q'i mbenë shokët aqe pas...
E zin' e jetës do t'a humb,
E buzën do t'a bëj më gas. —

... Tashi ah! djelli vate-e shkoj
T'u përvëlur përmi dhë;
Nga zemr' e tija fluturoj
Një reze-e bukur nëpër re:

Nër zemërimë ku po qaj
Vjen lajm i ri plot ëmbëlsi,
Pa më mbush n'emërin e saj
Me dritë-edhe përjetësi.

*Të ritë e viteve të mi
Më'a fryti, fletë të allë
Së cilëlloje nëp' deti
Kështu më fut nënë e për' viall!*

*Me këmbë flakët për' at
T' u dëndur nëp' kalë të cilë
E të vështrime nëp' deti
Më' q' të fletë për' viall!*

*E shtëpi e shkollë nëp' qytet
Ky këmbë për shkollë të cilë
Ky shkollë nëp' viall e det,
O pëllumbë e shpirtë të mi!*


*Të ritë e viteve të mi
Më'a fryti fletë të allë
Së cilëlloje nëp' deti
Kështu më fut nënë e për' viall!*

*Që në ç' dëndur nëp' qytet
Më'a fletë nëp' viall e det,
Dhë e viall për në viall të cilë
T' u dëndur për' nëp' viall e det.*

*Për nëp' viall e det
Të për' në viall e det
Të për' nëp' viall e det
Viall e det nëp' viall e det.*

*Me një vështrime nëp' qytet
Ky këmbë për shkollë të cilë
Ky shkollë nëp' viall e det,
O pëllumbë e shpirtë të mi!*

LASGUSH PORADECI



Lasgush Poradeci
Lasgush Poradeci

LASGUSH PORADECI: NJE NGA DORESHKRIMET E FUNDIT TË VJERSHËS „TË RITË-E VITEVE TË MI”

KUR TË MË JESH E ZEMËRUAR

Ti m'u rrëfeve për së pari shkrepëtimtare në stoli,
Un' ëndërrova se në zemër po më valon një mall i ri.
O, ç'ka që m'u venit qipalla me kaq të ngjethur të
pafaj?
Haj! shkretëtirë-e zemrës s'ime! Dhe haj! e zeza jetë,
haj!

Po si një yll i perënduar më pate humbur gjith më
larg...
Nga malli yt i thura fjalët gjith sërë-sërë-e-varg-e-varg;
E çdo mendim e pata tretur vetëm n'ërgjënd e në flori
O, vashë-e lotit të zhuritur që vetëtin nër syt' e mi. —

Prej largësirës së pa anë kalon durimi mot-me-mot...
Pas kaqe kohë dhemshurije, ndaj vëndi-i lum as éja
sot!
Në gjirin t'ënd të llaftaruar m'a lerë mëndjen t'a
humbas,
Të ndjej si zemra më gatohet plot me dëshir' e plot
me gas.

Ti buzëqësh-më zilitare, e më çkëlqé si vetëtim,
E më vështró me sy pëllumbi drejt mun në fund të
shpirtit t'im;

MALLI

Syri-i bukur që t'u mvrejt —
Syri yt që më lëndon —
Do më lerë-a von a shpejt,
Do më lerë-a shpejt a von.

Sapo shpirti m'u dëlir —
Shpirti im i nxirë krejt —
Do më lerë me pahir
Syri-i bukur që t'u mvrejt.

E do mbetem përnjëmënd
Varfanjak si mbret pa from:
Mbretëresha që më çmënd
Do më lerë-a shpejt a von

Do më lerë-a von a shpejt,
Do më lerë-a shpejt a von,
Syri-i bukur që t'u mvrejt —
Syri yt që më lëndon.

Do më lerë... A! po si —
Qoftë-ahere-ose tashi —
Do të qaj aq dashuri
Që do humb me mall të ti?

Mua mëndja s'm'a kupton
Mua syri s'm'a vështron,
Pa fillon edhe vajton,
E kullon, kullon, kullon:

Mall! o mall! që vjen e shkon!...

.
.
.
.

Vjen e shkon e prapë vjen,
Mall që len nga perëndon:
Len e vjen e zjen e bren:
Malli mallin më s'e gjen. . .

MË ZU NJË MALL

Më zu një mall dhe sot,
E s'mund t'a shuaj.
Ri vasha largë-o Zot,
Që kaq po vuaj.

Kalojnë kot më kot
Muaj më muaj.
S'vjen vasha sot as mot,
Pa heq e vuaj.

Nuk vjen, e më s'di dot
Ç't'i them t'i shkruaj!
Ah! mëndja po më lot
Që s'plas e vuaj!

Në vëndin t'im o Zot,
Jam vetë-i huaj.
M'a sill ti vashën sot,
Që kaq po vuaj.

MË ZU NJË MALL DHE SOT

VARIANTË

Më zu një mall dhe sot,
Një dhembje-e fshetë.
Ri vasha largë-o Zot,
Që dirgjem vetë.

Kalojnë kot-më-kot
Muajt e qetë.
S'vjen vasha sot as mot,
Pa vuaj vetë.

Sí vate-e lashë dot
Aq zemër-letë!
Ah! mëndja po më lot.
Që s'plasa vetë!

Për mua s'ka sot
As botë-as jetë
M'a sill ti vashën Zot,
Që dirgjem vetë.

MË ZU NJË MALL DHE SOT

VARLANTË

Më zu një mall dhe sot,
Një zi vajtare.
Ri motra largë-o Zot,
Që s'duroj fare.

Kalojnë kot-më-kot
Shpresat bujare.
S'vjen motra sot as mot,
Pa më s'mund fare.

Ç'e lashë-e vate o Zot,
Aq zemërgjare!
Ah! mëndja po më lot
Që s'plasa fare!

S'm'i mbyllet plaga dot
Zemrës së vrare.
Ri qaj përmys zi-plot
E shuhem fare.

QË LARG

Hidhur del nga shpirt' i zi
Breng që s'ka të ngjarë.
Dridhet mun në fund të ti
Zemërez' e vrarë;

Dridhet ndaj më s'po duron
Brengun e pahirë —
Këtë mall që fryn e shkon
Nëpër shkretëtirë;

Shkretëtir' e shpirtit t'im.
Sá m'u pate entuar!
Djeg posi një perëndim
Yll' i përvëluar;

Yll' i çdukur aqë larg —
Këngët që më s'janë —
Po më çfaqen varg-e-varg
Në kalim pa anë;

Dh'i vështroj me dhemshuri
Ndaj venë, ndaj vinë,
Pa dëshira mun në gji
Zjen për dashurinë;

Dashuri! që mbete pás! —
Luleja me erë! —
Psé kalon si yll me gas
Nëpër shpirt të mjerë!

Ah, sesá më ndrin për-mot
Moti që m'u shua!
Si m'a mbush ah! shpirtin plot.
Me stolit' e tua!

Me ç'stoli më perëndon
Drejt në zemër vetë,
Dashuri që vjen e shkon.
Po nuk vdes përjetë!

.
.
.
.

Drejt në zemër ndaj fundet
Mall' i përvëluar,
Tundet zemëra si det
Dyke uturuar:

Papo del nga shpirt' i zi
Yll që s'ka të ngjarë:
Ndritet në përjetësi
Zembërez' e vrarë.

VALLJA E YJVE

Yjtë e ndezur si fingjill,
Që vërtiten palë-palë,
Prej mosgjëje zunë fill
Plot me jetë-e mall të valë.

Zunë fill me dashuri
Që kur bota zu të ngjizet,
Pa sikush për shok të ti
Përvëlohet edhe ndizet,

Ndizet ças edhe për ças,
E si kurrë s'ka të shuar,
Pá pushim i vete pas
Me një sulm të llaftaruar.

E si kurrë nuku mund
Ylli yllin që t'a kapë,
Rrotull qiejve pa fund
Venë-e vinë-e venë prapë...

.....
.....
.....
.....

Do të venë fluturim
Kudo janë-e kudo s'janë,
Nëpër qjell që s'ka mbarim,
As fillim, as fund, as anë.

Kur mi të, kur nënë të,
Kur me hirë-e kur pa hirë,
Do përçajnjë gjithënjë
Hapësirë... shkretëtirë...

Ata ikin varg-e-varg
Me një etje të pashuar:
Sesá fellë!-e sesá larg
Shoq me shoq u pat larguar!...

Kúsh j-u fali-aq dëshërim,
Dh'e aqe zjarr e aqe flakë,
Dh'i gatoj me aq durim
Yjtë-e lum e varfanjakë?

Se do një si për çudi,
Kur prej syresh rreth të ftohet,
Shoq i vet nga mall' i ti,
Mê me zjarr ze përvëlohet...

Dh'i vjen qark më me vërtik
E me dhembje më të njetë,
E si ik... si gjithë ik...
E pushton me zjarr të vetë:

Sá më pak e shëmbëllen:
Aq më shumë-e djek dëshira...
Pa nga malli që s'e gjen,
Dridhet gjithë hapësira.

...Kur po ja! se që përtej
Ndriten erërat nga pakë:
Ylli-i çdukur nëpër qjej
Vetëtiu e mori flakë:

J-a pat shtënë më një ças,
Mun në mes në kraharruar,
Shoq' i vet q'i sillej pás
Me një sulm të llaftaruar;

Q'e kish flakën mun në gji,
Q'e zhuritte dashurija,
Që çkëlqente me zili
Rrotull rezeve të tija.

Yll i mjerë e yll i lum!
Yll i lum e yll i mjerë!
Sapo drita t'u përgjum,
Sheh një shoq nëpër skëterë:

Ay vin... e gjithë vin...
Gjithë më pranë...e gjith më pranë... —
Sesá ndrin e vetëtin!...
Sesá ndjen një gas pa anë!...

Sesí ndritesh përsëri!
Sesí ndizesh përsëri!
Sesí djek me dashuri
Posi yll margaritari!...

Dashuri! Heu! mall i ri!
Dashuri! këng' e durimit!
Ti liri! Ti robëri!
Ti valim i shkrepëtimit!

.
.
.
.

Yjtë-e ndezur aqë larg,
Lozin vallen e dëshirës
Dyke ndritur varg-e varg
Nëpër terr të hapësirës.

KROJ I FSHATIT T'ONË

I

Kroj i fshatit t'onë, ujë i kulluar,
Ç'na mburon nga mali dyke mërmëruar.

Venë mbushin ujë vashat an'e-mbanë,
Cipëzën me hoja lidhur më-nj'-anë;

Cipëzën e bardhë, cipëzën e kuqe,
Gushën si zëmbaku, buzët si burbuqe.

E si mbushin ujë, bubu! ç'm'ju ka hije
Ndaj këthenen prapë me hap nusërije:
Ndezur yll' i ballit si yll shentërije.

II

Kroj i fshatit t'onë, gjyrë-'rgjëndi-i-lyer,
Që nga rrëz' e malit ç'na mburon rrëmbyer.

Venë pijnë ujë trimat an'e-mbanë
Takijen me lule përmi sy më-nj'-anë.

Takijen e dli-rë, takijen e nxirë,
Buzën më të qeshur... më të psherëtirë...

Mbrënavë kur uji mërmëron nga-dalë,
Vjen t'i thotë trimi vashës nj'a dy fjalë:

Vashëzënë bujare që po vij më krua
Seç e përshëndeta, seç m'u turpërua
Papo ula kryet e shkova si grua.

III

Kroj i fshatit t'onë, tetë sylynjarë,
Në tetë krahina qënke kroj i parë;

Qënke një në botë, s'paskërke të dytë,
Ç'na shëroke plagët, ç'na shëroke sytë. —

Kroj i fshatit t'onë, n'atë mal me fletë,
Derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë,
Posi mall' i zemrës mun në gji të shkretë:

Derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë,
Posi mall' i vashës, që djeg më të fshetë,
Posi mall' i trimit, që buçet përperjetë,
Obobo! si malli, që nuk vdes përjetë.

TRIOLETA

I

Pik' e loteve të mija
Vetëtin si gur i rrallë.
Shkrep me zjarr posi shkëndija
Pik' e loteve të mija.

Bukurija, bukurija
Më pat puthur mun në ballë:
Pik' e loteve të mija
Vetëtin si gur i rrallë.

II

Si m'u ndrit çdo mall që pata!
„Miq, o! kim'a-ni zilinë!...
Ardhi dita: iku nata —
Si m'u ndrit çdo mall që pata!

Varg-e-varg me përgjërata
Para sysh më venë-e-vinë...
Si m'u ndrit çdo mall që pata!
Miq, o kim'-ani zilinë.

III

Këto kopshte ku fryn era
Muar gjyrën e floririt...
Se ç'm'i shkel baluke-prera
Këto kopshte ku fryn era:

Parëvera! parëvera!
Po më çel në mes të gjirit —
Këto kopshte ku fryn era
Muar gjyrën e floririt.

SYT' E LUMTUR

Ishe vogëloshe... isha mituri...
Kur më dole mbudhë, ti moj lumja ti!

Vinte perëndimi më të vagëlluar
Pa m'i shtire tinës ata syt' e shkruar.

Ata syt' e shkruar, sytë moj të fjetur,
Shtatë vjet me-radhë t'i kam përshëndetur.
Kur më pe së pari, more-e m'u largove,
Kur më pe së dyti, more-e m'u afrove,
Kur më pe së treti, more-e më pushtove,
Të putha në gushë, ti m'u turpërove.
Papo ule kryet e shkove-e vajtove.

SYT' E VARFËRUAR

Ishte vash' e rëndë... isha trim i ri...
Kur më dole mbushë, ti moj mjera ti!

Mjera seq' m'u prishe, vashëza moj vashë,
Ndaj më pe sëfshehta me ata sy gjumashë.

Të bij përmi kraha cip'e nusërisë...
Brenda mun në zemër bubu! cip' e zisë;

Bubu! shtatë jeta s'të kam për të gjetur,
Pa zë më qan syri si ves' e patretur,

Si ves'e patretur që kullon farmaqet
Lot' i përvëluar do m'i lagë faqet;

Do m'i lagë saqet, do t'i fshi me duar,
Do kujtoj me dhembje kohën e kaluar,
Mjer! as un'i mjerri, ç'pata dashuruar:
Mall' i zemrës s'ime: këngë-e-vaj-bashkuar:
Këngë-e pakënduar: vaj-i-pavajtuar:
Posi shpuz' e zjarrit nënë gji mbuluar.

MBRETËRIJA JONË

(TRIOLETA)

I

Kjo fjala jote, ti moj ti!
Mban erë lule-karafili;
Pikon si sumbull ëngjërv
Kjo fjala jote, ti moj ti!

Un' e dëgjova-e mun në gj
M' u duk se po këndon bilbili —
Kjo fjala jote, ti moj ti,
Mban erë lule-karafili.

II

Bilbili që këndon më nge,
Këndo një këngë zilitari:
Tha se m' u skuqe kur më pe...
Bilbili që këndon më nge:

E se me turp e sy-përdhe
Të pata folur për sè pari... —
Bilbili që këndon më nge,
Këndo një këngë zilitari.

III

Popo! ky malli ç' u bë det!
Ti more mik! ti moj mikeshë!
Me dy-tri ditë-e dy-tre net
Popo! ky malli ç'u bë det:

Ç'filloj një mbretëri një mbret...,
Një mbretëri një mbretëshë...
Popo, ky malli ç'u bë det,
Ti more mik, ti moj mikeshë.

SYT' E TU VETËTIMTARËT

Syt' e tu, vetëtimtarët, i mbulon pluhur i zi.
Syt' e tu vetëtimtarët ndezin yj mi vala detesh.
Me vështrim të perënduar, kaq hirplote ti më mbetesh
Si t'i fshen qipall' e rëndë të paçmuarat stoli.

Kur i pash' oh! në nat' helmi, hën' e largë-ish derdhur
n'ar.
Kur i pashë në nat' helmi, ar i derdhur m'u bë zija;
M'u bë gas ndaj fërfëllonte vgjeri-i shent' hijen e tija:
Mi shtrat flete sapo shtruar... na shij qjelli zilitar...

Syt' e tu — enigm' e kohës; syt' e tu — çudi pa çmim;
Syt' e tu — çkëlqim gazmuar i skëterrës dhemshurishte.
Kish durim yll' i zhuritur, yll me zjarr durimi kishte,
Që krijoj kaq dritë djelli, që mbaroj kaq dëshërim.

Syt' e tu, vetëtimtarët, sillen qark gjeratorisht.
Syt' e tu vetëtimtarët ëndërrojnë aq të qetuar.
Ndaj shtron hijen vgjeri-i shentë kur i putha-i
llaftaruar.
Syt' e tu vetëtimtarët buzëqeshnë dhemshurisht.

NJË YLL PËRJETËSIJE

Të pashë për së pari në zi të jetës s'ime,
Nga vënd' i lumtëruar ti vinje me-nga-dal.
T'a kishte ndritur udhën një valë shkrepëtime,
Një fërfëllim i hënës që ngrihej përmi mal.
Kúsh m'i pat hequr çapet ndaj çapeve të tua?
O, cili më drejtovi nër kaqe lumtëri?
Se ja!... si prej çudije, gjith jeta m'u ndërua:
M'u vesh dëshir' e vdekur ha! më një gas të ri!

Vjen mall' i ëndëruar... e shkon... — edhe ti vashë
Ri më lëngon së tejmi... nuk dukesh kurrëkund...
Të ndjej si nëpër mjegull me syt' e tu gjumashë,
Me sytë që më dhimshen në zemër mun në fund.
E bukurinë, -o motër që nuku kish të ngjarë,
Po t'a mbulon harrimi që sot e paskëtaj!
Nga pik' e largësirës të shoh me shpirt të vrarë —
Haj! shpirt i varfëruar vetëm në zi dhe vaj!
Si qesh një foshnjë-e vogël me lodrëzat e veta;
I cik, i puth, i luan, i rrëkëllen me gas,
Dh' ajo q'i dhemb më tepër dh' e çduki tatëpjeta,
Me sy të zembëruar nj' asaj i sulet pas, —
Kështu stolitë-e jetës m'i pat dhuruar fati:
Stolinë më të dhemshur m'a shpuri më përtej;

Më vate motr' e ëmbël me gjithë mall që pati,
E s'kam të keqtë-e shpirtit ah! kujt të ja rrëfej.

.....

Kush tha se ngazëllimi s'më pati falur pjesë?
O, cili kuvëndovi se mbeta varfanjak?
Nga-dal! nga thelbi-i dherit zu malli të thërresë!...
Një pamj' e lumtëruar po duket pak-ngapak:
Ajo fillon së largu në këtë ças të von,
Sa vete-e ngjan se ritet... sa vete-e përparon...
Sa vete-e shoh më afër... e vin... e gjithë vin...
Çkëlqehet posi rezja që ndrin e vetëtin
E ja!... se përnjëheresh m'u errë-o! syt' e mija
Më një verbim magjije prej mijërash shkëndija!...
Sesà një flak' e pastër që po më djek në gji!
Sesà m'u mbush kjo zemra plot këng' e ëmbëlsi!
Sesà nër pah shkëndijash, sesà nër valë drite
M'u veshe sot, o motër, e ndrite-e vetëtite!
Kjo ditë lumtërije që nuku ka të ngjarë,
Si hir i perëndishmë në shpirt më pati rarë,
M'u çduknë pikëllimet e vanë sërë-sërë...
Lëkundet nër të fella e dridhet bot' e tërë;

Një yll përjetësije u ndes në shpirtin t'im!...

— Ju botë! që lëvrijni nër qiej pa pushim!
Përse nuk shuhi fare! po diqni aqe pak!
Përse nuku ndaloni haj! rrutullimin t'uaj!
Të shihnit prej së lartrash, me syrin zemërak,
Në ç'dritë lumtërije çkëlqeu ky dhë i huaj!...

M'i njetë sesa zemra, që djek si flak' e qetë,
M'i ndritur se mendimi që shkrep si vetëtim,
E sesa do dëshirë m'i ndritur e m'i njetë
Ësht' yll' i dashurisë q'u ndes në shpirtin t'im.

MBRETËRIJA E ZEMRËS

Kur hapet perëndimi pas maleve përposh,
Ti vjen, o motr' e ëmbël, në shpirt të më qëndrosnë;
Ti zbret vetëtimtare, e fellë-edhe më fellë;
Në fund të zemrës s'ime fundet posi një djellë;

Fundet posi një djellë që vdes në perëndim.
Dh' ahëre prej skëterrës ku-i humbe shpirtit t'im.
Ku dyke perënduar më le me gisht në ballë...
Nga-dal e magjiplote, ti shkrep si yll i gjallë.

Sesà një natë-e errët po mbretëron tashi!
Sesà po dirgjet bota më një pushim të zi!
Sesà me reze t'arta, sesà me lumtërimë
Ti po çkëlqen, o motër, në fund të zemrës s'ime!

MËRGIM

U nis burimi zemërak
Prej shkëmbit të ronitur,
Dhe shkoj i pastër si zëmbak
E dyke pëshpëritur.

Ahere jargavan' i ri
Q' e pà me shpirt të gJORë,
Një degë t'ulur sipër ti
J-a sgjati si një dorë...

Ahere dega që vështroj
Ndaj shkëmbeve si thyet,
E drodhi lulen e rënkoj
Dhe j-a veniti kryet...

Dh' ahere luleja q'u tund,
E ndoqi larg së koti,
Pa që prej degës mun në fund,
Pikoj si pikë loti... —

Ish dora që më përqafo,
Ish kryet e anuar,
Ish lot' i Vashës që pikon
Pas Trimit që pat shkuar.

RESURRECTIO

E kur të kem-mbaruar për një pushim të ri.
Nuk pata mall, o vashë, që të më rish në zi,
E s'dua të brengohesh, as dua të më qash
Me zë të pikëlluar posi me vajë grash...
Ti ëja që me natë ndaj tumb' e varrit t'im,
Pa dalë zbardhëllimi vrapò si vetëtim:
Në vënd të zembëratës... nis këngën e ja merr —
Përse të qash kalimin e natës që u sterr?
Vaj! trimi yt, o motër. më s'gjindet përmi dhé,
U ndeh mi sytë-e tija një mjergullëz e re;
Pas helmit të mjeruar q'e treti në të ri,
E nxiu në ças të vonë një vaj shumë m'i zi.
... Nis këngën e m'ja thuaq ngadal e magjiplot,
Të bjerë pik' e këngës si bjen një pikë lot;
Të zbrazet dyke rjedhur prej syrit tatëpjet,
Të mbushet shkretëtira e varrit që më tret.
Oj! se çudë-e madhe do ngrihet që përposh,
Me shpirt të llaftaruar ti shih të m'a dëgjosh;
Vërreh si fryn sëfshehta fullim parëverak,
Nga fund' i gropës s'heshtur si ngrihet pak-nga-pak;
Ay fërrmon nga-dale e luan përmi shesh...
E fryn shumë-e-më-shumë... e rreh shpesh-e-më
shpesh...
E ritet... ritet... ritet mi gropëzën e shkret;
Posi një frymë-e gjallë... posi një zë që flet...
E ja! se fund' i jetës u ndrit e u përflak.

Prej varrët të përvajshmë vjen lajm parëverak:
Ha! fjala fat-miroshe! q'u shojt pa shpres' as miq:
Ha! ç'po flet trimi, -o vashë! q'u çmënd edhe që vdiq:
Ha! këjo këng' e djegur e ligjërimit t'ënd:
Nga gjum' i shkretëtirës e sgjoj me një kuvënd... —
Sesà me gas të pastër ti po këndon tashi!
Sesà po mallëngjehesh me vajë-e dhemshuri!
Sesà-i pashëmbëllyer, sesà dëshirëplot
Zu të m'a njomë syrin një varg prej pikash lot!...

O motër! kënga jote më fali-aq dëshërim
Kur të kish patur pranë qipall' e syrit t'im;
E kur m' j-u çduke pamjes, kur të pat lënë pàs,
Më fale,-o pëllumbeshë përjetësi dhe gas.

LETREKËMBIM

Ti qan që larg se vate dashurija?
Vate-e mbaroj e më s'i mbet as hija,
E na la pàs po zinë-e dhemshurinë?

Zi-dhemshuri! që m'i merr mënt' e mija!
Zi-dhemshuri, s'm'a merr dot fshehtësinë!

E nuk m'a ndal një yll që m'u pat shuar,
E nuk m'a ndal rrufe që pat dërmuar,
As ata sy që vanë-e më nuk ardhë:

S'm'a ndalni dot ah! dhembjen e treruar
Të bënet zjarr e flakë-e dritë-e bardhë!

VATE PRILLI

Vate prill' i trimërisë,
Më zu maj i dashurisë.

M'u shti vashëza në gjumë,
E-ëmbra-mi-shoqe-shumë.

Do t'a mar t'a kem për fare
Moj lesh-verdhën-lozonjare.

Ah! lesh-verdhëza-si-ftua,
Gji-mburuara-si-krua,
Shtat-lëkundura-pallua
Ç'më ka përvëlur mua.

KUR M'U RITE
VOGËLOSHE

Kur m'u rite vogëloshe,
Vogëlo si flutura,
Mes-hollë-këputura.

Të pashë më sbukuroshe,
Bukuro si flutura,
Mes-hollë-këputura.

Vajte m'u fsheve në qoshe,
Fshehuro si flutura,
Mes-hollë-këputura.

Nga shoqet më turpëroshe,
Shoqezo si flutura,
Mes-hollë-këputura.

Ah, zemra ç'të përvëloshe,
Zemëro si flutura,
Mes-hollë-këputura.

KUSH TË FALI BUKURINË

Kush të fali bukurinë,
Që të më trerosh të zinë!

Kur të pashë për të vluar,
Pëllumbeshë pëndë-shkruar,
Bubu! plumb në kraharuar,
Plumb që vret dyke gjymuar!

Mbledhur shoqet më një qoshe,
Diç m'j-u flisnje, diç m'j-u thoshe,
Gushë-e-llërë-e-gji-bardhoshe.

Pa me syçkëzat e tua,
Sy-larme! ç'më fole mua.

Leshrave t'j-u binte hija,
Yll i ndezur me shkëndija,
Ndezur mun në mes në ballë,
Të më vesh në dhë të gjallë.

NË PORTA NGA MULLIRI

Mun ne porta nga mulliri
Hyn e del një trup kalliri,
Vashëza flokë-floriri

Ç'hyn e del ashtu për Zonë,
Dëgjo bota seç' po thonë,
Vasha po na prish zakonë.

Bota thotë-ato të saja,
Thotë fjalë e mëdhaja,
Bota moj gojë-xhuraja!

Do të dal përgjithëmonë
Ashtu siç e kam zakonë,
T'a këput atë lejmonë:

Atë trimin e lëvduar
T'a mbaj udhës më të shkuar,
T'a puth t'a mbaroj nër duar.

DEL NE PORTA

VARIANTË

Del ne porta nga mulliri
Vashë-leshëra-floriri.

Dëgjo bota se ç'po thonë,
Vasha po na prish zakonë.

Bota thotë-ato që thotë,
Gojë-madhe-e-fjalë-kotë.

Do të dal përgjithëmonë,
T'a prish t'a shkretoj zakonë.

Atë trim të turpëruar
T'a mbaj udhës më të shkuar.

T'a mbyll në shtëpi për fare,
T'i ri pranë si manare.

PO QAN VASHA MË SHTËPI

Po qan vasha më shtëpi:
Ç'kanë shoqet përsëri,
Ç'më shëkojnë me çudi,
Sikur s'jam si 'to njeri,
Sikur jam një çilimi!

Thonë shoqet përsëri:
Mblidhe mëndjen ti moj ti,
Ay trimi moj i ri
Po të tret posi qiri.

Thotë vasha me mëri:
Trimin do t'a mbaj në gjil!

Thonë shoqet me zili:
Ay trimi ti moj ti,
Po të djeg, po të bën hi,
Po të fut në dhé të zi.

Thotë vasha përsëri
Fjalëzë me ëmbëlsi,
Fjalëzë me dhemshuri,
Fjalë plot me vrer të zi:
Ja me trimin ler-më-ni,
Ja me trimin mer-më-ni,
Mer-më-ni moj ther-më-ni.

VALLJA E LULEVE

Vijnë vashat valle-valle
Gushë-e-gji-stolisura.
Një pëllumb, një sy-zorkalle
Seç vjen m'e mbollisura.

Ç'm'i ka hije shtat' i hedhur,
Hije kraharuari,
Pa fillon me zë të dredhur
Motra së kënduari:

Ju që niseni për lule,
Shoqe moj të mijëza,
Merr-më-ni as edhe mua
Nër pyje-e korijëza;

Pritni moj të vi dhe unë
Maleve, lëndinave,
Ndaj çkëlqen pa të përdhunë
Fill-i trendelinave;

Në mos diça të bëj tufë,
Shoqe ju dëgjo-më-ni:
Bëni moj një tog me lule
Dhe në to mbulo-më-ni;

Në ju pyeçin për mua:
Ç'u bë flog-banusheja?
Thoni, se më një përrua
E zu gjarpërusheja:

Thoni, se ndaj një mburimi
Më t'e patë fluturën:
Thoni, seç e zuri trimi
Atë bel-këputurën.

BALLADË

NË FRYMË POPULLORE

I

Fryn veriu në mal të thatë,
Thotë vasha lele ngriva.

Duro, vashë, të durojmë,
Si duron mali dëborën.

Në të shtënça moj në dorë,
Do të ngroh si top dëborë.

II

Fryn një erë-e shkundërmuar,
Thotë vasha çeli molla.

Çeli, vashë, le të çelë,
Si çel malli mun në zemër.

Në m'a dhëng moj bel' e hollë,
Do të thyej si mënjollë,
Do të shtryth posi një mollë.

III

Vjen e bën një vap' e rëndë.
Thotë vasha bubu plasa.

Duro, vashë, të durojmë,
Si duron kallir' i pjekur.

Në më arthç o moj në hije,
Do t'i puth prej dhemshurije,
Do t'i skuq t'i ndes qirije,
Do t'i nxi t'i bëj mavije
Ato buzë gjak-qershije.

IV

Zun' e shkojnë delëndyshet,
Thotë vasha po venitem.

Venitu, vashë, venitu,
Siç venitet zemra ime.

Në të marça moj përherë,
Do të shtroj të parën herë,
Do të ngroh të dytën herë,
Do të puth të tretën herë

Buzë-e gushë-e gjinë-e mjerë
Dh' atë shtatin që mban erë
Posi luleja në verë:
Gjer sa gjumi të m'të zerë,
Të m'të zerë-e të m'të flerë
Syr' i urtë si mëshqerë.

V

Vate dimri, vate vera,
Vate vjeshta përngahera.

Trim më more-edhe më shtrove,
Trim më ngrove-e më pushtove,
Trim më puthe-e më mbarove,
Trim o trim seç trimërove!

VI

Atje lart në mal të thatë
Zoti-Krisht bëke një kishë.

N'atë kishë ç'paske brenda!
Qënke trimi edhe vasha:

Trimi ç'paske dhëndëruar,
Vasha ç'paske nusëruar,
Zotin ç'paskan lavduruar,
Jetën ç'paskan trashëguar,
Shpirtin ç'paskan shentëruar.

KUSH PO SHKON ASHTU

TRIMI DHE VASHA

Kush po shkon ashtu me bujë?
Kush po vjen ashtu për ujë?

Po shkon trimi si dragua,
Po vjen vasha për në krua.

Në mëngjes në mugëtirë
Ngrihet vasha pa gëdhirë.


Ngrihet trimi i dëshëruar
Në mëngjes pa svagëlluar.

Pse mëngon ti trim i ngratë?
Ç'del ti vashë që-me-natë?
Trimin më s'e mban durimi...
Vashën më s'e mban mejtimi...

Papo fryn mëngjez' i parë:
Vashë-e trim më s'janë parë;
Fryn mesditëza me vapë:
Vashë-e trim s'këthëhen prapë;
Pa fryn er' e perëndimit:
Vasha fle në gjl të trimit.

V

VALLJA E PËRJETËSISË
ZEMRA E PËRJETËSISË



VALLJA E PËRJETËSISË

LËNDA DHE JETA

Lëndë-e thjeshtë, lënd' ujem.
Pata qënë, do të jem.
Rëndë-e fellë-edhe përjetë,
Jam çudi si kursesi...

Marr të rëndët që përdhë.
Marr të fellët nënë dhë.
Po që Lart prej Qënies vetë
Marr e jap përjetësi,

FRYMA DHE QËLLIMI

Fryn'e pastër e veriut
I tha tinës vetvetiut:
Ç'mall i math të jep qëllim,
Që buçet me kaq rrëmbim?

E sakaq si uluriu,
J-u përgjegj me gas veriut:
Kam qëllim prej vetë-dijes
T'i fry nàpëzën anijes...

Po dhe napa q'ik mi det,
I tha vetëhes së vet:
Ç'mall i math të fali shkak,
Që rreh detin zemërak?

E në ças si mori valë,
Qiti nàpëza dy fjalë:
Kam qëllim prej vetvetiut
T'i shty lundrëzën njeriut...

NDJENJA DHE NJERIU

Pa e pyet dhe vet' e ti
Të mosbindurin njeri,
Dhe për zemrën që j-u thye
I kërkoj një arsye;
Ç'ke që vuan, o njeri?
Ç'ke që bret me dhemshuri?
Ç'ke që djek posi qiri? —
...Veç në djellë-e veç në shi!
Veç në det me llaftari!
Gjith të ndjell një mall i ri!
Mall i ri, — haj! mall i zi!...
Po njeriu ndaj e dëgjonte,
Hapte gojë-e kuvëndonte —
Kuvëndonte më të qarë,
Me zembrim, me shpirt të vrarë:
Mall'i em, qëllim' i em
Që qëkur m'u bë ujem...
M'u bë fije prej qëmoti,
Sapo shpirt më fali Zoti,
Me të parën pikë loti...
Lot' i parë-ah! lot' i shkretë
Zu më shket për tatëpjetë
Sapo Zoti më dha jetë:
Më dha jetë-e më la vetë...
Dhe q' ahëre vetë-e vi,

Nxihem keq, a shkrepëti,
Rrah të bje në gji të Ti:
Po si turrem me vërtik,
Si rrah Zotin të m'a çik...
Zot' i em që m'është' armik
Gjith më çduket... gjith më ik...

NJERIU DHE ZOTI

Ndaj të qëndron, po, Zoti — tha zemra shpesh vetiu,
Më tha me zë të fellë, dhe prapë — u qetësua;
Dhe prapë që nga gjiri q'u tund e psherëtiu
Me fshehtësi më foli: Ay qëndron ndaj mua...
Ahëre pata heshtur, e s' kuvëndova dot,
Ahëre thelb' i zemrës m'u droth posi thërrime;
Sepse në vetëveten të pata ndjerë, o Zot!
Mjerush të pata ndjerë në vëtëveten t'ime!
A! dyke neveritur gëzim e dhembje pàs,
Me sy të vetëtimshmë dhe dyshimtar e tinës,
Kur që nga shëmb' e vetes qëndrova të sodas
Sa keq m'j-u patnë hapur të fellat e greminës —
Ndaj fundesh llaftarije ku syr' i em u mvrejt,
E mënt' e turbulluar askur s'u mund t'i matin:
T'a pata matur shtatin! T'a pata matur krejt!
Ndaj fundesh llaftarije T'a pata matur shtatin!

O Zot! Po rroj pëndesën e jetës më së nxire:
Shtërmath në vete t'ënde — më dhë kaq vogëlsi...
E si m'a ngrite shpirtin nër kulme lartësire —
Sesà në fund ke zbritur! sesà në fund të ti!...

PËRJETËSIJA

Në kulm,
Në thelb,
Në fund të vetes s'ate
Më mban, njeri;
Me tëmbëla nër duar
Kupto tatshi çfardo dyshim që pate!
Të flas me zë të fjalës së kulluar:

•

Kur ti *shijon*...
Kur t'i përket...
Kur ti
Një lules s'heshtur erë-i merr në fletë:

Jam pemë...
Flutur...
lule..., o njeri

Je lëng...
Je pluhur...
J' er' e lules vetë...

•

A *sheh* ku zbriti vera mi bregore?
Dëgjon në pyll këmborën q'ushtiu?

Je fiye bar,
Je tëngëll prej këmbore:

Jam vera,
Jam këmbora vetvetiu.

Pra ndje tashi si ryn në det një vlak,
Kupto tashi si shket... fundet... humbet...
Heu! tej-së-tejmi deti zemërak
Nër vlak kullon!...

Njeri:

Je vlak!
Jam det!

PËRJETËSIJA

I

Jam sot,
Si vjet,
Si mot,
Si përgjithënjë.

Në trupin jam,
Në zemr' e shpirtin t'ënd.

Kur jam në trupin t'ënd,
Jam domosdo
Dhe jashtë trupit t'ënd prej vetvetiu:

Në pemën jam, që shije ty të jep,
Në fluturën, që krahët ti j-a çik,
Në lulen jam, që erën ti j-a merr.

Që brënda trupit desha t'a bashkoj
Dhe veten t'ime-atje përjashta ti:

Dhe hapa shteg-bashkimi nëpër trup:
Atë të gojës, plot margaritar,
Atë të dorës, ndritur si zëmbak,
Atë të hundës, drejt posi qiri.

Pra ti shijon një pemë-embëlsi,
Ti çik me dorë fluturën-stoli,
Ti merr me gas një erë-fshehtësi:

Nër shteg-bashkimi, që ti s'di sesi,
Bashkohesh brënda me përjashtësi,
Bashkohesh jashta me përbrëndësi,
Bashkohesh fellë me përjetësi.

II

Jam sot si vjet,
Jam mot si përgjithnjë.

Në trup,
Në zemër jam,
Në shpirtin t'ënd.

Kur jam në zemër t'ënde,
Jam vetiu
Dhe jashtë zemrës s'ate domosdo:

Nër pyje jam, që syri t'i vështron,
Nër këngë jam, që veshi t'i dëgjon.

Që brënda zemrës desha t'a bashkoj
Dhe veten t'ime-atje përjashta saj:

Dhe hapa shteg-bashkimi nëpër të:
Atë të syrit, plot me shkrepëtim,
Atë të veshit, plot me tingëllim.

Pra ti shëkon një pamje-bukuri,
Pra ti dëgjon një këngë-llaftari,
Pra zemra ndjen një ndjenjë-fshehtësi.

Nër shteg-bashkimi, që ti s'di sesi,
Bashkohesh brenda më përjashtësi,
Bashkohesh jashta me përbrëndësi,
Bashkohesh,tretesh me përjetësi.

III

Jam sot,
Jam vjet,
Jam mot,
Jam përgjithnjë.

Në trup,
Në zemër,
Jam në shpirtin t'ënd.

Kur jam në shpirtin t'ënd,
Jam domosdo
Dhe jashtë shpirtit t'ënd prej vetvetiu:

Në mal, që mëndjen ty t'a çqetëson,
Në hon, që mëndjen ty t'a turbullon,
Në det, që mëndjen ty t'a llaftaron,
Në qjell, që mëndjen ty t'a qjellëson,
Në djellë, mëndjen që t'a djellëson,
Në botë, mëndjen që t'a botëson.

Që brënda shpirtit desha t'a bashkoj
Dhe veten t'ime-atje përjashta ti:

Dhe hapa shteg bashkimi nëpër shpirt:
Shteg të mendimit, plot me diltësi,
Ah! të mendimit plot me errësi...


Pra ti kupton ah! ti s'kupton tashi,
Një mal-e-hon-e-det-ah! llaftari,
Një qjell-e-djellë-e-botë-ah! fshehtësi.

Nër shteg-bashkimi, që ti s'di sesi,
Bashkohesh brënda me përjashtësi,
Bashkohesh jashta me përbrëndësi,
Bashkohesh-ritesh-me-përjetësi.



VI

VALLJA E VDEKJES
ZEMRA E VDEKJES



GJENIU I ANIJES

Vështroni si shket sipër valash
E tundet anija më ngé? —
..Me krismë-e me prush prej stërkalash
Mi të shkrepëtiu një rrufe!..

Ti det, brohori fshehtësire!
Kuptim i potershëm, ti det!
..Po heshtje: ndaj valës së nxire
Gjeniu i anijes po flet:

Prej zallit që sot po largohem,
Fillova mërgimin e ri;
Hepohem... anohem... humbohem...
Po sulmën s'e ndal kursej.

Dh'aspak nuk më tremb zhurmërija,
Ndaj turret me hov e vërtik
Mi ballë-e mi kórje të mija
Ndërsimi-i tallazit armik.

Përpara kur shoh gjeratore,
Dh'ato më gremisin në fund —
Mi kulmin e valës malore
Un' heq të shpëtoj sa me mund.

E morti fatkeq në më çiku,
N'u desh tmerrësisht të fundas —
Aspak nuk më thyen reziku,
Po nis e përmbysëm me gas:

Se prapa le vazhdën e ndritur —
Q'e hapa me shpirtin fatos: —
Fistonin gazmor ku pat shkitur
Valim-i anijes q'u sos.

.
.
.
.

Valimi-i anijes së letë
Qetohet, ndalohe, mbaron:
Gjeniu i anijes përjetë
Hepohet... anohet... valon...

LUNDRA DHE FLAMURI

Që larg po vi..., që larg.
Më turren valët varg-e-varg,
Un' ik dh' hepohem mund si harg...

E sipër tyre shkas,
Valoj me sulmë-e gas,
I le tallazet pàs:

...Kur val' e egër ze më tund,
E s'mund të mpruhem asgjëkund
Prej gjeratoreve pa fund, —

Dënimi im s'më tremb aspak!
Dënimi im nis e m'i lak
Fingjijtë-e shpirtit varfanjak:

E si më mbyt i tmershmi det.
Pushon ah! zemra që buçet,
Mbaron ah! zjarri që më tret.

E s'duket gjë kur humb,
Veç pluhurës si shkrumb
Lart mi katárt si thumb:

Flamur i pastër që m'u nxi
Në sulm të lumtur për liri,
Qëndron gazmor në lartësi!...

.
.
.

Tashi katarti-u çduk në det
Tashi flamuri-u ngrit përpjet.
Valon lirisht si shpirt i lehtë.

VDEKJA E NOSITIT

Me zjarr ju flas..., me zjarr.
Në gjirin t'im kam hapur varr...
Që t'i jap shpresë-edhe t'j-a mar...

Un' ik liqerit zemërak
Fatlum dh'i pastër si zëmbak,
Po zemra ime kullon gjak:

Se vijnë-urtuar zoqtë-e mi,
Dh'u jap ushqim me dashuri —
Një dashuri për llaftari:

Pa nis ah! gjirin t'a godas...
Dh'e hap ah! — gjirin më një ças...,
Dh'i nginj ah! zoqtë-e vdes me gas!...

Ahere-helmohet e buçet
Pas mallit t'im liqeri-i shkret.
E rit tallazin posi det.

Ay e tund, ay e shkund,
Ay e hap sa me të mund,
Gjer mun në gjit, gjer mun në fund.

E shpirtin dyke m'a përcjellë,
Më thotë ah! shih sesá 'sht'i fellë
Ky gjir' i em që të pat pjellë...
... Me zjarr ju flas, me zjarr.

PËRQAFIMI

RONDEL

Jetë-e-vdekje-përqafuar,
Nuku di se ku po vete:
Shkon e ndal e ri menduar
Në kalove-edhe në mbete.

Në ke lerë-a perënduar,
Gjith dyshim jetë pas jete!
Jetë-e-vdekje-përqafuar,
Nuku di se ku po vete.

Kështu rrjeth dyke kënduar
Ëndr' e zemërës së shkrete.
Rrjeth si varg i pambaruar,
Varg i thurrur vdekje-e-jete,
Jetë-e-vdekje-përqafuar.

ZEMRA E SHOKUT

Të kam shok nga koh' e vjetër
Shok prej zemre-edhe prej gjaku...
Shok të ri me besë plaku
Nuku kam, nuku ke tjetër.

Se ç'do gas e mall të shkretë
M'i ke thënë-emër me emër,
Unë-i mbylla mun në zemër
Gjer sa zemra të mos jetë.

Se ti mban në kraharuar
Shentërinë-e një dhurate:
Mban në fund të zemrës s'ate
Ç'të kam thënë-i llaftaruar.

Ish e bardhë-e nuku kishte
Dredhëri zemra bujare:
Bënte botën zilitare
Zemr' e bukur shokërishte.

VRAPojNË ZEMËRAT

Me sulm të ri, me shpirtin plot
Ti bën një vrap për t'udhëtuar.
Bën edhe një si vjet dhe sot,
Dhe një dhe mot e papushuar.

Dhe nuku pyet për ngaj po shkon,
Që ngaj po vjen ngaj të fryn era.
Veç udhëton veç përparon,
Si vjet e sot e mot përhera.

Dhe ik... e ik... e ik... e ik...
E ja! këputet zemr' e shkretë.
E ja! përshembet vrap' i lik
Et bje përmbys përgjithëjetë.

E pa t'u tharë pika lot,
Vrapojnë zemërat e tjera,
Me sulm të ri, me shpirtin plot,
Si vjet e sot e mot përhera.

VAJTIM MI TRUPIN E SHOKUT

Shpirtit t'im Ty, — Gas përjetë —,
I pat falur koha;
Ububu! më le të shkretë —
Ah! posa të njoha.

Digjej zemr' e dashurisë
Posi yll i gjallë;
Shok! je nxirë posi pisë
Në buzë, në ballë.

Dh'ay syri yt i urtë
Flij — pëllumb në gjumë...
Sot t'a shtyp qipall' e gurtë,
Është bërë lumë.

Psë më mprite aqe fellë
Mun në shpirt, përhera:
Vesë, që çkelqeu në djellë,
Lule, q'e thau era? —

Ah, nuk le të çeli jeta
Mun në kulm të sajë:
Biskun q'e thëthin përpjeta
Të çeli në majë,

Zot!

... Në botë kaq mjerime,
Kaq një mall i nxirë
Pati mbushur jetën t'ime
Plot me shkretëtirë.

KU QAJNË MOTRAT VËLLANË

(VAJË NË KADENCË POPULLORE)

Vajtó, moj botë,
Vajtó me ne:
Se ra zëmbaku,
U shtri përdhe.

Ti lul' e bukur,
Ah! ti zëmbak,
Na mbushe shpirtin
Plot helm e gjak.

Ti re sëmurë,
O trim i ri,
E gjë në jetë
S'të pru dobi:

Më çdo lëndinë,
Më çdo ugar,
Si bleta mjaltin
Kërkuam bar;

Po ty e liga
S'të pat shërim,
O rusp i bukur,
O djalë trim.

Në varr të fellë,
Në varr të zi,
T'u shojt ah! jeta
Posi qiri;

Të qajnë motrat,
Të qan vëllaj,
E fshat' i tërë
Të qan me vaj;

Të vdiq jot-ëmë:
T'u ngjall yt-at:
Prej dhembjes s'ate,
Ah! shpirt i ngrat.

PREJ ÇDO GAZI-E HIDHËRIMI

Prej çdo gazi-e hidhërimi
Mbetet pas vetëm kujtimi

Ah! dh'i shkreti-mallëngjimi.



VII

KUR NUK NDJEHESH FARE MIRË
KUSH MA NJOHU DHEMSHURINË

KUR NUK NDJEHESH FARE MIRË

Kur nuk ndjehesh fare mirë.
(Sepse shpirtin e ke plot),
Ze këndon në vetësirë
Pa të derdhen pika lot.

Pika lot, si pika dylli,
Që të derdhen aqë shpesh,
Kush qëpallat nuk i mbylli...
Nuku mund t'i marë vesh:

Kujt s'j-u dha t'i rrahi mentë,
Në shtëpi kush nuk u mbyll,
Më një hov kur shpirt'i shentë
Ndrin e digjet posi yll —

Nuku mund t'a dijë fare,
As që do të ndjejë dot
Ç'pruri kënga mendimtare
Me çdo varg prej pikash lot:

Kush të tall me verb të kotë,
Nuku mund t'i ndjejë gjiri
Ç'Drit' e bardhë djeg në botë
Me çdo pikë prej qiriri.

KUSH M'A NJOHU DHEMSHURINË

Ç'punë bëj e ku kam lerë,
Në kam nënë-e në kam at —
Me kuvëndin e përzjerë
Pate pyetur, shok i ngrat!

Un' i ziu që s'kisha fatin
Të përgjigjem më një ças,
Passi von t'a mata shtatin
Kam vendosur të të flas:

Më pat lindur vënd' i Zotit,
E bëj punën e njeriut,
E për prind... — o! pik' e lotit,
Pse më re prej vetvetiut?

Me kuptim të përvëluar
U pat mbushur shpirti im.
Shpirti im q'u pat zembruar,
Shkëndijon si vetëtim.

Po në qaj e zjej me-vete,
S'dëshpërohem kursesi
Ndaj i ndjej së mjerës jete
Vetëm mall e dhemshuri.

Veç durim e mall të nxirë
Më pat dhënë-ah! gjir' i saj,
Pa më mbush me shkretëtirë,
Haj! o fund i jetës, haj!

Qoftë-e ëmbël si një çupë,
Qoftë-e mbushur plot me gjak:
Do t'a pi të shkretën kupë,
Siç e piu Sokrati plak...

Papo zemrën e zhuritur
Mos u tremb se mos m'a fik:
Se në prush m'u pat kalitur
Thelb' i zembërës, o mik.

E në dhembjet venë-e vinë,
Jam gati të vuaj më:
Kush m'a njohu dhemshurinë,
S'pati njohur kurrëgjë.

SHËNIME

Lasgush Poradeci, pseudonim i Lazar Gushos, lindi në Pogradec, më 1896. Si kreu shkollën fillore në Pogradec, shkoi në një shkollë rumune të Manastirit, e prej atje në një lice francez fetërisht në Athinë. Në vitin 1920 kthehet në Pogradec e një vit më vonë shkon në Bukuresht, ku regjistrohet në fakultetin e letërsisë dhe në Akademinë e Arteve të Bukura. Po në këtë kohë dëgjon edhe një kurs leksionesh mbi doktrinën fetare, mbi teozofinë. Këtu u zgjodh sekretar i Shoqërisë së Shqiptarëve të Rumanisë. I dobët nga shëndeti dhe me vështirësi të mëdha ekonomike, u detyrua pas tri vjetësh t'i presë studimet. Me ndërmjetësinë e Shoqërisë së Shqiptarëve të Rumanisë merr bursë nga qeveria e Nolit dhe më 1924 shkon në Grac të Austrisë, ku kreu studimet në filologjinë romangjermanike. Në vitin 1934 u emërua profesor vizatimi në gjimnazin e Tiranës, ku punoi thujse deri në çlirimin e vendit. Pas çlirimit u emërua në Institutin e shkencave, pastaj në Shtëpinë Botuese „Naim Frashëri“.

Lasgushi filloi të shkruajë që nga viti 1915, për vjershat e tij zunë të botohen kryesisht nga viti 1921 në gazetën „Shqipëri e Re“ të Konstancës, në gazetën „Dielli“ të Bostonit, si dhe në të përkohshme e gazeta të tjera. Më 1933 studentët shqiptarë në Bukuresht i mblodhën mjetet për botimin e librit *Vallja e yjve* e cila doli nga shtypshkronja *Albania* e Konstancës po në këtë vit dhe përmban vjershat e Lasgushit të shkruara e të botuara në mes të viteve 1921-1924, përveç vjershës *Himni i djalorisë*,

që u botua më 1929 në Shqipëri. Më 1937 në të njëjtën shtypshkronjë doli libri i dytë *Ylli i Zemrës*, nën përkujdesjen e Mitrush Kutelit, që përmban vjersha të reja të Lasgushit, si dhe një numër nga vjershat e botuara në librin e parë.

Mbas vitit 1937 Lasgushi shkroi ndonjë vjershë në revistën „Përpjekja shqiptare” dhe pas vitit 1941 botoi disa vjersha në gazeta e revista të asaj kohe.

Në këto vitet e fundit Lasgushi botoi disa vjersha të reja në gazetën „Drita” dhe në revistën „Nëntori” në Tiranë.

Me rastin e gjatëdhjetëvjetorit të lindjes së poetit, më 1956(?) u botua në Tiranë një vëllim me titull *Lirika*, që përmban vjersha të zgjedhura të Lasgushit. Vëllimin e ka përgatitur Muzafer Xhaxhiu.

Më 1967 Enti për botimin e teksteve në Prishtinë nxori vëllimin me titull *Poezia*, që përmban shumicën e vjershave të Lasgushit, të përgatitura për shtyp nga Murat Isaku.

Në vitin 1970, në serinë e veprave të zgjedhura *Poezia* shqipe, u botua po ashtu në Tiranë një zgjedhje e vjershave të Lasgushit.

Sa di unë, pos botimeve të përmendura, edhe pse kurr nuk ka pushuar interesimi i lexuesit shqiptar për fuqinë dhe bukurinë e poezisë së Lasgushit, vepra e tij nuk është botuar, (ri)botuar kurr e plotë. Detyrën e rëndë të një botimi të tillë e merr mbi vete nxërrja e këtij vëllimi. Prandaj, ndjej nevojën të them këtu një-dy fjalë lidhur me përgatitjen e këtij vëllimi.

Jam përpjekur të përfshijë të gjitha vjershat e Lasgushit, mirëpo nuk e kam arritur këtë sepse nuk kam pasur mundësi t'i kem në dorë vjershat e poetit, të botuara në gazetat dhe të përkohshmet në Shqipëri gjatë luftës dhe pas saj. E ato pak poezi të kësaj periudha që kam pasur në dorë nuk kanë vlerën e poezive të Lasgushit të përfshira në dy librat e Bukureshtit. Prandaj, vendosa që në këtë vëllim me titull *Vdekja e Nositit*, që simbolikisht shpreh programin poetik të Lasgushit si dhe të krijuesit përgjithësisht, të përmbledh të gjitha vjershat e tij të botuara në

librat *Vallja e yjve* dhe *Ylli i Zembrës*. Libri është përgatitur duke ruajtur titujt e cikleve e të vjershave e *duke i shkrirë të dy librat në një tërësi*, me synimin që Lasgushi ta ndiejë veten sa më mirë në këtë mënyrë të komponimit të ri të veprës së tij poetike. Pra, jam përpjekur që, edhe në këtë libër, poezia e Lasgushit të mbetet dhe të lexohet gjithnjë si poezi lasgushjane, duke i ruajtur të gjitha karakteristikat e shkrimit të tij, pos tjerash edhe interpunksionin, i cili është prekur sa herë është ribotuar kjo poezi dhe i cili është relevant sepse është i funksionalizuar poetikisht në vjershë.

Në këtë mënyrë, kujtoj, krijohet mundësia që poezia e Lasgushit të lexohet ashtu si është shkruar. Pra, të shtrihet mundësia e leximit të saj të plotë.

Vlera e veprës së Lasgushit mbetet gjithnjë aktuale. Këtë e thotë drejtpërdrejt edhe botimi i kësaj vepre dyzet vite mbas botimit të *Yllit të Zembrës*.

S. Hamiti



TRYEZA E VARGJEVE

Vdekja e Nositit	7
I. Shqiptimi i poezisë	7
II. Fusnota	35
NË VEND PARAFJALE	49
Zog' i qiejve	51
VALLJA E QJELLIT / ZEMRA E QIELLIT	53
Shpirtit	55
Ri mbështetur në truezë	57
Malli i vjershëtorit	59
Ylli	60
Gjumi i shpirtit	61
Gjuha e zjarhtë	62
VALLJA E DHERIT / ZEMRA E DHERIT	63
— Kënga pleqërishte	65
— Poradeci	67
— Naimit	68
— Naim Frashërit	71
— Asdrenit (Portret)	77
X Dremit liqeri	78 X
Zemra e liqerit	79
Dritë fshehtësije	80
Mëngjes	81
Korrik	82
Mbarim vjeshte	83
Dimër	84
Gjahtori	85
— Marshi i djalërisë (Himn Kombëtar)	87
— E fundit mërzitje (Marsh Shqiptar)	89
— Bjenë telat (Rapsodi)	91
— Ç'u mbush mali (Rapsodi popullore)	94
— Dita e njëzetetëtës	96

Vogëlushja	101
Mall i largë	103
Ti moj shoqe	105
Syr' i fshehur	107
Vesë dashurije	109
Si nus' e re	111
Vashë shemshurije	113
Erë trendeline	115
Dashurija udhëtare	117
Je ulur fort	118
Oh, vanë fletër (Frangment)	119
C' dëgjoj me sy të trembur	120
Ti po vjen që prej së largu	121
Ah, me-atë mall që më ke ti (Trioleta)	122
Ku shtrohet vala (Romancë)	124
Dora jote ledhatarja	126
Posi burbuq' e trëndafilut	127
Eja, motër	128
Vdekja jonë	131
Endër zilitare	133
Dëshirave	134
Kur në flakë	135
Ri me shëndet	136
Lamtumirë	138
Lamtumirë (Variantë)	139
Lamtumirë (Variantë)	140
Lamtumirë (Variantë)	141
Të ritë e vitevet të mi (Këngë)	142
Kur të më jesh e zemëruar	145
Malli	147
Më zu një mall	149
Më zu një mall dhe sot (Variantë)	150
Më zu një mall dhe sot (Variantë)	151
Që larg	152
Vallja e yjve	154
Kroj i fshatit t'onë	157
Trioleta	159
Syt' e lumtur	161
Syt' e varfëruar	162
Mretëria jonë (Trioleta)	163
Syt' e tu vetëtimtarët	165
Një yll përpjetësije	166
Mbretëria e zemrës	168
Mërgim	169
Resurrectio	170
Letrëkëmbim	172

Vate prilli	173
Kur m'u rite vogëloshe	174
Kush të fali bukurinë	175
Ne porta nga mulliri	176
Del ne porta (Variantë)	177
Po qan vasha më shtëpi	178
Vallja e luleve	179
Balladë (Në frymë popullore)	181
Kush po shkon ashtu (Trimi dhe vasha)	184
VALLJA E PËRJETËSISË / ZEMRA E PËRJETËSISË	185
Vallja e përpjetësisë	187
Lënda dhe jeta	187
Fryma dhe qëllimi	188
Ndjenja dhe njeriu	189
Njeriu dhe zoti	191
Përjetësija	192
Përjetësija	194
VALLJA E VDEKJES / ZEMRA E VDEKJES	199
Gjeniu i anijes	201
Lundra dhe flamuri	203
Vdekja e Nositit	205
Përçafimi (Rondel)	206
Zemra e shokut	207
Vrapojnë zemërat	208
Vajtim mi trupin e shokut	209
Ku qajnë motrat vëllanë (Vajë në kondencë popullore)	211
Prej çdo gazi-e hidhërimi	213
KUR NUK NDJEHESH FARE MIRË / KUSH MA NJOHU DHEMSHURINË	215
Kur nuk ndjehesh fare mirë	217
Kush m'a njohu dhemshurinë	218
S h ë n i m e	220

NDREQJE GABIMESH

- Në faqen 33 vargu:
Gjuha : goja! Gjuha : fjala! Gjuha : zemr'e
 duhet të jetë:
Gjuha : yll'i vjershërisë! Gjuha : Verb'i Perëndisë!
- Në faqen 38, rreshti 16, fjalia:
 „... *ky është poet lirik...*”
 duhet të jetë:
 „... *ky nuk është poet lirik...*”.
- Në faqen 72, vargu:
Po nër bijt' e mëmës s'ate, me gjymashë-e
 duhet të jetë:
Po nër bijt' e mëmës s'ate, me gjymashë-e me stërnipër.
- Në faqen 205, vargu i fundit i poezisë *Vdekja e Nositit*
 duhet të jetë i ndarë nga strofa pararendëse.

